

1 E mërkurë, 3 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.02

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
12 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit sot.

14 Do të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë
15 04752.

16 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

17 Ndërkohë që presim dëshmitarin mund të pyes Prokuroren,
18 dhe sa kohë mendoni se ju nevojitet për të përfunduar?

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mendoj se do të përfundoj para
20 pushimit të orës 11.00.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
23 z. Zyrapi.

24 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të

1 vazhdojmë me dëshminë tuaj edhe sot.

2 Ju lutem përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse
3 nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkonit që pyetja të
4 përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që pyetja të
5 sqarohet.

6 Gjithashtu dhe mos harroni të na thoni ku i bazoni ju
7 faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjmë pyetje.

8 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
9 se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë në mënyrë që t'ju kapin
10 dhe përkthyesit.

11 Në çdo moment që keni nevojë për pushim na thoni në
12 mënyrë që të bëjmë organizimin përkatës.

13 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
14 vërtetën sikurse vetë e cituat përmes deklaratës solemne.

15 Siç ju thashë dhe dje, ju rikujtoj që nuk duhet t'u
16 përgjigjeni pyetjeve që mund të jenë vetinkriminuese me
17 përjashtim të rasteve kur ju detyron Trupi Gjykses. Nëse lind
18 një pyetje e tillë ju mund ta shprehni këtë përmes Avokatit
19 tuaj dhe do të vendosim ne pastaj nëse ju duhet të përgjigjeni
20 apo jo dhe në ç'rrethana do të duhet t'i përgjigjeni kësaj
21 pyetjeje.

22 Mirë. Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga Prokuroria.
23 Dëgjojini me vëmendje.

24 Znj. Sekretare, fjala është për ju.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Dhe mirëmëngjesi.

1 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI [Vijon]

2 Pyetje nga znj. Lawson: [Vazhdim]

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

4 PY. Sa i takon marrëveshjes së Rambujesë, a është mbajtur
5 ndonjë takim për të vendosur të firmosej apo jo kjo
6 marrëveshje?

7 PË. Po. Mbasi, veç edhe dje kur folëm, ishte një ndër takimet
8 që e bamë është qa ai takim të cilin u kthye delegacioni nga
9 Rambujeja, e kemi diskutuar dhe pas asaj janë kthyer dhe e
10 kanë nënshkrue marrëveshjen në Rambuje.

11 PY. A është mbajtur një takim përpara se të nënshkruhej
12 marrëveshja për të diskutuar a duhej nënshkruar apo jo kjo
13 marrëveshje?

14 PË. Po, një takim. Delegacioni ka qenë në Rambuje dhe është
15 kthyer, është diskutue në shtab dhe janë kthyer pastaj dhe
16 kanë nënshkrue në Rambuje.

17 PY. Ky takim ku është mbajtur, flasim për takimin ku është
18 diskutuar marrëveshja?

19 PË. Takimi është mbajtur në bjeshkët e Berishës.

20 PY. Kush mori pjesë në këtë takim?

21 PË. Ka marrë pjesë delegacioni, Shtabi i Përgjithshëm dhe
22 komandantët e zonave.

23 PY. Kush e kryesoi këtë takim?

24 PË. Po më kujtohet në atë kohë në këtë takim, ka informuar
25 për ecurinë në Rambuje ka shpalosur komplet Hashim Thaçi,

1 pastaj janë kyç edhe anëtarë të tjerë të delegacionit dhe
2 shtabit.

3 PY. Cila qe natyra e diskutimeve?

4 PË. Në diskutime është diskutu për nënshkrimin e
5 marrëveshjes. Cilat janë dobitë pozitive dhe cilat janë
6 negative. Më shumë është që është pozitive dhe çka ka pi asaj
7 se që do të nënshkruhet marrëveshja.

8 PY. Ju personalisht çfarë pikëpamje patët për këtë
9 marrëveshje, a duhej nënshkruar apo jo?

10 PË. Unë e kam pas pikëpamjen, po, duhet të nënshkruhet. Si
11 mbas situatës që e kam pasur në terren dhe e kam ditur, ka
12 qenë e nevojshme që të nënshkruhet kjo marrëveshje.

13 PY. A pati rezistencë, pra, a pati më rezistencë për
14 nënshkrimin e marrëveshjes pasi delegacioni ua shpjegojë këtë
15 marrëveshje personave të pranishëm?

16 PË. Jo, më vonë, jo.

17 PY. Do të kthehem pak në kohë për t'u fokusuar te shkurti.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për këtë arsye do të doja që të
19 shfaqej në ekran prova materiale me numër P00182. Dhe do të
20 doja të shkonim në faqen 416.

21 PY. Ky është një shënim që mban datën 12 shkurt 1999, këtu
22 thuhet se ju keni refuzuar të nënshkruanit disa prej vendimeve
23 që janë marrë në atë takim. Ju kujtohet?

24 PË. Po, më kujtohet.

25 PY. Me kë person e keni pasur diskutimin?

1 PË. Këtë diskutim e kam pas me Rexhep Selimin, në të cilin
2 kam refuzuar të bëhet ndërrimi i komandantit të zonës së
3 Pashtrikut.

4 PY. A e dini pse u mor vendimi për të bërë ndryshimet në
5 zonën e Pashtrikut?

6 PË. Po në atë kohë kërkonte që të bëhej ndryshimi me
7 komandantin e zonës. Kam kërkuar shpesh herë të shpjegon
8 arsyen pse, në qoftë se mirret në aspekte profesionale, nuk ka
9 dobësi të tij si komandant, ka aftësinë e vet dhe njef
10 terrenin dhe njef zonën. Po si shifet si mbas disa raporteve
11 të mëhershme që janë ankuar mosbashkëpunimi i komandant Drinit
12 me disa eprorë në atë komandë, të cilën nuk korrespondonte, se
13 këta zotërinjtë nuk i kanë ditë as detyrat e veta t'i kryejnë
14 e të japim kësi mendime.

15 Dhe në aspektet profesionale dhe të aftësive të tij në
16 këtë kohë ka qenë për mua absurde të ndërrohet komandanti i
17 zonës të vihet dikush tjetër që shumë më pak e njef zonën edhe
18 njësitë.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të doja tani të shfaqim në
20 ekran materialin me numër P00633.

21 PY. Edhe ky dokument mban datën 12 shkurt. Edhe këtu emërohet
22 Sali Veseli si ushtrues i detyrës së komandantit në zonën
23 operative të Pashtrikut. A është kjo pjesë e emërimeve që ju
24 keni refuzuar të nënshkruani apo të pranoni?

25 PË. Së pari, unë e kam cek edhe më herët, këtë dokumentacion

1 s'e kam pa. E dyta dhe nuk është përcek atëherë aspak as kush
2 do të është zëvendësuesi i tij, i komandantit të zonës. Ne
3 kemi folur veç për komandantin e zonës. Kurse të gjitha këto
4 të tjerat që janë vendosë në emërimet, nuk mund të bëhen
5 emërimet të tillë dhe të emëron shefi i shtabit rend edhe
6 komandantin edhe pjesë të komandës, kur shumë mirë dihet, ne
7 folëm dhe më herët, i pamë dhe komisionin kadrovik i cili ka
8 qenë i informum. Ai është i cili i shikon, i propozon nga
9 komandanti i zonës. Ata shikojnë si komision, i jipet
10 komandantit apo zëvendësit ndaj vendos ose emëron komandantin,
11 zëvendësin, shefin e shtabit apo komandantët e brigadave. Nuk
12 është e imja si shef shtabi të emëroj as komandantin e
13 brigadës, as komandantët e zonave, po as t'i emnoj komandantët
14 e batalioneve.

15 Komandantët e batalioneve dhe oficerët të cilët janë
16 pranë zonave nuk kanë qenë në pjesën të cilët emënonte
17 komandanti ose shefi i shtabit nga Shtabi i Përgjithshëm, po
18 komandantët e zonave.

19 Këtu kur të folim për gjithë këta, domethënë, ky dokument
20 ose është nënshkruar më vonë ose ky dokument nuk është paraqitur
21 në atë takim. Jo veç ky, po asnjë dokument, sa më kujtohet
22 shumë mirë kur kemi diskutu për këtë çështje.

23 PY. Pra, kemi një seri dokumentesh të tjera që mbajnë të
24 njëjtën datë, 12 shkurt. Ka dhe një me emrin tuaj po nuk ka
25 nënshkrimin tuaj. Mesa kam kuptuar unë, ju nuk keni parë këto

1 dokumente. Thjesht keni diskutuar me Rexhep Selimin për të
2 bërë ndryshime në zonën e Pashtrikut, po dokumentet
3 konkretisht nuk i keni parë, a e kam kuptuar drejt?
4 PË. Po, plotësisht qashtu është.

5 PY. Arsyet janë që ju nuk u pajtuat sepse fillimisht ju nuk u
6 pajtuat me zëvendësimet për shkak të aftësive profesionale dhe
7 së dyti nuk ishte kompetenca juaj për të marrë këto vendime,
8 kështu?

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund të bëj një pyetje pak më të
10 hapur Prokurorja, se më duket pak sugjestionuese kjo pyetje. A
11 mund ta pyes Prokurorja dëshmitarin çfarë mendonte ai
12 konkretisht?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me kënaqësi mund ta bëj. Unë
14 thjesht u bazova në pyetjen e tij.

15 PY. Dëshmitar, do ju lutesha a mund të na thoni çfarë arsyesh
16 patët që vendosët që të mos nënshkruanit ndryshimet në zonën e
17 Pashtrikut?

18 PË. Shkurt. Unë dhe e shpjegova dhe para. Një ka qenë që të
19 mos ndërrohej komandantin e zonave për shkaqe profesionale.
20 Dhe e dyta nuk është në kompetencën time unë t'i emnoj
21 komandën e zonës. Shkurt.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kalojmë tani tek dokumenti me
23 numër 072639. Dhe nuk është për publikun.

24 PY. A e njihni ushtarin që përmendet në këtë dokument,
25 Samedin Xhezairi?

1 PË. Po.

2 PY. A e njihni kush e ka nënshkruar, personin që e ka
3 nënshkruar këtë urdhër?

4 PË. Po. vula është e komandës së zonës operative të
5 Pashtrikut, nënshkrimi është i Ekrem Rexhës, Drinit.

6 PY. Për çfarë është ky urdhër dhe a jeni konsultuar ju për
7 këtë urdhër?

8 PË. Po, më kujtohet shumë mirë ky urdhër. Dhe është
9 konsultuar komandanti i zonës për të emëruar ose një
10 koordinator i cilit duhet të ishte Samedin Xhezairi, të shkon
11 në territorin e Dragashit, faktikisht të Opojës dhe të bën
12 formimin e Brigadës 127. Por edhe që ka pas për detyrë e të
13 shkon në territorin e Brigadës 125, për shkak se në territorin
14 e Opojës nuk ka qenë hala as nën kontrollin e UÇK-së. Po nga
15 ky territor ka dalë e të depërton dhe të formon këtë njësi.
16 Mirëpo në atë kohë nuk arriti ta formon për shkak të ofensivës
17 dhe sulmeve që u është bërë në atë territor dhe nuk arriti që të
18 realizohet ky urdhër për formimin e kësaj brigade.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër të
20 dokumentit.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më falni që ju ndërpres, po a
22 mund të respektojmë këtë praktiken e të thënit datat e
23 dokumenteve për procesverbal.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Patjetër. Shkojmë atëherë tek
25 data pararendëse. Është data 1 mars 1999.

1 PY. Dokumenti mban datën 22 mars 1999. Dëshmitar, a njihni
2 çfarë është ky dokument.

3 PË. Po. Ky është një leje qarkullimi në territorin e Kosovës
4 ku i jipet ushtarit apo eprorit të cilit mund të qarkullon
5 prej zonave në zonë. Si për shembull, konkrete kjo leje, ky
6 dokument që është dhënë Xhezair Samedinit. Është nënshkrimi
7 im, është vula e drejtorisë operative dhe është dokumenti
8 Shtabit të Përgjithshëm.

9 PY. Dhe kush, si rregull, kush e kishte kompetencën për të
10 nënshkruar leje të këtilla?

11 PË. Po në raste të tilla, unë e kam nënshkru. Po ka të
12 drejtën të nënshkruar leje të lëvizjes, ka pas komandanti i
13 brigadës në zonën e vet. Komandanti i zonës në zonën e vet të
14 përgjegjesisë. Për shtabin eprorët të cilët ose ushtarët të
15 cilët kanë lëvizje prej një zonë në zonën tjetër, atëherë janë
16 dhënë edhe nga ana e shtabit. Po dhe shtabi janë dhënë dhe ata
17 të cilët janë vartësit e shtabit si eprorët apo ushtarët apo
18 njësitë të cilat janë pranë Shtabit të Përgjithshëm.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në faqen
20 tjetër.

21 PY. Ky dokument mban datën 6 korrik 1999 dhe shohim emrin e
22 Tahir Sinanit poshtë. Ka qenë komandanti i zonës Tahir Sinani
23 në periudhën kohore të këtij dokumenti?

24 PË. Po, Tahir Sinani merr emnim në mars të vitit 1999, kur
25 është bërë ndryshimi ose ndërrimi i komandant Drinit e ka

1 marrë Tahir Sinani edhe ka vazhduar edhe në këtë kohën tash të
2 korrikut që ka qenë komandant Tahir Sinani. Faktikisht ky
3 dokument është data si qershor, si po e shoh 15 qershor. Në
4 fakt është 7, 7 qershor si dokument i shkruar.

5 PY. Komandant i brigadës thuhet këtu se ka qenë përgjegjës
6 për zbatimin e këtij vendimi. Cili ka qenë komandanti i
7 Brigadës 125 në atë kohë?

8 PË. Në këtë kohë ka qenë komandanti i brigadës Nehat Basha,
9 Brigadës 125.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
11 pranohet ky dokument.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
13 kundërshtime?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Nuk ka kundërshtime, dokument me numër 072639 -- të trija
17 faqet?

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. Të trija faqet dhe duhet të
19 jetë konfidencial për shkak të shënimeve që ka ky dokument.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Të trija faqet do të pranohen dhe do të marrin numrin
22 përkatës.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri i plotë që do të
24 pranohet është me numër 072639 deri në 072641 dhe përkthimi në
25 gjuhën angleze do të marrin numrin P01432 dhe do të mbeten

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 11

1 konfidencialë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të nxjerrim tani në ekran
4 dokumentin SPOE00229225.

5 PY. Ky dokument mban datën 27 mars 1999. Besoj se na e thatë
6 edhe dje këtë, po do ju pyes edhe një herë kush është Plaku?

7 PË. Plaku Xheladin Gashi.

8 PY. Çfarë përgjegjësish kishte ai?

9 PË. Ka qenë komandant i bazave në logjistikës në Shqipëri.

10 PY. Fushat e renditura në këtë shënim ishin pjesë e zonës së
11 tij të përgjegjësive?

12 PË. Po. Këto vende të cilat u çekën këtu janë vendet ku kanë
13 qenë edhe bazat e logjistikës në pjesën veriore të Shqipërisë
14 ku ai ka qenë përgjegjës për to.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet ky
16 dokument, i nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtime?

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po kundërshtoj për faktin që
20 dëshmitari nuk është autor i këtij dokumenti. As nuk thotë që
21 ka qenë i pranishëm kur është nënshkruar ky dokument.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
23 rrëzohet. Dokumenti me numër SPOE00229225 pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti dhe përkthimi
25 në gjuhën angleze marrin numrin e provës materiale P01433 dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 12

1 klasifikimi aktual është konfidencial.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë publik.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

4 Riklasifikoheni si dokument publik.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, në 1999 a kishte bazë UÇK-ja në Greme në
8 komunën e Ferizajt?

9 PY. Po mendoni në fshatin Greme? Po, ka qenë njësia e
10 Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës.

11 PY. Pjesë e cilës brigadë ishte?

12 PË. Ka qenë më duket e Brigadës 161. Si pjesë njësia e kësaj
13 brigade. E di për arsye se në 1999 në prill kam kaluar nëpër
14 atë vend edhe në këtë fshat.

15 PY. Kush ka qenë komandant atje?

16 PË. Nuk më kujtohet kush ka qenë komandant i njësisë, po aty
17 ka qenë zëvendëskomandanti i zonës me të cilin unë jam takuar
18 dhe kemi biseduar. Ka qenë z. Imri Ilazi.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen

20 tuaj dua që të dëshmitarit t'i lexoja një paragraf nga Shënimi
21 Përgatitor numër 2.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

24 PY. Paragrafi 26:

25 "[Dëshmitari] konfirmon se në 1999 Imri Ilazi krijoi një

1 bazë apo njësit të UÇK-së në Greme ... Ferizaj ... dikush që
2 njihej si 'Inxhinieri' qëndronte atje. Ai ishte bashkë me
3 Ilazin në Greme ... kur ka shkuar atje [Dëshmitari]".

4 Kështu?

5 PË. Po, aty ka qenë Imri Ilazi si zëvendëskomandant.

6 Inxhinieri, po, ashtu që ka qenë komandant aty, po tash s'më
7 kujtohet emri saktë kush është. Po zëvendësi po, se me të kam
8 pas kontakte dhe kemi bisedu.

9 PY. Faleminderit. Në prill të vitit 1999, a u krye një
10 evakuim i të plagosurve?

11 PË. Po.

12 PY. Nga cili në vend në cilin vend u evakuuan?

13 PË. Po në kohën e prillit kemi pasur shumë evakuime me shumë
14 zona. Po konkretisht në prill, më kujtohet mirë evakuimi i të
15 plagosurve nga zona e Drenicës në zonën e Pashtrikut. Për
16 shkak të ofensivave, që ka qenë jashtëzakonisht e fuqishme dhe
17 u dash që të plagosurit së bashku me pjesën e spitalit të
18 transformohen ose të barten prej zonës Drenicës në zonën e
19 Pashtrikut. Kështu që në atë kohë më kujtohet mirë dhe
20 transportimi i tyre prej kësaj zonës në zonën e Pashtrikut.

21 PY. Anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm kanë ndihmuar me këtë
22 evakuim

23 PË. Po. Mirë më kujtohet në atë kohë ka qenë Kadri Veseli dhe
24 Rexhep Selimi nga Shtabi i Përgjithshëm kur janë transferu
25 ata, këta të plagosur nga Drenica në zonën e Pashtrikut.

1 PY. Ku qëndronte në prill të 1999 Shtabi i Përgjithshëm? Më
2 parë kemi folur për periudhën nëntor në mars.

3 PË. Në prill, Shtabi i Përgjithshëm, një pjesë ka qenë në
4 Divjakë, një pjesë ka qenë në Devetak. Në fshatin, kur them
5 Devetak, në fshatin në pjesën e zonës së Nerodimjes.

6 PY. Dega politike edhe ajo ishte e bazuar aty apo qëndronte
7 diku tjetër në atë kohë?

8 PË. Jo, në prill si më kujtohet aty --

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtojmë. I nderuar Kryetar i
10 Panelit, ishte shumë e vagullt pyetja çfarë do të thotë "dega
11 politike"?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
13 kundërshtimi.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

15 PY. Mund të përgjigjeni.

16 PË. Në atëkohë --

17 PY. Dëshironi që ta përsëris pyetjen?

18 PË. Jo, ndëgjova. Në atë kohë aspekti kur them politik dhe që
19 ishte Qeveria e Përkohshme ishte z. Hashim Thaçi, dhe në atë
20 kohë veç kishte hy nga Maqedonia në territorin e Nerodimjes
21 dhe unë e kam takuar në zonën e Nerodimjes në Mollopolc.
22 Mollopolc, Petrov kjo pjesë.

23 PY. Atëherë ku ishit ju kur filloi fushata e bombardimit të
24 NATO-s dhe a mund të na shpjegoni dhe lëvizjen tuaj pas saj?

25 PË. Në fillimin e bombardimit të NATO-s, më 24 mars 1999, në

1 fillimin e saj kam qenë në komandën, domethënë, në objektin,
2 në zyrat e Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë. Me fillimin e
3 bombardimeve atëherë jam transferuar, kam dalë në pjesën e
4 Nishorit, në territorin e zonës së Pashtrikut, për arsye se në
5 këtë territor në këtë drejtim kishte filluar me fillimin e
6 bombardimit edhe sulmet e forcave serbe. Dhe kam shkuar në
7 këtë territor që t'i ndihmoj komandantit të kësaj zone që mund
8 të mbajë, të organizojë mbrojtjen më të mirë dhe tërheqjen e
9 popullatës nga fshatrat të cilat do të rrezikoheshin nga
10 luftimet në ato territore dhe ato drejtime.

11 Dhe aty kam qëndruar deri me një kohë luftimet që kanë
12 fillu prej 24 deri më 1 prill, deri tërheqjen në fshatin
13 Berishë, kur janë tërheq me pjesën e shtabit dhe pjesën e
14 njësive të zonës operative të Pashtrikut. Pastaj në Berishë
15 kam qëndruar një kohë, disa ditë, derisa është bërë mbrojtja e
16 Bjeshkës së Berishës nga sulmet e forcave serbe dhe një pjesë
17 të njësive të zonës operative të Pashtrikut, konkretisht
18 Brigadës 123. Kam dislokuar edhe Brigadën 124 dislokuar në
19 zonën e Budakovës dhe zonën e Nerodimjes për të forcuar këto
20 drejtime dhe për mujt me pas mbrojtjen e popullatës që ishte
21 koncentruar në atë drejtim.

22 Dhe pas kësaj kohe, janë transferuar në zonën e
23 Nerodimjes, ku në fshatin Devetak, kam organizuar zyrën
24 operative dhe pjesën ku mujt të përcjellim në mënyrë operative
25 të lëvizjeve të forcave tona dhe të forcave të kundërshtarit.

1 Dhe normalisht këtu jam taku edhe me Qeverinë e Përkohshme.

2 PY. Atëherë ju përmendët që keni qenë në një takim në

3 Mollopolc, për afërsisht kur ka ndodhur kjo dhe kush ka qenë

4 pjesë e atij takimi apo mbledhjeje?

5 PË. Në Mollopolc kemi qenë në takime, kam qenë unë ku kam

6 informue edhe Qeverinë e Përkohshme, gjendjen dhe situatën në

7 cillën gjinden në territorin e Kosovës në të gjitha zonat. Në

8 aty kam taku me Hashim Thaçi, ka qenë Ramë Buja, ka qenë

9 komandanti zonës të Nerodimjes, Agim Çeku dhe unë normalisht

10 të cilën kam bërë raportimin e gjendjes dhe situatës në

11 territorin e Kosovës.

12 Pas, në atë takim, kam shpjeguar komplet sesi është

13 situata në Kosovë. E di që, nuk e di, ditë të nesrit apo

14 pasnesrit kemi dalë së bashku me Hashim Thaçi e kemi vizituar

15 komplet civilët që ishin të strehuar në territorin e zonës së

16 Nerodimjes, nëpër pjesët e maleve. Dhe kemi vazhdu pastaj. Kam

17 vazhdu dhe riorganizimin e mbrojtjes së këtij territorit.

18 Dhe pas do ditë jam kthyer prapë në Berishë. Në Berishë

19 atje prapë kam takuar me komandantin e përgjithshëm për të

20 informuar për gjendjen e cila është në territor. Jam kthyer

21 prapë në zonën e Nerodimjes. Nuk më kujtohet ditë saktë, se ka

22 kalu kohë. Dhe jemi takuar në Jezercë dhe aty të na është bërë

23 ndërrimi mes meje dhe Agim Çekut.

24 PY. Faleminderit. Thjesht dëshiroj të pyes operacioni

25 Shigjeta u diskutua në një nga këto mbledhje apo takime?

1 PË. Po. Po, është diskutue, se kur kam shpjeguar për situatën
2 e cila është në territorin e Kosovës kanë shpjegu edhe për
3 Operacionin Shigjeta, të cilin u kanë njoftu edhe Hashim
4 Thaçin, po edhe Agim Çekun si për t'u njoftuar me situatën për
5 të qenë dhe ai i informuar se çka po ndodhë dhe kemi diskutuar
6 për atë, për operacionin se kur të fillon. Faktikisht, ai
7 kishte filluar veç ne kur jemi takuar. Se më 9 prill ka fillu
8 në Koshare. Dhe për të vazhduar pastaj me drejtime tjera të
9 cilat ishin të planifikuar si mbas planit të përpiluar nga
10 Shtabi i Përgjithshëm.

11 Në atë kohë, kemi diskutuar edhe me Agim Çekun për
12 strukturat se si do të jenë të këtyne njësive të operacionit,
13 sidomos Drejtimit Operativ numër 2 dhe personit të cilit do të
14 shkon të udhëheqë këtë drejtim në atë kohë. Kemi diskutue dhe
15 kemi përcaktue që të është Nexhmi Kastrati, ish-shef i shtabit
16 të zonës së Pashtrikut që kishte përvojë në udhëheqjen e
17 njësive operative dhe me grupin e oficerëve që të përgatitet
18 për të shkuar në Shqipëri dhe për të filluar me udhëheqë këtë
19 operacion në këtë drejtim.

20 PY. Atëherë thjesht për të qenë të qartë, më parë në
21 procesverbal u tha që komandanti i zonës së Nerodimjes, Agim
22 Çeku" --

23 PË. Jo, jo.

24 PY. -- po mos e keni fjalën për komandanti i zonës, Agim
25 Çeku, apo jo?

1 PË. Më falni, unë e ke shumë kjartë. Unë e ceka, komandanti i
2 zonës, pastaj Agim Çeku, domethënë, veçantë. Agim Çeku nuk
3 është komandant i zonës, as nuk ka qenë komandant i zonës.
4 Komandanti i zonës ka qenë Shukri Buja.

5 PY. Ju thatë që ka patur një takim të dytë në Jezercë. A mund
6 të na tregoni se kush ka qenë i pranishëm në atë takim?

7 PË. Takimi po që është mbajtur në Jezercë kemi qenun kështu,
8 kanë qenë pjesë edhe të Qeverisë së Përkohshme se atëherë veç
9 ishte dhe Qeveria e Përkohshme dhe një pjesë e anëtarëve të
10 Shtabit të Përgjithshëm. Në takim ishin, domethënë, ishte dhe
11 Hashim Thaçi edhe Kadri Veseli edhe ka qenë Adem Graboci, ka
12 qenë Agim Çeku. Më kujtohet më duket ka qenë edhe Sylejman
13 Selimi dhe disa anëtarë të tjerë kush s'më kujtohet mirë.

14 Në atë takim e kemi mbajtur, q'aty është bërë ndryshimi
15 mes meje dhe Agim Çekut. Unë e kam dorëzuar detyrën në q'atë
16 kohë Agim Çekut. Dhe kam marrë detyrën tjetër të shkoj në
17 Ministrinë e Mbrojtjes, ku t'i ndihmoj ministrit të mbrojtjes
18 të zhvillohet Ministria e Mbrojtjes dhe të udhëheqi
19 operacionet në Shqipëri të cilët ishin njësitë, ishin
20 mobilizuar njerëzit që kishin ardhë nga perëndimi për të
21 filluar -- për të vazhduar Operacionin Shigjeta.

22 PY. Faleminderit. Më parë ju keni thënë - në P01356-ET në
23 faqen 6049 në dëshminë Sainovic - që pasi u krijua Qeveria e
24 Përkohshme raportet për forcat e UÇK-së i dërgoheshin
25 Ministrisë së Mbrojtjes, është e vërtetë kjo?

1 PË. Po, është e vërtetë. Se veç që u formu qeveria filloi
2 Ministria e Mbrojtjes u formu dhe raportet normalisht i
3 dërgoheshin ministrit të Mbrojtjes. Se ashtu është në
4 rregullat që Shtabi i Përgjithshëm i jep raporte Ministrisë së
5 Mbrojtjes, i raporton për gjendjen dhe situatën që ka në
6 terren.

7 PY. A keni qenë i përfshirë në përpilimin e planit operativ
8 për Operacionin Shigjeta?

9 PË. Po.

10 PY. A mund të më tregoni se kur u përpilua plani dhe cili ka
11 qenë objektivi i këtij operacioni?

12 PË. Po. Duke marrë parasysh qysh në janar të vitit 1999, pas
13 ndodhjes së masakrës në Reçak, atëherë na u ka qenë shumë
14 kjartë për ne që forcat serbe nuk do të qëndrojnë qetë dhe
15 duhet të ketë sulmet e tjera dhe do të mund të vijmë në
16 situatë shumë të palakmueshme. Atëhere së bashku me drejtorinë
17 operative dhe Shtabin e Përgjithshëm kemi fillu përpilimin e
18 këtij plani dhe të quajtur plan ose operacion për hapjen e
19 korridoreve të cilët do të hapshin korridoret nga drejtimi
20 Shqipërisë për në Kosovë për të furnizuar edhe Ushtrinë
21 Çlirimtare të Kosovës me municiona, ushqime, po edhe
22 popullatën edhe me ushqime edhe medikamente. Njashtu në këtë
23 plan është paraparë që me hyrjen dhe frymën korridoreve,
24 forcimin e njësive të mbrendshme të fillon pastaj dhe çlirimi
25 i territorit të Kosovës nga forcat serbe.

1 PY. Faleminderit. Dhe me pak fjalë a mund të më shpjegoni se
2 cila ka qenë struktura e komandës për Operacionin Shigjeta?
3 PË. Operacioni ka qenë i parapamë në tri drejtime: Në
4 drejtimin e parë ka qenë në Koshare, drejtimi i dytë në malet
5 e Pashtrikut dhe drejtimi 3 në drejtimin e Koritnikut. Në atë
6 kohë vetëm dy drejtimet kanë qenë aktive: Kjo e Kosharës dhe e
7 Pashtrikut. Komandat e drejtimit të Kosharës ka qenë në
8 Kosharë, Drejtimin Operativ numër 2 ka qenë në Pashtrik,
9 konkret në Cahan. Kurse komanda për operacionet të gjithë ka
10 qenë në Kukës, të cilën e kam udhëhequr unë. Dhe kjo komandë
11 ka qenë e vendosur në një shtëpi private në Kukës, ku nga aty
12 është bërë koordinimi dhe udhëheqja e tyre operacioneve në
13 këto dy drejtimet operative.
14 PY. Dhe a mund të na tregoni, ju lutem, se kush ka qenë
15 komandanti për Drejtimin Operativ numër 1 dhe për atë numër 2?
16 PË. Drejtimi numër 1 ose Brigada 138 e cilën u shndërru, ka
17 qenë Rrustem Berisha. Kurse komandant i Drejtimin Operativ
18 numër 2 ka qenë Nexhmedin Kastrati.
19 PY. Faleminderit.
20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran
21 SPOE00228147. Faleminderit.
22 PY. Pasi hynë në Kosovë forcat e Operacionit Shigjeta, a
23 ndryshoi komanda? Më falni se nuk ka lidhje me dokumentin.
24 Thjesht po ju bëj një pyetje tjetër pas atyre që ju bëra më
25 parë.

1 PË. Po. Se ashtu ka qenë e planifikuar dhe me plan. Me hyrjen
2 e forcave të Operacionit Shigjeta në territorin e Kosovës dhe
3 bashkimin me forcat e brendshme, komanda e operacioneve ku unë
4 e komandonte, shuhet dhe eprorët transferohen dhe barten në
5 pjesën e Shtabit të Përgjithshëm ose në dispozicion të Shtabit
6 të Përgjithshëm. Unë kthejna prapë, jam kthyer në Ministrinë e
7 Mbrojtjes. Njëjtë ashtu komanda e Drejtimit Operativ numër 2
8 ashtu me hyrjen mbrenda është transformuar dhe del në
9 dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm për nevojat e saj. Dhe
10 të gjitha ato njësitë hyjnë nën komandën e Shtabit të
11 Përgjithshëm dhe vazhdojmë më tutje. Normalisht edhe
12 ndryshimet këto ishin, po folim prej operacionit në përfundim
13 në qershor.

14 PY. Pra, forcat do të hynin dhe do të ishin më pas pjesë e
15 komandës së Shtabit të Përgjithshëm, a është e saktë kjo?

16 PË. Po. Po me hyrjen në territorin e Kosovës dhe bashkimin me
17 forcat e tjera, ajo menjëherë hyn nën Shtabin e Përgjithshëm.

18 PY. Faleminderit. Tani t'i kthehemi dokumentit që shikoni në
19 ekran. A e njihni vulën lart në të djathtë?

20 PË. Po. Është vula e Shtabit të Përgjithshëm.

21 PY. Sipas jush çfarë është ky dokument? Dhe madje mund t'i
22 kalojmë edhe faqet njëra pas tjetrës që ta shikoni të gjithë
23 dokumentin.

24 PË. Ky është një organigramë i zhvillimit të Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës të cilët është parapa. Unë besoj që këto

1 organizime kanë mund të bëhen vetëm pas luftës. Se si po shof
2 këtu kemi dhe shumë njësi të cilat dhe gjatë luftës nuk kemi
3 mujt t'i arrisim t'i bëjmë. Nuk e besoj qëkur s'kam mujt t'i
4 arrij unë deri para bombardimit t'i bëjë të gjitha këto,
5 atëherë s'ka mujt edhe gjatë bombardimit edhe luftimeve t'i
6 bën dikush, t'i zhvillon këto njësi. Ka mund t'i ndryshojë
7 emrat vetëm disa njësive.

8 Për t'i zhvilluar të gjitha këto njësi të duhet goxha
9 kohë dhe goxha veprim. Veç unë besoj që ky organizim ose kjo
10 strukturë është bërë pas çlirimit.

11 PY. Këtu përmendet garda kombëtare, a e dini se kur është
12 krijuar ajo?

13 PË. Kjo ka filluar qysh gjatë periudhës diku majit, prill-
14 maj, nuk e di tash saktë. Po zakonisht në këto njësi të gardës
15 janë transferuar njësi të cilat kanë qenë njësi të reagimit të
16 shpejtë dhe vëzhguese edhe si në shtab, si në zonë dhe i ka
17 shndërru të quajtur si garda kombëtare si bazë të cilat do të
18 zhvillohet garda kombëtare prej asaj kohe. Dhe çka di unë ajo
19 ma së shumti ka filluar të zhvillohet pikë pas luftës se s'ka
20 mujt të zhvillohet gjatë luftës.

21 PY. Kush u vu në krye të zhvillimit të mëtejshëm të gardës
22 kombëtare?

23 PË. Në atë kohë, sa më kujtohet, është vendosur Sylejman
24 Selimi.

25 PY. Dhe a e njihni këtu firmën në faqen e fundit të këtij

Dëshmitari: Bislrim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 23

1 dokumenti?

2 PË. Po, po e shoh.

3 PY. A mund të na thoni se i kujt është ky nënshkrim, të
4 lutem?

5 PË. Ndoshta i Hashim Thaçit.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dokumenti, nga pjesa e sipërme,
7 ka datën 14 maj të faksit 1999 dhe kërkoj që të pranohet nga
8 Gjykata.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të kërkoja që të ishte një
10 formë provizore sepse mendoj që dy faqet e para janë
11 relevante, ndërkohë që ne kur të bëjmë kundërpjetjet duhet të
12 jetë i gjithë dokumenti.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mendoj që çfarëdolloj faqesh të
14 tjera shtesë mund t'i shtohen numrit përkatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
16 [Përkthim] E kuptoj kërkesën tuaj. Dhe jam dakord me atë që
17 tha Prokurorja, pra, faqet mund të shtohen më pas dhe mund t'i
18 pranojmë të gjitha të plota.

19 Por për momentin SPOE00228147 pranohet. Dhe të jetë
20 konfidenciale apo publike?

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë të
23 riklasifikohet si dokument publik.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë e gjithë numri
25 ERN për procesverbalin është SPOE00228147 deri në

1 SPOE00228151, i cili së bashku me përkthimin në gjuhën angleze
2 pranohet si provë materiale, P01434 dhe riklasifikohet si
3 dokument publik. Faleminderit.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që në ekran të vendoset
5 dokumenti SPOE00228188. Dokumenti mban datën 27 maj 1999. A
6 mund të kalojmë tek faqja e dytë e këtij dokumenti që
7 dëshmitari të shikoj vulën dhe nënshkrimin.

8 PY. A i njihni ato, Dëshmitar dhe a mund të na i shpjegoni
9 ato?

10 PË. Vula është e Shtabit të Përgjithshëm. Është nënshkrimi i
11 Agim Çekut.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani mund të kalojmë tek faqja e
13 parë e këtij dokumenti.

14 PY. Pra, ju keni përmendur tashmë që pasi u krijua Qeveria e
15 Përkohshme dhe pate Ministrinë e Mbrojtjes gjatë kohës që ju
16 ishit në Shqipëri, sa informacion merrnit ju për forcat që
17 ishin brenda në Kosovë?

18 PË. Unë, nuk ka qenë më detyra ime që të marrë unë raportet
19 ose brenda prej shtabit. Prej shtabit ça mujt të marrë në atë
20 kohë ka qenun për pozicionet e forcave serbe, për shkak që më
21 ka interesu për shkak të operacionit. Kurse raportet e tjera
22 nuk kanë ardhë te unë. Ato kanë shku te ministri i mbrojtjes.
23 Po si kanë shku dhe si përpunu nuk e di më tutje.

24 PY. Pra, në paragrafin 2 mund të shikojmë që bëhet një, i
25 referohet këtu forcave serbe që reagojnë ndaj Operacionit

1 Shigjeta dhe më poshtë në atë faqe në numrin 3 shihet që
2 flitet për forcat e UÇK-së të përfshira në Operacionin
3 Shigjeta. Ky informacion a është i saktë mesa njohuri keni ju?
4 Dhe data është 27 maj.

5 PË. Po. Si informacion forcat serbe dhe lëvizjet e forcave
6 tyre ne në këto drejtime, në drejtim në Operacionit Shigjeta,
7 po, janë të sakta.

8 PY. Dhe sa i përket forcave të UÇK-së në numrin 3, a është e
9 saktë këtu që përmendet Milaj, Gorozhup dhe Planej si fshatra?

10 PË. Po mendoni granatimet që janë bërë në këto fshatrat si
11 mbas këtij raporti? Si mbas këtij raporti?

12 PY. Jo, më falni. Kam kaluar tek pika numër 3 dhe në rreshtin
13 e fundit të kësaj faqeje përshkruhen forcat e UÇK-së në
14 fshatrat përkatëse.

15 PË. Po, po e shof aty. Po nuk është kjo e saktë për shkak se
16 në atë kohë kur, 27, forcat tona nuk kanë arritur të shkojnë
17 në Gorozhup dhe në Planej, në Milaj po.

18 PY. Faleminderit.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe atëherë me këtë sqarim që u
20 bë, kërkoj që të pranohet ky dokument.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
22 kundërshtime?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
25 meqenëse nuk ka kundërshtime, dokumenti SPOE00228188 pranohet

1 dhe do të riklasifikohet si dokument publik.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i
3 nderuar. Atëherë për procesverbal, numri i plotë është
4 SPOE00228188 deri në SPOE00228189 dhe së bashku me përkthimin
5 në gjuhën angleze, do të marrin numrin e provës material
6 P01435 dhe do të jetë dokument i riklasifikuar si publik.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A do të bëhet pushim tani prej
9 dhjetë minutash?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rast se
11 dhe ju mendoni që duhet bërë ky pushim tani?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
14 të bëjmë një pushim prej dhjetë minutash. Ju lutem mos flisni
15 me askënd tjetër për gjërat që janë diskutuar këtu dhe mund të
16 shoqëroheni tani nga Asistentja e Seancës.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pushim për
19 dhjetë minuta.

20 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

21 --- Seanca rifillon në orën 10.10

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
23 Prokurore, ju lutem, herë tjetër kur kërkonit që të pranohen
24 dokumentat përmendeni numrin e plotë të dokumentit. Kjo është
25 për saktësi në procesverbal. Faleminderit.

1 Tani mund të sillni dëshmitarin.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Znj. Prokurore, mund të vijoni.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Ju lutem tani të
6 shfaqet në ekran materiali me numër SPOE00227562. Është një
7 dokument vetëm me një faqe, kështu që ky është numri i vetëm
8 që ka ky dokument.

9 Data e dokumentit është 17 maj 1999.

10 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet blerja e armëve që përshkruhet
11 në këtë dokument?

12 PË. Më kujtohet në përgjithësi blerja e armëve, po edhe këto
13 armë të cilat janë ble, më kujtohet edhe ardhja e tyre.

14 PY. Për çfarë ishin këto armë dhe a u morën si përfundim?

15 PË. Këto armë janë konë të nevojshme për nevojat e
16 operacionit. Për shembull, armë të cilat janë këtu llojet, e
17 para për shembull, është kundërajrore, të cilat ka pasë
18 nevojë. E dyta, njësitë anti-tank, që është e nevojshme për
19 njësitë anti-tank, ose është njëjta njësiat -- këto armët
20 anti-tank edhe Zola është njësi anti-tank. Të gjithë ato janë
21 njësi -- tre, e dyta, e treta dhe e katërta janë armët anti-
22 tanke që ka pas nevojë të kemi.

23 Në tjetrin grup, është një grup snajperi, të cilat ka
24 pasë nevojën, që të ketë në njësi, dhe këto janë blerë në
25 vende të ndryshme të botës edhe është dashtë të hyjnë në

1 Shqipëri, si po shoh si dokument që i është drejtuar Qeverisë
2 së Shqipërisë. Unë e di që këto armët kanë hy ndoshta brenda,
3 mirëpo te na nuk kanë mujt me mbërrirë se derisa ka mbërrit
4 këto armë është përfunduar edhe lufta. Edhe ato kanë mbetur në
5 depot e tyre.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që të
7 pranohet ky dokument, edhe mund të jetë publik.

8 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
9 kundërshtime?

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
12 SPOE00227562 pranohet, dhe riklasifikohet si dokument publik.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti bashkë me
14 përkthimin në anglisht do të marrë numrin e provës P01436 dhe
15 do të riklasifikohet si dokument publik. Faleminderit.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, për pyetjet e
17 radhës do të doja që të kalonim në seancë private për shkak të
18 klasifikimit që mbajnë dokumente.

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Kalojmë në seancë private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 29

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 30

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 31

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 32

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 33

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 34

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 35

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 36

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 37

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 38

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 39

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 40

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 41

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 42

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, tashmë jemi
22 në seancë publike.

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

25 PY. Kam disa pseudonime apo nofka si edhe disa çështje të

1 tjera për të cila dëshiroj t'ju pyes ju sot. A e njihni emrin

2 Bashkim Fino?

3 PË. Po.

4 PY. Kush është Bashkim Fino, a jeni takuar me të, dhe nëse

5 po, ku?

6 PË. Bashkim Fino ka qenë epror i komandës së Brigadës 121. E

7 kam takuar në komandën e Brigadës 121 në Bjeshkët e Berishës.

8 PY. A e dini emrin e tij të saktë?

9 PË. Më duket që e ka emrin Naser.

10 PY. A e dini se kush është Fytyra?

11 PË. Po, e di. Edhe ai është epror i Brigadës 121 dhe e kam

12 taku te komanda e Brigadës 121.

13 PY. Po emrin e tij të vërtetë e dini?

14 PË. Po, por për momentin nuk po kujtohet tash se po më

15 përzihen, emrat i kanë të shumta.

16 PY. Nuk ka problem, se dëshirojmë të na thoni vetëm gjërat që

17 vërtetë mbani mend. Van Dami?

18 PË. Po, Van Dami njëjtë është. Ka qenë një ndër ushtarët ose

19 eprorët e komandës 121. Këtë ma shumë e njoh se në fillim të

20 qershorit kur ka bërë trajnimet e njësive për reagimE të

21 shpejta Agim Çeka, Van Dami ka qenë në atë njësi që është

22 trajnuar edhe pastaj është kthyer në Brigadën 121 dhe ka

23 udhëheq këto njësitë në Brigadën 121. Domethënë aty e kam

24 takuar. Emrin tash për momentin s'po më kujtohet. Emri i

25 vërtetë.

1 PY. Atëherë po ndryshoj pak temë. Ku ka qenë shtabi i zonës
2 së Drenicës në verën e vitit 1998?

3 PË. Shtabi i zonës së Drenicës një herë ka qenë në Likovc.
4 Pas ofensivës së verës atëherë është transferuar në fshatin
5 Abri, dhe aty ka qëndruar. Në këto dy vende ka qenë shtabi
6 kryesor ose komanda e shtabit të zonës operative të Drenicës.

7 PY. Dhe thjesht meqenëse nuk jam shumë e qartë nëse në
8 përkthim u përmend emri i fshatit të dytë siç duhet, a mund të
9 na jepni emrin e plotë të fshatit nëse e dini ju lutem?

10 PË. Gjatë ofensivës, luftimeve, kanë lëviz shpesh komandat.
11 Herë ka qenë -- në fillim ka qenë në Likovc një kohë e gjatë,
12 pastaj në Baicë, [E pakuptueshme] Abri, domethënë këto janë
13 fshatrat të cilët më së shumti ka qenë komanda e zonës të
14 Drenicës.

15 PY. Faleminderit. Kush ka qenë Bekim Berisha?

16 PË. Bekim Berisha ka qenë një ndër eprorët të cilët ka pas
17 një përvojë jashtëzakonisht të madhe të luftës. Bekim Berishën
18 përndryshe ka qenë edhe në luftërat edhe të Kroacisë edhe
19 Bosnjës. Ndryshe në fillim të luftimeve në Kosovë, në fillim
20 ka qenë në territorin e Drenicës dhe ai ka bërë ushtrime dhe
21 përgatitje të njësisë të reagimit të shpejtë në Drenicë,
22 ndryshe të quajtur Brigada 111, ose Brigada Adem Jashari. Këtë
23 njësi e ka trajnu edhe e ka përgatitur.

24 PY. Ku ka qenë e vendosur ajo njësi?

25 PË. Njësi ka qenë i vendosur në Arbri.

1 PY. Cilat ish-in brigadat e vendosura në Reti?

2 PË. Në Reti janë vendosur në vitin 1999, domethënë, 1998,
3 1999 brigadat -- Brigada 125, komanda e saj. Komanda e
4 Brigadës 124 dhe komanda e Brigadës 126.

5 PY. A ka patur sulme nga serbët pak pasi ka filluar
6 bombardimi i NATO-s?

7 PË. Po, me fillimin e bombardimit të NATO-s menjëherë i kanë
8 filluar forcat serbe sulmin, sidomos në zonën -- në të gjitha
9 zonat, po fillimi i lëvizjes ka qenë Pashtrik që ka shkuar
10 prej drejtim të këtyne brigadave që përmenda, Brigadës edhe
11 125, edhe 124, edhe 126. Në drejtim edhe të Retisë, edhe në
12 drejtim të fshatrave të brendësisë të kontrollit të cilat i ka
13 pasë zona operative e Pashtrikut.

14 PY. A ka pasur sulme gjithashtu edhe në Shalë pak përpara se
15 të fillonte bombardimi i NATO-s?

16 PË. Me fillimin e bombardimit njëjtë ashtu kanë fillu edhe
17 sulmet edhe në drejtim të Shalës, zonës së Shalës -- zonës së
18 Shalës. Ashtu ka fillu sulmi edhe në zona të tjera. Edhe
19 Drenicës, edhe e Dukagjinit edhe të Nerodimës.

20 PY. Njësitët nga zonat e tjera kanë shkuar për të ndihmuar në
21 Shalë?

22 PË. Në fillim kur ka filluar sulmet e para në drejtim të
23 Çiçavicës, po, kanë qenë njësitë, kanë ndihmuar njësitë e
24 zonës operative të Drenicës të cilët i kanë ndihmuar zonës
25 operative të Shalës për të ndalë sulmet serbe në atë drejtim.

1 PY. Ditën e hënë ne folëm për rolin e Azem Sylës dhe se si ky
2 roli, pozicioni ishte sekret. Me çfarë njohuri kishit ju, a e
3 dinte Azem Sylja për Sylejman -- ose Sylejman Selimi do ta
4 dinte që Azem Sylja ka qenë komandant në atë kohë? "Ai" e kam
5 fjalën gjithmonë për Selimin.

6 PË. Nuk e di. Unë për vete e kam dit mbrenda kur kam hy, kur
7 kam -- kur jam vendos në detyrën e drejtorisë operative që
8 Azem Sylja është komandanti i përgjithshëm, kurse Sylejman
9 Selimi nuk -- simbas asaj që kam pas reagimin pastaj që ai nuk
10 e ka ditur që Azem Sylja është komandant i përgjithshëm. Unë e
11 kam menduar se komandantët e zonave kanë qenë më herët të
12 vendosun dhe ata kanë pas ditun, por unë nuk e kam ditur që
13 ata s'e kanë ditur.

14 PY. Faleminderit. Dëshmitar, ky është fundi i pyetjeve që kam
15 unë. Faleminderit për vëmendjen që treguat.

16 Dhe dëshiroj të falënderoj edhe Sekretaren e seancës për
17 të gjithë dokumentet që na bëri të mundura në ekran.

18 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe tani mund
19 të vijojmë me kundërpyetjet.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Jam gati.

21 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Mirëmengjes, Dëshmitar, z. Zyrapi. Unë quhem Luka
24 Misetic dhe jam Avokati i Mbrojtjes së z. Thaçi. Kam goxha
25 pyetje për ju, kështu që do të përpiqem që të bëhen sa më

1 shumë pyetje që jetë e mundur, por shumicën e pyetjeve jam
2 përpjekur që t'i shpreh në një mënyrë të tillë që ju të keni
3 mundësinë të përgjigjeni me "po" ose "jo". Në këtë mënyrë do
4 të ndihmojmë që këtë lloj materiali që kam unë ta kalojmë me
5 sa më shumë shpejtësi që të jetë e mundur, dhe që të mbaroj,
6 pra, kundërpjetet, e mia sa më shpejt që të mundur.

7 Në rast se do të kërkojmë ose do të kemi nevojë që ju të
8 na shpjegoni diçka në përgjigjen tuaj, do t'ua kërkojmë këtë
9 gjë dhe do të keni mundësinë që të shtjelloheni për një
10 çështje të caktuar. E pranoni këtë gjë? Mendoni që është e
11 pranueshme?

12 PË. Mirëmëngjesi. Jam i gatshëm t'i jap të gjitha përgjigjet
13 ato ç'ka i di.

14 PY. Okej. Z. Zyrapi më lejoni që të filloj me këtë pyetje: Ju
15 jeni një oficer me përvojë ushtarake. Është e saktë kjo? Jeni
16 dakord me të?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe ju keni qenë oficer në tre ushtri të ndryshme, apo
19 jo?

20 PË. Po.

21 PY. Ju keni qenë në akademinë e lartë të ushtrisë jugosllave,
22 apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. A jeni dakord me mua kur them që me -- sipas njohurive që
25 keni jo të gjitha e botës vënë në shënjestër bashkëpunuesit,

1 dhe për këtë arsye për shembull kanë edhe shërbimet e
2 kundërzbulimit?

3 PË. Bën ta kjarhtësoni këtë pyetje pak, se nuk është bash e
4 kjarhtë pyetja.

5 PY. Pra, të gjitha ushtritë dhe sistemet në të cilat
6 funksionojnë ato kanë shërbime të kundërzbulimit. Është e
7 saktë kjo?

8 PË. Po, është e vërtetë.

9 PY. Dhe pjesë e detyrave të kundërzbulimit është që të
10 zbulojnë bashkëpunëtorët potencialë në rangjet e tyre. Është e
11 saktë kjo?

12 PË. Po, shumë e saktë.

13 PY. Pra, në parim a jeni dakord me mua që nuk ka asgjë të
14 gabuar. Në parim, gjithnjë, në parim, që një ushtri kërkon se
15 cilët janë bashkëpunëtorët?

16 PË. Po, është e saktë.

17 PY. A jeni gjithashtu dakord me mua që ajo që do të ishte
18 gabim që të kërkonin bashkëpunëtorë dhe pastaj të abuzonin me
19 të drejtat e njeriut duke i torturuar, duke i rrahur, duke i
20 vrarë, gjëra të kësaj natyre?

21 PË. Po.

22 PY. Okej. Ju vetë a keni qenë ndonjëherë në dijeni të ndonjë
23 marrëveshjeje qoftë me të shprehur ose jo, brenda për brenda
24 Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe
25 në të cilën të ketë qenë i përfshirë z. Thaçi për të abuzuar

1 të drejtat e njeriut ose bashkëpunëtorëve ose personave që
2 perceptoheshin si kundërshtarë të UÇK-së?

3 PË. Jo.

4 PY. A keni qenë ndonjëherë në dijeni të ndonjë marrëveshjeje
5 të shprehur ose jo, për të frikësuar në mënyrë të paligjshme
6 persona që janë perceptuar si bashkëpunëtorë ose kundërshtarë
7 të UÇK-së ose për të kryer dhunë kundër tyre ose për t'i
8 hequr, larguar ata në mënyrë që UÇK-ja të merrte pushtetin në
9 Kosovë?

10 PË. Jo.

11 PY. Okej. Dëshiroj tani që të kaloj tek tema e përkufizimit,
12 ose më lejoni të filloj ndryshe. Në verën e vitit 1998, a do
13 të ishte e drejtë të thosha që ajo që keni parë ju nga UÇK-ja
14 është që ka qenë një organizatë e paorganizuar dhe jo e
15 centralizuar?

16 PË. Po.

17 PY. A do të ishit dakord me mua që në verën e 1998, vetë
18 Shtabi i Përgjithshëm ka patur probleme për t'u mbledhur për
19 t'u takuar dhe për të funksionuar në një formë të unifikuar?

20 PË. Po.

21 PY. Tani, ju vetë, a keni patur një përkufizim të
22 bashkëpunëtorit, pra çfarë është bashkëpunëtori?

23 PË. Po përkufizimet -- në cilin aspekt të bashkëpunëtorit, të
24 jemi më të kjartë pak.

25 PY. Okej. Do t'ju lexoj përgjigjen që dhatë ju kur këtë

1 pyetje jua ka bërë ZPS-ja.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe ju thatë - dhe bëhet fjalë për
3 P01355.5 në faqen 2, dhe rreshtat 15 deri në 25.

4 PY. Ju keni thënë:

5 "Unë mund të flas vetëm nga këndvështrimi ushtarak. Një
6 person që është kolaboracionist i armikut dhe pjesë e njësisë
7 i bie që jep informacion për njësinë për sa i fortë -- është e
8 formë është njësia, sa e përgatitur është ajo dhe sa kapacitet
9 ka njësiti për të vepruar, dhe ky është informacion për
10 armikun se si ta shkatërrojë këtë njësi."

11 Është e saktë?

12 PË. Po, e saktë është.

13 PY. Dhe ju i keni thënë ZPS-së që ky është përkufizimi jua
14 profesional për kolaboracionistin ose bashkëpunëtorin. Është e
15 saktë kjo?

16 PË. Po.

17 PY. Okej. Më pas pyetja që u bë ishte kjo: Një civil a mund
18 të ishte pjesë e këtij përkufizimit të këtij
19 kolaboracionistit? Dhe ju thatë --

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe kjo është nga dokumenti me
21 numër P01355.5, në faqen 3, rreshtat 7 deri në 12.

22 PY. "Në zonën e kontrollit një civil mund të perceptohet si
23 kolaboracionist". Dhe këtë dëshiroj që ta shpjegojmë. Çfarë e
24 -- për çfarë e keni fjalën kur thoni një civil në zonën e
25 kontrollit ose në zonën e kontrolluar, pra mund të ishte pjesë

1 ose subjekt i këtij përkufizimi?

2 PË. Kur thuhet këto domethënë për civil i cili ose civili i
3 cili është bashkëpunëtor i armikut, ai njëjtë është sikur
4 është brenda radhave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo
5 është jashtë saj, ai do të jep informacionet për lëvizjet e
6 forcave tona armikut, njëjtë domethënë, bashkëpunëtor i
7 armikut. Domethënë, klasifikohet gati të njëjtën se është
8 bashkëpunëtor i tij. Pa marrë parasysh a është i veshur në një
9 njësi, a është civil.

10 Dhe në qoftë se është civil [E pakuptueshme] konkret në
11 to, ai i përcjell lëvizjet tona dhe e informon armikun në
12 lëvizjet tona dhe normalisht jo vetëm lëvizjet tona, po edhe
13 ç'ka kemi brenda, edhe cilat janë armët, edhe cilat janë
14 njësitë, edhe sa janë, edhe të gjitha. Është e barabartë,
15 është bashkëpunëtor.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryetar.

17 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
18 Dëshmitar, është koha për të bërë pushimin prej gjysmë ore siç
19 e bëjmë çdo ditë në orën 11.00. Mund të largoheni nga salla
20 dhe ju lutem mos flisni me askënd për të dëshminë tuaj këtu në
21 sallë. Do të rikthehemi në sallë në orën 11.30.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
24 orën 11.30.

25 --- Pauza fillon në orën 11.02

1 --- Seanca rifillon në orën 11.30

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokati
3 Kujdestar ka pak probleme kur iu referoheni faqeve se ai ka
4 vetëm numrat ERN. Kështu që, ju lutem, kur të citoni një
5 dokument jepni dhe numrin ERN sepse ai nuk i gjen dot. E
6 kuptoj që është pak ngarkesë për ju, por, ju lutem, përpiquni
7 ta bëni.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Patjetër. Atëherë, do i kërkoj
9 Trupit Gjykes të japë një çikë më shumë kohë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të japim një
11 minutë më shumë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Por e kuptoni, unë dua më shumë
13 kohë për të cituar numrin ERN.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj, por
15 duhet t'i japim edhe atij mundësinë që të na ndjekë.

16 Në rregull. Sillni dëshmitarin në sallë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] T'ju pyes dhe një herë, ai e ka
18 paketën e plotë të intervistave të ZPS-së?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, a mund t'i referohem
21 thjesht duke thënë Pjesa 1, Pjesa 2, Pjesa 3? Se mbase kështu
22 mund të jetë më e thjeshtë për atë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për këtë
24 autoriteti është [REDAKTUAR].

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë.

2 Z. Avokat, e kuptojmë vështirësinë që keni ju, dhe do
3 përpigemi ta zgjidhim me aq sa të mundemi.

4 Faleminderit.

5 Z. VANREUSEL: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

7 Tani për hir të Avokatit Kujdestar, unë do t'i drejtohem
8 intervistës së ZPS-së me pjesë.

9 PY. Dëshmitar, vazhdojmë aty ku e lamë para pushimit. Nëse të
10 kujtohet, unë po ju pyesja për përkufizimin tuaj profesional
11 të kolaboracionistëve ose bashkëpunëtorëve. Dhe ju na e
12 shpjeguat nga këndvështrimi ushtarak, që mund të ketë edhe
13 ushtarë brenda njësive dhe mund të ketë edhe civilë të një
14 zone që mund të jenë bashkëpunëtorë, në një zonë të
15 kontrolluar. Pra, mund të ketë persona kolaboracionistë edhe
16 në një zonë të kontrolluar.

17 Tani, pyetja e radhës që kam unë është kjo: A kanë qenë
18 këto përkufizimet që keni zbatuar ju kur u bëtë shefi i
19 shtabit të UÇK-së, sa i takon, gjithmonë, bashkëpunëtorëve?
20 PË. Po.

21 PY. Pasi u bëtë shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ju
22 lëshuat një urdhëresë më 28 nëntor 1998, ku jepnit udhëzime se
23 si të trajtoheshin bashkëpunëtorët, kështu?

24 PË. Udhëzim? Më fal, cilin urdhër?

25 PY. Po ua lexoj. Keni dhënë udhëzime se keni marrë ankesa nga

1 persona, nga komandantët e zonave, për sjelljen e ushtarëve në
2 terren. Pra, keni dhënë urdhër disiplinor, keni nxjerrë një
3 urdhër disiplinor për sjelljen e tyre.

4 PË. Mendoni -- për urdhrin e 28 nëntorit, po.

5 PY. Po, po. Për atë.

6 PË. Po.

7 PY. Dhe ju thoni, "pasi u konsultova me komandantin e
8 përgjithshëm, kështu?

9 PË. Po, kjartë.

10 PY. Që të jemi të qartë, komandanti i përgjithshëm këtu ishte
11 Azem Sylja?

12 PË. Po.

13 PY. Mirë. Më pas, keni pasur një takim në vijim të këtij
14 udhëzimi. Dhe takimin e keni pasur me komandantët e zonave për
15 t'ua shpjeguar këtë udhëzim, kështu?

16 PË. Jo vetëm për këtë udhëzim, por të -- takimi ka qenë i
17 përgjithshëm, edhe për, dhe strukturimin e shtabit edhe
18 ushtrisë. Ka qenë edhe strukturimet e tjera, nevojat,
19 kërkesat. Nuk është vetëm takimi që ka qenë veç për këtë
20 çështje.

21 PY. Do t'u lexoj çfarë i keni thënë ZPS-së.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Është prova materiale P01355.5.

23 Dhe për Avokatin Kujdestar është Pjesa 5, faqja 13.

24 PY. Vazhdoni dhe thoni:

25 "Komandantët e zonave nuk ishin në këtë takim.

1 "PË. Po, nuk ishin, erdhën më vonë.

2 "PY. Pra, erdhën më vonë në një takim tjetër?

3 Ju përgjigjeni:

4 "Po, në një takim tjetër. Ka pasur dhe takime të tjera me
5 komandantët e zonave.

6 "PY. A e diskutuat çështjen e kolaboracionistëve atje?

7 "PË. Edhe kjo u diskutua.

8 "PY. A mund t'ju pyes nëse kishin pyetje komandantët e
9 zonave se si ta ushtronin këtë në praktikë?

10 "PË. Ua shpjegova edhe në praktikë, se si duhet ta
11 zbatonin këtë urdhëresë në praktikë. Ua shpjegova që nëse do
12 të kishte dyshime, atëherë personi..."

13 Ka bërë një sqarim përkthyesi aty.

14 Dhe thoni, mund të dërgohej tek sektori juridik. Ia keni
15 thënë këtë komandantëve të zonave se si duhet të trajtonin
16 rastet e bashkëpunëtorëve?

17 PË. Po.

18 PY. Ajo që keni dash të bëni ju është që një person që
19 dyshohet si bashkëpunëtor duhet të kalonte përmes një procesi
20 juridik dhe do të dilte para gjykatës, apo jo?

21 PË. Po, para sektorit juridik.

22 PY. Sektori juridik është krijuar në nëntor të 1998, kështu?

23 PË. Ka filluar në ato, por domethënë thuajse gati dhjetori,
24 janari.

25 PY. A është e saktë të themi që krijimi i sektorit juridik ka

1 qenë një pjesë e procesit të -- strukturimit profesional të

2 UÇK-së me mbërritjen tuaj?

3 PË. Jo veç me mbërritjen time, kam mbërri edhe ma herët se

4 kur ka fillu ky strukturimi, por nevoja dhe kërkesa në q'atë

5 kohë kur është bo. Për arsye se ne ma herët s'kemi mujt me i

6 bo këto strukturime për shkak të ofensivave serbe që kanë qenë

7 të verës 1998. Dhe tek, domethënë, në këtë periudhë prej

8 nëntorit kemi fillu ristrukturimin e Ushtrisë Çlirimtare të

9 Kosovës simbas nevojave që është paraqit në atë kohë, dhe po

10 në atë kohë, domethënë, kemi fillu edhe këtë sektor ta

11 zhvillojmë.

12 PY. Do flasim dhe për të gjitha këto aspekte për të kuptuar

13 çfarë ndodhi në verë dhe pse nuk e krijuat atëherë sektorin

14 juridik.

15 Por a mund të them kështu që, mesa kuptuat ju, sektori

16 juridik do të ishte përgjegjës për të mbikëqyrur të gjithë

17 procesin e hetimit të bashkëpunëtorëve dhe të bënte një

18 vlerësim se kush ishte në të vërtetë një bashkëpunëtor

19 PË. Po.

20 PY. A është e vërtetë që sektori juridik kishte kompetencë të

21 lëshonte fletë-arreste?

22 PË. Po.

23 PY. Këto fletë-arreste më pas zbatoheshin nga policia

24 ushtarake dhe nëse lindte nevoja dhe nga njësia speciale,

25 kështu?

1 PË. Po, nga policia ushtarake.

2 PY. Që të jemi më konkretë, kur ju referoheni dhe thoni,
3 sektori juridik mbikëqyrte procesin, ju këtu i drejtoheni
4 Sokol Dobrunës edhe formimit të tij -- dhe formimit të
5 gjykatës ushtarake?

6 PË. Po.

7 PY. Pra, po thoni në dëshminë tuaj që Sokol Dobruna i
8 raportonte drejtpërsëdrejti komandantit të përgjithshëm Azem
9 Sylës?

10 PË. Po, komandantit.

11 PY. Pasi u bë Sylejman Selimi komandant i përgjithshëm, Sokol
12 Dobruna a i raportonte edhe Sylejman Selimit?

13 PË. Me rregull, po.

14 PY. Por ama çfarë ka ndodh në të vërtetë, nëse e dini, në të
15 vërtetë kujt i raportonte Sokol Dobruna pasi u bë komandant i
16 përgjithshëm Sylejman Selimi?

17 PË. Nuk e di saktë. Kur u bë komandant Sylejman Selimi veç
18 koha ka fillu edhe ofensiva serbe, faktikisht, edhe
19 bombardimet. Në atë kohë sa ka mund me raportu nuk e di, se
20 s'kam pas dijeni në atë drejtim, por në rregull është dasht
21 t'i raporton atij.

22 PY. Kur thoni ofensiva serbe, për cilën ofensivë e keni
23 fjalën?

24 PË. Pas bombardimit më 24, më -- mars, 24 mars.

25 PY. Mirë. Por, nga 12 shkurti deri më 24 mars, në këtë

1 periudhë, kujt i raportonte Sokol Dobruna, a e dini këtë?

2 PË. Me rregull, është dasht t'i raportonte komandantit të
3 përgjithshëm, Sylejman Selimit.

4 PY. Po ama në praktikë, në praktikë, themi, në të vërtetë? Në
5 realitet, kujt i raportonte ai, keni ndonjë informacion?

6 PË. Jo.

7 PY. Dëshmitar, pyetjet e tjera janë për të verifikuar disa
8 nga faktet që keni dhënë për faktin që keni mohuar të keni
9 dijëni, për shembull, për planet e shprehura apo të
10 pashprehura për shkeljen e të drejtave të personave që
11 dyshoheshin si kolaboracionistë.

12 Pra, do hyjmë në fakte tani. Që nga momenti që hytë në
13 Kosovë, e deri në fund të luftës, çka do të thotë se do më
14 duhen hollësi.

15 Fillimisht, do më ndihmonit nga pikëpamja juaj si oficer
16 ushtarak me përvojë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për këtë do të doja të shfaqet
18 në ekran prova materiale P628.

19 PY. Dëshmitar, ja, presim të dalë edhe shqipja në ekran.

20 Dëshmitar, nuk më intereson përmbajtja e këtij urdhri,
21 por forma. Pyetja e parë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim një herë faqen e fundit për
23 nënshkrimin.

24 PY. Që një urdhër të hyjë në fuqi, të hynte në fuqi në UÇK,
25 dhe po ju pyes tani si oficer me përvojë, si mund të hynte në

1 fuqi një urdhër në UÇK si fillim duhet të kishte nënshkrim,
2 apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Flasim tani për urdhrat me gojë -- me shkrim, jo me gojë.

5 Që të hynte në fuqi një urdhër, a duhet të kishte vulë?

6 PË. Për të hyrë në fuqi një urdhëresë, e cila është e
7 shkruar, duhet të ketë nënshkrimin, vulën, numrin e
8 protokollit.

9 PY. Po. Nëse një urdhër nuk i ka këto tri gjëra, a mund të
10 hyjë në fuqi? Nëse i mungon një nga këto tri elementë, a mund
11 të jetë urdhër efektiv, a mund të hyjë në fuqi një urdhër i
12 tillë?

13 PË. Në qoftë se nuk ka nënshkrim edhe vulë, nuk mund të hyjë
14 në fuqi, nuk është kry procedura administrative për të hy në
15 fuqi ai urdhër.

16 PY. Prokurorja sot paradite ju tregoi një urdhër që ishte
17 përgatitur më 12 shkurt dhe në atë urdhër ishte, flitej për
18 zëvendësimin e komandant Drinit. Ju kujtohet urdhri?

19 PË. Po, plotësisht.

20 PY. Urdhri ka qenë i panënshkruar, e rrjedhimisht i
21 pavlefshëm. Në realitet, ju nuk e nënshkruat asnjëherë këtë
22 urdhër sepse nuk pajtuat me të, saktë?

23 PË. Saktë.

24 PY. Pra, kur ke një urdhër të panënshkruar, dhe që -- dhe për
25 të kuptuar nëse ky urdhër kishte ndonjë vlerë, a nuk mendoni

1 që duhet të flitej me personin që vërtet e ka përgatitur
2 urdhrin...? E di që ishte pyetja e paqartë. Po, mund të ketë
3 disa variante të një urdhri, mund të ketë kopje të nënshkruar,
4 mundet të ketë kopje të panënshkruara. Por ama, për ta kuptuar
5 a ka qenë ndonjëherë i vlefshëm ky urdhër, duhet folur me
6 personin që e ka përpiluar atë urdhër, apo jo?

7 PË. Po, kjartë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim kryen e faqes në fillim të
9 kësaj urdhërese.

10 PY. Paragrafi ku thuhet, "Në bazë të..." Pse i keni dhënë
11 bazën ligjore ju për këtë urdhër?

12 PË. Në këtë urdhëresë që është shkru, po. Kjo është thënë
13 baza ligjore, të cilët është në kompetencën e shefit të
14 shtabit për raportimin e komandantëve të zonës, të cilët duhet
15 të raportojnë kohën dhe ku do të raportojnë. Kjo është e
16 drejta e shefit të shtabit. Edhe kjo bazohet në rregulloren
17 edhe të Shtabit të Përgjithshëm, jo veç të një ushtrie të
18 formimit që ka qenë i yni, por dhe çdo ushtrie tjetër.

19 PY. Po, por a është e drejtë që ju, kur jeni përgatitur si
20 oficer jeni përgatitur dhe ju kanë thënë që gjithmonë do të
21 jepni bazën ligjore ku e mbështesni një urdhër. Për shembull,
22 nëse komandanti të urdhëronte ty të bëje diçka në njësitin
23 tuaj, ju do ta citonit urdhrin e këtij komandantin në urdhrin
24 tuaj me shkrim dhe më pas do ua përcillnit vartësve tuaj, apo
25 jo?

- 1 PË. Po. Sigurisht dhe kjo është bazuar në rregulloren e
2 Shtabit të Përgjithshëm.
- 3 PY. Faleminderit. Të ndryshojmë temë tani dhe ta marrim në
4 radhë kronologjike që nga momenti që keni hyrë në Kosovë. Ju
5 pritët për afërsisht dy muaj në Shqipëri përpara se të hynit në
6 Kosovë, saktë?
- 7 PË. Po, saktë.
- 8 PY. Gjatë kohës që ishit në Shqipëri, e ndihmonit UÇK-në me
9 aspektet logjistike, kështu?
- 10 PË. Në sektorin e logjistikës, ndihmojsha, kam ndihmuar për
11 përcaktimin e armëve, aspektin teknik të tyre.
- 12 PY. Dhe ju thatë që keni trajnuar edhe disa nga personat që
13 do të bëheshin ushtarë të UÇK-së, apo jo?
- 14 PË. Po.
- 15 PY. Ju pritët dy muaj, sepse, siç e kishit kuptuar ju, po
16 bëhej një verifikim i të shkuarës suaj, apo jo?
- 17 PË. Po.
- 18 PY. I thatë ZPS-së se ju nuk mendonit se ky verifikim i të
19 shkuarës suaj kishte të bënte me pozitat tuaja politike në të
20 shkuarën, saktë?
- 21 PË. Pozita të mia politike s'kam pas në të shkuarën kurrë, në
22 këtë drejtim. Por verifikimi ka qenë për veprimin tim të punës
23 në ish-armatën jugosllave, por ku kam qenë, ku kam jetuar.
- 24 PY. Po, por për shembull, më shumë deshën të kuptonin në
25 cilën parti ishit pjesë, për këtë?

1 PË. Unë para të kyçem në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës s'kam
2 qenë me asnjë parti politike.

3 PY. Ju keni qenë në një grup me ish-oficerë të tjerë të
4 armatës jugosllave, dhe bashkë prisnit të hynit në Kosovë,
5 kështu?

6 PË. Në atë kohë kemi qenë normalisht, kanë qenë edhe, grup i
7 ish-oficerëve të armatës popullore të Jugosllavisë, kur kemi
8 punuar, që kemi jetuar jashtë perëndim, dhe ne kemi pritur
9 normalisht që të verifikohet për ne dhe pastaj të hyjmë në
10 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

11 PY. A mund t'i identifikojmë, p.sh. kanë qenë oficerë -- po
12 një nga oficerët ka qenë Agim Qelaj, kështu?

13 PË. Një ndër ta, një ndër ta, po?

14 PY. Kadri Kastrati?

15 PË. Po.

16 PY. Kemal Shaqiri?

17 PË. Po.

18 PY. Binak Gashi?

19 PË. Po.

20 PY. Mahir Hasani?

21 PË. Po.

22 PY. Në rregull. Ndonjë tjetër që unë s'e përmenda?

23 PË. Në UÇK ka pas pastaj Shaban Draga, Naim Maloku, e të
24 tjerë, e të tjerë, oficerë veç.

25 PY. Me sa keni ju dijeni, a mund të themi që, pra, këta

1 personat që ju dinit se ishin në Shtabin Qendror asokohe, nuk
2 kishin ndonjë problem, nuk kishin ndonjë gjë kundër oficerëve,
3 ish-oficerëve të armatës jugosllave, kështu?

4 PË. Po, pikërisht është q'ashtu. Jo vetëm nga shtabi qëtu por
5 edhe jashtë se kam qenë, para se të hyjmë këtu ne kemi pas
6 kontakte me anëtarë të UÇK-së dhe shtabit të cilët kemi
7 diskutuar dhe përgatitur për të hyrë këndeje.

8 PY. Personat me të cilët keni pasur ju kontakt, Fehmi
9 Lladrovci dhe Xhemajl Fetahu, kështu?

10 PË. Po, pikërisht. Po, po. Pikërisht.

11 PY. Dhe ju e dinit, sipas jush, ata ishin në UÇK, kështu?

12 PË. Po, qe vetë më kanë treguar që janë pjesë e UÇK-së, janë
13 pjesë e shtabit dhe kemi diskutuar bukur gjatë dhe kemi bë
14 përgatitje për të hyrë këndejna në Kosovë.

15 PY. Mirë. A mund të them që jo vetëm që ata nuk ishin kundër
16 personave që kishin përvojë ushtarake në ushtrinë jugosllave,
17 por madje kërkonin profesionistë si ju dhe të tjerë që unë i
18 përmenda që të shkonit në Kosovë dhe t'i ndihmonit, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Ju thatë se përfundimisht ju dha Azem Syla dritën jeshile
21 për të hyrë në Kosovë, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Ai ju dha udhëzime dhe ju takoi përpara se të hynit në
24 Kosovë, në fund të majit 1998, kështu?

25 PË. Po, në këtë kohë në maj, jo në fund të majit, por në maj,

- 1 fillim. Jemi takuar edhe me anëtarë të tjerë të shtabit, ku
2 kemi diskutuar, dhe në fund të majit kemi hyrë në Kosovë.
3 PY. Mirë, por sidoqoftë, kur hytë në Kosovë në fund të majit,
4 ju nuk e dinit që Azem Syla ishte komandanti i përgjithshëm i
5 UÇK-së në atë kohë, saktë?
6 PË. Po, saktë.
7 PY. Të prezantuan me Hashim Thaçin kur hyrë në Kosovë në maj
8 të 1998, kështu?
9 PË. Po.
10 PY. Ju sapo thatë se keni pasur këtë takim me Azem Sylën në
11 Shqipëri. Po te ky takimi, Hashim Thaçi ka qenë i pranishëm?
12 PË. Jo.
13 PY. Pra, takimi juaj i parë me z. Thaçi ka qenë përafërsisht
14 në datën kur hyrë në Kosovë. Me sa ju kujtohet, kjo ka qenë
15 hera e parë që jeni prezantuar me të?
16 PË. Po, hera e parë ka qenë maji i 1998.
17 PY. I thatë ZPS-së, mbase ju ndihmon kjo për të rifreskuar
18 kujtesën, i thatë ZPS-së se me Agim Qelaj ka mundësi ta keni
19 takuar një herë tek Hotel Tirana në prill të 1998, a është e
20 saktë kjo?
21 PË. Po, mund të jetë. E saktë.
22 PY. Ju hytë në Kosovë, së bashku me Agim Qelajn, Hashim
23 Thaçin, kështu?
24 PË. Po.
25 PY. Kadri Veselin?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe Adem Grabovcin?

3 PË. Po.

4 PY. Por ju i thatë ZPS-së se nuk morët asnjë udhëzim nga z.

5 Thaçi, z. Veseli apo z. Grabovci, nuk ju thanë se çfarë

6 prisnin prej jush kur të hynit në Kosovë, kështu?

7 PË. Po, pikërisht.

8 PY. Tani do t'i referohem një prej dëshmive që i keni dhënë

9 ish-Tribunalit të Hagës.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Për palët do më duhet të jap

11 numrin e referencës. Është me numër U016-0791-U016-0817.

12 PY. A është e vërtetë që në fakt ju ishit personi që po i

13 udhëhiqnit z. Thaçi, z. Veseli, z. Grabovci në Kosovë sepse ju

14 ishit profesionist?

15 PË. Po, kolonën e kam udhëheq unë, kam qenë komandanti i

16 kolonës.

17 PY. Në këtë moment -- dua të më shpjegoni se si e keni

18 kuptuar ju rolin e z. Thaçi në Shtabin e Përgjithshëm apo

19 Shtabin Qendror. Ju i keni thënë ZPS-së që roli i tij ishte të

20 mbulonte drejtorinë për publikun për marrëdhëniet me publikun

21 dhe me median në qershor të 1998, a është kështu?

22 PË. Po, është kështu.

23 PY. Më pas thoni se ai u bë përfaqësuesi politik i UÇK-së.

24 Tani unë kam këtë pyetje. Me sa ju kujtohet ju, sa kohë e ka

25 drejtuar drejtorinë për median dhe marrëdhënien me publikun z.

1 Thaçi dhe kur mori rolin e përfaqësuesit politik?

2 PË. Po. Rolin e drejtorit të drejtorisë për marrëdhënie me
3 publikun edhe mediat e ka drejtu deri në, transferimit të
4 Shtabit të Përgjithshëm në nëntor të 1998. Në nëntor të 1998,
5 faktikisht, ende hala ka qenë kjo dhe është nxjerrë nevoja për
6 shkak të bisedimeve dhe me, ishin bisedimet me palën
7 ndërkombëtare dhe Serbinë. Atëherë u dasht nevoja që të jetë
8 edhe një pjesë e ndarë e veçan pjesës politike, dhe është
9 formuar drejtoria politike në të cilën, fillimi i saj, punës
10 ka fillu mendoj kah dhjetori. Edhe është vendosur z. Thaçi,
11 për shkak të përvojave të tij që ka pas për marrëdhëniet me
12 publikun dhe mediat, dhe i ka njoft aspektet ndërkombëtare.
13 Dhe është vendosur në këtë detyrë në të cilën e ka ushtruar këtë
14 detyrë pastaj deri në Rambuje, kur është përcaktuar edhe si
15 kryeministër i qeverisë së përkohshme nga Rambujeja që ka
16 dalë.

17 PY. Faleminderit për sqarimin. Tani dua të fillojmë me
18 trajektoren tuaj në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kur hytë
19 në Kosovë ju nuk kishit asnjë rol apo ndonjë pozitë të caktuar
20 pranë UÇK-së, saktë?

21 PË. Saktë.

22 PY. A është e vërtetë që kur u kyçët në UÇK ju nuk i njihnit
23 shumicën e personave që ishin asokohe në Shtabin e
24 Përgjithshëm, a është kështu?

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. Ju keni dhënë dëshmi më herët.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal është materiali
3 me numër IT-04-84 T3154-3255 në faqen 3203.

4 PY. Pra, keni dhënë dëshmi më herët që vetëm kur hytë në
5 Kosovë, dhe shkuaat në Likovc, morët detyrën ju personalisht
6 dhe Agim Qelaj, kështu?

7 PË. Po, atëherë kam marrë detyrën si oficer i zhvillimit dhe
8 profesionalizimit në kuadër të drejtorisë operative.

9 PY. Po. Atëherë, në të njëjtën dëshmi të cilën e kam cekuar
10 tashmë, dhe është në gjyqin Haradinaj në 2007, ju thatë që ju
11 ishin dhënë detyrat e një eprori në drejtorinë operative të
12 Shtabit të Përgjithshëm me përgjegjësi për zhvillimin e UÇK-
13 së, është e saktë kjo?

14 PË. Po, është e saktë.

15 PY. Dhe tani dëshiroj që të jem shumë i saktë dhe preciz. Ju
16 e konsideroni veten që ishit oficer i shtabit, epror në
17 shtab?

18 PË. Nuk -- e konsiderojsha veten që jam pjesë e drejtorisë
19 operative të Shtabit të Përgjithshëm.

20 PY. Pyetja ime është, në qershor të vitit 1998, ju besoni që
21 kishit autoritetin dhe kompetencat që vetë të lëshoni urdhra
22 në formë të drejtpërdrejtë, për shembull shtabeve lokale? Apo
23 ju ishit epror në shtab duke asistuar të tjerë?

24 PË. Jo, në atë kohë isha duke asistuar të tjerët. Nuk kam pas
25 unë të drejtën të lëshoj urdhrat, as kompetencën që...

1 PY. Mirë, atëherë në bazë të kësaj përgjigjeje, ju në atë
2 kohë a besonit që, dhe po flasim për qershor-korrik-gusht, në
3 fakt qershor-korrik tani për tani, përpara se të bëheni shefi
4 i drejtorisë operative. A besonit në qershor dhe korrik për
5 shembull që ju mund të lëshonit një urdhër, dy shtabeve
6 vendore dhe t'u thoshit, unë ju urdhëroj që ju të bëheni një
7 Shtabi i Përgjithshëm i vetëm?

8 PË. Jo, me urdhëresën nuk ka shku. Ato kanë shku me
9 mirëkuptim të të gjitha njësive që kanë qenë në ato territore
10 ose kur kanë shkuar që t'i unifikojë. Pasi janë unifikuar së
11 bashku ata, kam informuar drejtorinë operative se si ku ka
12 arrit, deri ku ka arrit.

13 Unë i kam ndihmuar në aspektin profesional se si të
14 organizohen, ata të cilët janë pajtu që të bëhet si shtab
15 lokal ose si një njësi e vetme.

16 PY. Por kur keni vajtur atje, ju për shembull flisnit me
17 autoritetin e një komandanti apo përpiqeshit që të
18 ndërmjetësonit ndërmjet dy apo më shumë grupeve?

19 PË. Jo, nuk kam qenë me autoritetin e komandantit, por me
20 autoritetin si epror profesionist për t'i ndihmuar, këshilluar
21 dhe për t'i riorganizuar ose organizuar ato njësi. Me urdhër,
22 normalisht, me udhëzimet që i kam pas prej drejtorisë
23 operative.

24 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Atëherë, duke u bazuar tek
25 përgjigjet tuaja tani, kur keni shkuar në vende të ndryshme në

1 qershor të 1998, si në Drenoc ose në rrafshin e Dukagjinit ose
2 në Suharekë, ju u jepnit këshilla atyre se si mund të bëheshin
3 më profesionistë?

4 PË. Po, pikërisht ashtu është.

5 PY. Në rregull. Ju gjithashtu keni dhënë dëshmi dhe kjo edhe
6 kur folët, në përgjigjen që i dhatë Prokurorisë, që në mes të
7 korrikut 1998 ju u bëtë drejtor i departamentit operativ në
8 Shtabin e Përgjithshëm, është e saktë kjo?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. Në çështjen Haradinaj në gjykimin e tij në vitin 2007,
11 dhe ky është në procesverbal në faqen 3277 deri në 78 të atij
12 gjyqi, ju keni dhënë dëshmi duke thënë që në periudhën e verës
13 1998, ekzistonin vetëm zonat e Drenicës dhe Dukagjinit, ndërsa
14 zonat e Llapit, Pashtrikut dhe Karadakut u formuan më vonë dhe
15 nuk funksiononin si zona të vërteta. Është e saktë kjo apo
16 dëshironi ta ndryshoni këtë dëshmi?

17 PË. Shumë mirë kjartë unë e kam thanë aty në dëshmi që zona e
18 Drenicës dhe e Dukagjinit kanë qenë më aktive. Kam thanë më
19 aktive në aspektin e luftimeve, kur këto zona të tjera nuk
20 kanë qenë aq të organizuara dhe të unifikuara, ato kanë
21 ekzistuar, kanë qenë aty, komandat e të gjitha, por organizimi i
22 tyre nuk ka qenë i plotë. As nuk kanë qenë aktive shumë në
23 luftime. Nga këtë aspekt edhe e kam thanë edhe deklaratën e
24 shkru lart.

25 PY. Në rregull. Atëherë për ta sqaruar kur thoni që nuk ishin

1 të organizuara mirë, pyetja ime është për ju si profesionist.
2 Nëse mund t'i thoni Trupit Gjykses çfarë, për çfarë e keni
3 fjalën këtu, nuk ishin të organizuara mirë, ose të
4 mirorganizuara, çfarë u mungonte atyre për të qenë një zonë e
5 organizuar mirë?

6 PË. Po kur folim për këtë kohën, qershor, korrikun, domethënë
7 që nuk kanë qenë të organizuara mirë, nuk kanë qenë për arsye
8 se kanë qenë shumë grupe të ndryshme në këto territore. Kanë
9 qenë edhe në [E pakuptueshme] Drenicës dhe Dukagjinit, por
10 atje ka pas pak ma mirë ka qenë ma afër organizimi edhe ma
11 kanë qenë ma afër njësitet të lidhura. Kurse në këto zonat nuk
12 ka qenë të gjitha, kanë pas njësi të ndryshme të brenda
13 territoreve. Për shembull po marrim Pashtrikun. Kemi pas
14 njësitin Lumi, njësitin Lisi, Pëllumbi, të gjitha, po asnjëna
15 prej tyre nuk ka qenë e lidhur me një komandë. Se shifet prej
16 asaj që tek në fund të qershorit është përcaktu komandanti i
17 zonës në, zonës së Pashtrikut. Domethënë deri atëherë nuk ka
18 pas as komandë, nuk e di ndoshta ka pas ndonjë komandë, por
19 nuk kam dijeni. Po shifet që deri atje nuk ka pas komandë.

20 Edhe këto njësitë kanë vepruar, domethënë, simbas
21 situatës dhe nevojave. Dhe kështu që kjo është aspekti i saj
22 që nuk kanë qenë të organizuar, edhe mes veti këto njësitë nuk
23 kanë pas bashkëpunim mes veti. Që është dashtë shpeshherë që
24 të bisedohet dhe t'i ofrohet që të kemi bashkëpunimin mes
25 këtyre njësive.

1 Për atë edhe fundit të qershorit ka fillu, dhe zonës së
2 Pashtrikut ku është përcaktu komandanti, pastaj në korrik,
3 gusht, është përcaktu i zonës së Nerodimes. Pastaj kanë fillu
4 të dalin në skenë zona e Shalës, siç ajo ka qenë, por me
5 grupe. Veç ka fillu riorganizimin, tek masanej në fund, pastaj
6 Llapi diku më vonë kah shtatori kur është, kur arritën të
7 organizohet si zonë.

8 Për atë them se kanë qenë grupet e ndryshme, dhe nuk kanë
9 qenë komandat e unifikuara të cilat kanë mujt të komandohen si
10 një aspekt ushtarak në këto zona. Për atë dhe në këtë kontekst
11 e kam shpjeguar aspektin se pse kanë qenë ato, nuk kanë qenë
12 të zhvilluar anë aspektin ushtarak.

13 PY. Okej. Dhe për t'u treguar i drejtë me ju, në fakt këtë
14 keni thënë në dëshminë tuaj në çështjen Limaj dhe, në fakt,
15 pothuajse fjalë për fjalë këtë gjë keni thënë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për palët bëhet fjalë për
17 faqet 6823 deri në 25 në dëshminë që keni dhënë në 2005 në
18 çështjen Limaj.

19 PY. Në lidhje me zonën e Pashtrikut në gjyqin e z. Limaj ju
20 keni thënë, dhe po e lexoj:

21 "... unë kam parë shumë njësite të vetorganizuara dhe që
22 nuk ishin të unifikuara në një komandë. Kjo zonë nuk ishte
23 aktive në atë kohë. Në qershor filluam përgatitjet për zonën
24 dhe sigurisht në qershor dhe korrik ne nuk arrinim dot nivelin
25 më të lartë të organizimit të kësaj zone. Dhe, siç e thashë,

1 ka pasur shumë ofensiva të serbëve në qershor dhe korrik,
2 megjithatë ristrukturimi vazhdoi edhe në muajt në vijim, por
3 nuk arriti nivelin e dëshiruar, siç ishte për shembull rasti
4 me zonat e tjera, gjithashtu.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo ndodhet në faqen 6825 të
6 dëshmisë në -- të 2005, në z. Limaj.

7 PË. Është e shpjeguar saktë situata kështu?

8 PY. Po, saktë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Okej atëherë, ju lutem që në ekran
10 të vendosim provën materiale P01346-ET.

11 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë hartë këtu?

12 PË. Jo.

13 PY. Atëherë, keni të drejtë. Më duhet ta sqaroj. Nuk e kam
14 fjalën për shënimet mbi hartë, por a mund të shihni Rahovecin
15 për shembull në pjesën e sipërme të kësaj harte në mes?

16 PË. Po, po. Mund ta shof.

17 PY. Okej. Nuk e di nëse mund t'i lexoni shifrat, numrat, por
18 këtu përpiqet që të tregojë, në fakt brigadat e UÇK-së me
19 numrat e tyre. Për shembull në mes duket 123, dhe këtu ideja
20 është që të tregohen edhe zonat, përkufizimi, pra i zonave të
21 brigadave, e shihni këtë gjë?

22 PË. Po, po. E shof.

23 PY. A ekzistonin të gjitha këto brigada në këto zona të
24 përcaktuara këtu në korrik të 1998?

25 PË. Në korrik të 1998, kanë fillu këto, se kanë qenë njësitë,

1 janë bërë -- qershor, korrik, kanë qenë njësi shtabeve lokale
2 në formim. Por brigadat si brigada kanë fillu që atëherë diku
3 në fund të korrikut, fillim të gushtit të formohen pas
4 ristrukturimit të nevojës që është kanë në atë kohë.

5 Dhe këto selitë e njësive po, kanë qenë Brigada 121, që
6 ka qenë në Bjeshkët e Berishës, 122 e Malishevës, 123 është e
7 Suharekës, se shtabi lokal i Suharekës është shndërru në atë
8 kohë në Brigadën 123. Edhe Brigadës 125, për shembull
9 Batalioni i parë, i dytë, diçka, Batalioni -- po, këto janë
10 përgjegjësitë e Brigadës 123.

11 Përafërsisht qeto kanë qenë si grupe dhe njësive. Edhe
12 124, dhe ky është shtabi lokal i Rahovecit, është formu shumë
13 ma vonë, fund të korrikut, fillim gushtit, dikund. Sa më
14 kujtohet. Por ndarja e zonës së përgjegjësive nuk është kanë e
15 imja, është kanë e komandantit të zonave, dhe ata e kanë
16 ndaj të zonën e përgjegjësive mes brigadave brendapërbrenda
17 zonës.

18 PY. Më lejoni të jem pak më specifik në pyetjet e mia. A
19 ekzistonin këto brigada në këto zona përpara dhe gjatë
20 ngjarjeve në Rahovec, rreth 17 korrikut?

21 PË. Përpara jo. Kanë ekzistuar njësitë, të cilat kanë qenë. Po
22 prapë mbas Rahovecit, po. Mbas rastit të Rahovecit, ndodhjes
23 [E padëgjueshme].

24 PY. Nuk jam i sigurt fort për përgjigjen tuaj, ndoshta ka të
25 bëjë me përkthimin. Por ju thatë jo më përpara, por njësitë

1 respektive përkatëse ekzistonin, pra mund të na sqaroni?
2 Ekzistonin këto brigada si 121, 122, 123, përpara dhe gjatë
3 ngjarjeve në Rahovec?
4 PË. Unë e ceka, shumë mirë e thashë. Brigadat janë formu pas
5 Rahovecit, ndodhjes së Rahovecit. Para Rahovecit nuk ka pas
6 brigada, ka pas njësi.

7 PY. Okej. Tani do lexoj dëshminë tuaj që keni dhënë në
8 çështjen Limaj në vitin 2005, në faqen 6831. Ju thatë që:
9 "... brigadat filluan të formoheshin në gusht 1998, dhe
10 ky proces vijoi në shtator, tetor dhe nëntor. Ka patur
11 përpjekje për t'i zhvilluar këto brigada, dhe arritën në nivel
12 të mesëm. Megjithatë, duke marrë parasysh të gjithë luftimet
13 që po ndodhnin në gusht e në shtator e më pas, në mars njësitë
14 nuk arritën një organizim të plotë ushtarak të brigadës."

15 A është e saktë kjo?

16 PË. Po, plotësisht e saktë.

17 PY. Okej.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, në ekran të vendosim
19 dokumentin tjetër i cili ka numrin 1D00164.

20 PY. Dëshmitar, ju treguan këtë dokument, në fakt ishte ZPS-
21 ja. A e mbani mend se çfarë është ky dokument?

22 PË. Po.

23 PY. Në rreshtin 8 të origjinalit, nëse mund ta zmadhojmë pak
24 për dëshmitarin, dhe do t'ju lutesha që të ma konfirmonit, a
25 është ajo firma juaj apo jo?

1 PË. Po, plotësisht firma jeme është, në numrin 7.

2 PY. Dhe a e mbani mend që e keni nënshkruar një dokument të
3 tillë në këtë takim?

4 PË. Po.

5 PY. Në rregull. Takimi në vetvete, mbledhja, mendohet që
6 është mbajtur në 26 qershor 1998, në Studenqan. A pasqyron kjo
7 gjë saktësisht atë që ju mbani mend për këtë lloj takimi, pra
8 kur dhe ku ka ndodhur ai?

9 PË. Po, plotësisht.

10 PY. Dhe në dokument raportohet që vendimi që u mor për
11 bashkimin e dy njësiteve u mor nga njësitë Çeliku 50 dhe Lisi
12 në vetvete, vetë këto të dyja, a është e saktë kjo?

13 PË. Po, është e saktë. Të dy njësitë janë takue edhe ne kemi,
14 edhe unë kam qenë prezent në këtë takim. Ne, faktikisht, unë
15 dhe zotëria tjetër, të cilin, Gafur Elshani, kemi marrë pjesë
16 dhe kemi ndihmuar që të dy njësitet të ofrojnë, të ofrohen
17 njëra me tjetrën dhe të formojnë këtë shtab lokal.

18 PY. Në dokument pasqyrohet kjo që ju thatë, pra në atë fjali
19 që ju thatë që ju keni qenë thjesht i pranishëm në këtë takim?

20 PË. Po.

21 PY. Është e saktë që ju nuk erdhët në këtë takim dhe t'i keni
22 dhënë urdhër këtyre dy njësiteve që të bashkoheshin? Pra, nga
23 ndokush që t'ju kishte dhënë këtë autorizim nga Shtabi i
24 Përgjithshëm?

25 PË. Jo. Nuk ka pas urdhër të [E pakuptueshme] që të bashkohen

1 këto dy njësi. Unë nga drejtoria operative, jam dërgu që të
2 shifet cilat janë problematikat, me këtë territor, në ato
3 njësi. Kur i kemi grumbulluar që të bisedojmë me këto dy
4 njësi, atëherë këto kanë fillu që të bisedohet dhe të ofrohen
5 të dyja njana me tjetrën, dhe të formohet shtabi lokal. Unë i
6 kam vu pastaj në sistemin e organizativ se si formohet një
7 komandë, dhe si mund të vendoset. Kjo është të cilën unë e kam
8 kry në atë kohë.

9 Nuk ka pas urdhër që, strikt, që duhet, ose që është me
10 urdhër që të formohet si njësi, ose të formohet si njësi e
11 përbashkët, por janë unifikuar simbas bisedës dhe nevojës që
12 kanë pas.

13 PY. Tani të kalojmë te zona e Dukagjinit në pothuajse të
14 njëjtën periudhë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Në ekran do t'ju lutesha që të
16 kishim dokumentin P10364.

17 PY. Dëshmitar, kjo është një mbledhje ose ka qenë një takim
18 në 23 qershor, dhe është procesverbali i këtij takimi të
19 shtabit të Gllogjanit të Dushkajës, të Lugut të Baranit, të
20 Lugut të Lushanit dhe të anës së Drinit. A e shihni këtë?

21 PË. Po.

22 PY. A keni qenë i pranishëm në këtë takim?

23 PË. Jo.

24 PY. Okej. Atëherë më lejoni që t'ju tregoj pak dhe të
25 shikojmë, pra, se çfarë ndodh në këtë takim, dhe nëse kështu e

1 keni kuptuar edhe ju, gjendjen e UÇK-së në zonën e Dukagjinit
2 në fund të qershorit. Ky është një takim, pra, i shtabeve
3 vendore, lokale, që ka sjellë edhe krijimin e zonës së
4 komandën -- së Dukagjinit.

5 Së pari, më lejoni t'ju pyes, që ju duhet ta dinit, ose
6 më lejoni t'ju bëj këtë pyetje. Që nuk ishte Shtabi i
7 Përgjithshëm që krijoi zonën e Dukagjinit me anën e ndonjë
8 urdhri, a është e saktë kjo?

9 PË. Po, saktë, simbas saj.

10 PY. Atëherë, po të kalojmë më poshtë, dhe ka një diskutim
11 ndërmjet gjithë këtyre grupeve dhe nëse mund të na shpjegoni
12 luginat e Gllogjanit, Dushkaja, Baranit, Lushanit, dhe këto
13 shtabe, pra, që përmenda dhe të anës së Drinit. Me pak fjalë
14 këto ishin njësitë të UÇK-së të vetorganizuara në zona të
15 ndryshme të Dukagjinit, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe po takohen këtu për të parë nëse mund të arrijnë një
18 marrëveshje për të krijuar një komandë që mund t'i komandojë
19 ata të gjithë dhe të bashkërendojë aktivitetin e tyre, është e
20 saktë kjo?

21 PË. Po, e saktë. Kjo është në të njëjtin veprim nga të,
22 thuja, sikur ato kur jemi bashku në territorin e Suharekës,
23 këto njësitë në shtabin lokal.

24 PY. Po. Atëherë, të kalojmë te faqja 5 e këtij dokumenti me
25 numër, por në fakt është faqja 2 e këtij dokumenti. Atëherë,

1 këtu raportohet --

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, edhe tek anglisht faqja e
3 dytë e dokumentit për ekranin.

4 PY. Dhe këtu thuhet që Majori, që unë besoj se është Veseli,
5 që propozon unifikimin e të gjitha shtabeve vendore në një
6 komandë të përbashkët të vetme. A e shihni këtë pjesë?

7 PË. Po.

8 PY. Nëse kalojmë tek faqja tjetër, me të zezë të fortë,
9 thuhet që:

10 "Formimi i shtabit operacional të Lugut të Dukagjinit u
11 ra dakord dhe u shpall i formuar në formë unanime."

12 Dhe pastaj vijon tek pika tjetër që:

13 "Unanimisht aprovohet njëzëri, aprovohet që shtabi të
14 ketë komandant, zëvendëskomandant, ndihmësin për moral dhe
15 politikë, kryeshefin e shtabit, ndihmësin për logjistikë, për
16 zbulim dhe kundërzbulim."

17 A është e saktë që Lugina e Dukagjinit po krijohet këtu
18 duke u hedhur në votë nga njësitë vendore lokale të UÇK-së?

19 PË. Po, simbas këtij procesi, po, q'ashtu është.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja 4 e
21 këtij dokumenti, por mbetet faqja 3 në gjuhën shqipe.

22 PY. Personi që identifikohet si Smajli, që unë besoj se është
23 Ramush Haradinaj, thotë që:

24 "Shtabi Qendror nuk është duke na dhënë udhëzimet që na
25 duhen, nuk është prezent."

- 1 A e dini ju pse, a keni ndonjë arsye ose a dini pse
2 Ramushi mund të ketë thënë që mendimi i tij ishte që Shtabi
3 Qendror nuk ka qenë i pranishëm në luginë deri atëherë në
4 Dukagjin?
- 5 PË. Jo, nuk e di.
- 6 PY. Okej. Më poshtë vijohet, ku thuhet që me votë duhej
7 vendosur nëse Smajli, Ramush Haradinaj pra, ose Magjypi, që
8 është Lahi Brahimaj, besoj unë, secili prej tyre duhet të jetë
9 komandant i zonës, dhe Smajli zgjidhet me shumicën e votave
10 nga shtabi vendor lokal. Është e saktë kjo?
- 11 PË. Saktë, simbas procesit.
- 12 PY. Okej. Pra, komandantët e zonave në këtë rast, komandantët
13 e zonave zgjidheshin nga ata të rangjeve të mëposhtme dhe nuk
14 përcaktoheshin nga lart, a është e saktë kjo, jeni dakord me
15 mua?
- 16 PË. Simbas këtij procesit, po.
- 17 PY. Po a keni ndonjë arsye për të menduar që Ramush Haradinaj
18 u caktua në pozicionin e vet për shembull me anën e ndonjë
19 urdhri nga lart, nga dikush mbi të? Keni ndonjë arsye për të
20 mos rënë dakord me këtë procesverbal?
- 21 PË. Jo, nuk e kam thënë as tash, por asnjherë. Sikur kam
22 ardhur i kam gjet ata komandantët aty. S'di as mënyrën qysh
23 kanë ardh, qysh janë vendos. Por po shifet me procesverbalet
24 se kanë ardh në këto mënyra.
- 25 PY. Okej. Më poshtë vijohet, duke thënë --

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë tek pjesa e
2 fundit e faqes, që:

3 PY. "Pas saj, shefi i shtabit, Majori, ofroi një shpjegim
4 profesional të detyrave të komandantit, të
5 zëvendëskomandantit, shefit të shtabit dhe zëvendësshefit të
6 shtabit."

7 Kështu që, po ta lëmë këtu, në dukje duket sikur duhet
8 t'u shpjegonte këtyre personave se çfarë do të thonë këto
9 funksione, këto pozicione. Është e saktë kjo?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Okej. Dhe pastaj thuhet që:

12 "Dhjetë persona me përgjegjësi të ndryshme ushtarake në
13 Dukagjin u caktuan gjithashtu si shtabi operativ në Dukagjin."

14 Pra, edhe shtabi po zgjidhet nga këto njësi vendore të
15 vetorganizuara, është e saktë kjo?

16 PË. Po, po. Simbas këtyre.

17 PY. Tani dëshiroj t'ju tregoj një version tjetër të këtij
18 procesverbali që është më i hollësishëm se sa këto detaje që
19 pamë këtu. Po së pari, Sali Veseli, Majori, edhe ai është një
20 oficer i ushtrisë, ish-ushtrisë jugosllave, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Atëherë, në këto -- detaje, procesverbal, tregohet që ju
23 të gjithë oficerët e ish-armatës jugosllave po vinit dhe po i
24 tregohet këtyre personave edhe gjëra elementare se cilat janë
25 detyrat, për shembull, të komandantëve, e të tjerë, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Okej.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë në ekran të vendosim KSC-
4 BC-2020-06, dhe më pas me shifrat IT-04-84 P00141.E.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, nëse mund të
6 na përsërisni shifrat përkatëse?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Patjetër, P00141.E.

8 PY. Në këto shënime, kemi më shumë hollësi se çfarë kanë
9 thënë personat e ndryshëm që kanë qenë në këtë takim. Pra,
10 Sali Veseli, për shembull, pra ish-oficer i armatës
11 jugosllave, në faqen 2 anglisht dhe në faqen e parë të gjuhës
12 shqipe.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, vendosni në ekran edhe
14 dokumentin në gjuhën shqipe.

15 PY. Dhe këtu thuhet, në faqen 2, Sali Veseli thotë:

16 "... ne duhet të kalojmë në një ushtri operative,
17 operacionale."

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe në faqen 2 të versionit në
19 gjuhën shqipe, dhe 3 në anglisht.

20 PY. Edhe këtu Sali Veseli thotë:

21 "Unë propozoj që të formohet një shtab operativ për zonën
22 e Dukagjinit..."

23 Ndërsa Rustem Tetaj thuhet që:

24 "Për mendimin tim ka pak konsolidim të forcave.

25 "Dhe në mënyrë që të ecim përpara, na duhet bashkërendimi

1 dhe një komandë e vetme.”

2 Pra, është e saktë që gjatë gjithë qershorit ka patur pak
3 konsolidim të forcave në Dukagjin?

4 PË. Po, jo veç në Dukagjin, por në tërë territorin e Kosovës,
5 në të gjitha zonat ka qenë riorganizimi, organizimi, po
6 faktikisht -- në këtë proces, po.

7 PY. Kjo do të kishte qenë pyetja ime e radhës kështu që,
8 faleminderit që i parapritët edhe na shpjeguat se çfarë po
9 ndodhte në të gjithë Kosovën në atë kohë. Rustem Tetaj, edhe
10 ai ka qenë një oficer i ish-armatës jugosllave apo jo?

11 PË. Po, si po i shof emrat këtu, edhe Sali Veseli, Rustem
12 Tetaj dhe Shemsedini kanë qenë të tre ish-oficerë të armatës
13 popullore të Jugosllavisë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të shfaqet në ekran faqja
15 e fundit e këtij dokumenti, faqja 4. Dhe të shikojmë pjesën e
16 fundit të saj. 4, në gjuhën shqipe. Edhe në anglisht, kemi
17 faqen e fundit në anglisht. Shikojmë në fund të faqes.

18 Më duket se kemi një -- ngatërresë, se anglishtja ka dalë
19 faqja e duhur, por nuk ka dalë shqip. Po e lexoj më mirë, në
20 qoftë se s'keni kundërshtim.

21 PY. Dëshmitar, në dokument thuhet kështu, besoj se e keni në
22 shqip përpara, thuhet që Sali Veseli, ushtar profesionist, i
23 bëhet pyetje nga Ramush Haradinajt t'i shpjegojë detyrat që ka
24 një komandant, zëvendëskomandant dhe një shef shtabi, kështu
25 ka ndodhur?

1 PË. Nuk di a ka ndodh kështu, por pyetja është e tillë, po,
2 në mënyrën profesionale.

3 PY. Por, a është pasqyruar kjo në dokument, a i është bërë
4 kjo pyetje?

5 PË. Po.

6 PY. Pra, nëse ky dokument është i saktë, është Ramush
7 Haradinaj ai që ka bërë pyetje bazike të tipit, cilat janë
8 detyrat e një komandanti, apo zëvendëskomandanti, saktë?

9 PË. Saktë.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj të
12 pranohet ky dokument si provë gjyqësore. Në anglisht ishte
13 faqja 7.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm faqen
15 7?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, kërkoj të pranohet i gjithë
17 dokumenti.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
19 kundërshtim?

20 KSC-BC-2020-06 IT-04-84 P00141.E, pranohet.

21 A është konfidencial apo publik?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Publik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Riklasifikojeni si dokument publik.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti bashkë me

1 përkthimin në gjuhën angleze merr numrin 1D00165, dhe do të
2 klasifikohet si konfidencial.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Mos deshët të thonit publik?

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. Do riklasifikohet
5 si publik.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, folëm për Suharekën dhe Dukagjinin. A
8 pajtoheni me mua që kjo tregon se si komandantët e zonave në
9 gjithë UÇK-në e merrnin autoritetin e tyre nga njësitet lokale
10 të UÇK-së dhe jo prej emërimeve nga Shtabi i Përgjithshëm. A
11 është e saktë?

12 PË. Komandantët e zonave në atë kohë, normalisht që kanë pas
13 prej njësiteve mbrenda zonave të tyre, dhe ato veç kanë, nga
14 ana ime, kur kam ardh kam gjet dhe nuk mund të caktojme. Sipas
15 procesit që është dhe mënyrës që shifet, po. Është dhanë nga
16 njësitë ma poshtë, është përcaktu nga njësitë ma poshtë.

17 PY. Dua t'ju tregoj një deklaratë që keni dhënë për ish-
18 Tribunalin e Hagës në 2005.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, vendosni në ekran
20 materialin SPOE00183317 deri në 00183342, në paragrafin 14.

21 PY. Z. Zyrapi, do t'jua lexoj sepse lidhet me atë që sapo
22 diskutuam. Paragrafi thotë kështu:

23 "Pjesëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nuk ishin
24 të gjithë të stacionuar në të njëjtin vend, por shumë prej
25 pjesëtarëve e kishin bazën në Shqipëri. Në atë kohë, për të

1 kryer operacionet e rëndësishme luftimi, forcat në terren në
2 teori duhej të merrnin miratimin e Shtabit të Përgjithshëm.
3 Megjithatë, në praktikë kjo nuk ndodhte. Deri në fund të vitit
4 1998, është fakt i qartë se në duart e komandantëve të zonave
5 ishte përqendruar më shumë pushtet se në duart e Shtabit të
6 Përgjithshëm.”

7 I qëndroni ende këtij vlerësimi?

8 PË. Plotësisht, po.

9 PY. Fakti që komandantët e zonave kishin më shumë pushtet në
10 duart e tyre se Shtabi i Përgjithshëm, vinte për faktin sepse
11 ata e kishin marrë pozicionin e tyre si komandant zone prej
12 njerëzve, prej njësiteve të tyre, në bazë, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Po ndonjë faktor tjetër a ka, mbi të cilin e keni bazuar
15 këtë vlerësim? Kur themi, për faktin që komandantët e zonave
16 kishin më shumë pushtet në 1998 se sa Shtabi i Përgjithshëm, e
17 bazoni diku tjetër këtë vlerësim?

18 PË. E bazoj, e kam bazuar në atë se si janë, edhe kanë pas
19 autoritetin te njësitë mbrenda zonave të veta. Dhe kanë pasur
20 autoritetin mbrenda dhe jo vetëm aty, por edhe te popullata.
21 Aty se, Shtabi i Përgjithshëm dinte që ekziston, faktikisht në
22 atë kohë, Shtabi Qendror, por nuk kanë ditur se kush janë
23 anëtarët e Shtabit Qendror. kanë dit veç pak komandantët që
24 kush janë anëtarët e Shtabit Qendror edhe nuk kanë pas një
25 autoritet në opinionin për t’u njoftur kush janë. Ose për të

1 pas një autoritet ndaj, ma të madh. Kështu që komandantët e
2 zonave kanë pas autoritetin e plotë edhe ma të fuqishëm se
3 Shtabi i Përgjithshëm. Ato edhe gjatë, të mia që kam pas nëpër
4 këto zona, edhe gjatë punës sime në 1998.

5 PY. Faleminderit. Në gjykimin e parë të Haradinaj në 2007,
6 dhe kjo reflektohet në materialin IT-04-84 T3154-T3255 në
7 faqet 36 deri në 37 [Sipas përkthimit], ju keni thënë, nuk po
8 citoj por po them, që në vizitën në territoret, nga Mitrovicë
9 në Klinë, "ka pasur një komandë në nivel fshati apo nivel
10 lagjeje, por nuk ka pas strukturë komanduese. Nuk ka pasur një
11 komandë të mirëfilltë ushtarake ku të ishin edhe rangjet,
12 gradat përkatëse. Kishte disa grupe të pakoordinuara me njëri
13 tjetrin. Dhe prandaj shkova atje që t'u jepja përvojën time
14 edhe këshilla sesi të koordinonin me njëri-tjetrin". Saktë?
15 PË. Po, saktë është.

16 PY. Më pas në 2011, në gjykimin tjetër të Haradinaj, ju thoni
17 kështu.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në materialin IT-04-84, në faqen
19 675.

20 PY. Ju thoni kështu, ndonëse nuk mund të thoni që nuk ka
21 pasur Shtab të Përgjithshëm në ekzistencë në qershor të 1998,
22 nuk ka pasur koordinim të mirë mes shtabit dhe zonave
23 operative, koordinim të duhur më saktë, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. A mund të na shpjegoni, çfarë mungonte në koordinim?

1 Çfarë koordinimi nuk kishte mes Shtabit të Përgjithshëm dhe
2 mes zonave, çfarë elementi mungonte?
3 PË. Aty mungonte aspekti ushtarak. Se ne veç e spjegum dhe
4 shifet, dhe se simbas raporteve ishte në kohën kur ishin
5 njësitë e shumta të vetorganizuara dhe për t'i unifikuar ato
6 është dasht kohë. Dhe normalisht që ne kemi mujt të unifikojmë
7 shumë më vonë këtë drejtim që të ketë një sistem ushtarak të
8 cilit prej nalt-poshtë shkojnë urdhrat ose prej raportit, prej
9 poshtë-nalt, po foli poshtë-nalt nga shtabi në zonat e më
10 posht, ose nga zonat në shtab. Këto nuk ka qëndru. Ka mujt të
11 qëndron vetëm në atë kohë me ato çka kanë mujt t'i njofim kush
12 u njoft me anëtarët e shtabit dhe si komandant i zonës, dhe po
13 për ta pas një autoritet të plotë në atë zonën për të ditur
14 nuk, nuk ka pasur një koordinim, q'aq.

15 Edhe për arsye të, edhe të territoreve të cilat kanë qenë
16 të shkëputura dhe jo të kontrolluara të gjitha, por dhe për
17 arsye se sistemit të organizimit të ktyne shtabeve nuk ka qenë
18 në formën ushtarake, që ka mujt të shkojë një koordinim i
19 plotë edhe i mirë ushtarake. Për atë edhe ky konteksti edhe
20 kam fol.

21 PY. Të flasim për anëtarësinë në Shtabin e Përgjithshëm ose
22 Shtabin Qendror në verën e 1998. Është fakt që shumë prej
23 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë dhe
24 komandantin e përgjithshëm, ishin në Shqipëri, saktë?

25 PË. Po, në fakt. Q'ashtu është.

1 PY. Madje dhe në vende të tjera, saktë?

2 PË. Po, kjartë. Po, ashtu është.

3 PY. Sa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, me sa dini ju,
4 ishin në Kosovë në atë kohë?

5 PË. Po në atë kohë, po folim qershorin, korrik në atë kohë ka
6 qenë, anëtarët e shtabit kanë qenë Hashimi, Thaçi, Kadri
7 Veseli, Rexhep Selimi, Sokol Bashota, Jakup Krasniqi zëdhënës.
8 Këta i kam njoft, nuk ka pas më brenda të tjerë. Adem Grabovci
9 ndonjëherë, vinte, shkonte.

10 PY. Më herët keni thënë që dhe Hashim Thaçi shkonte e vinte
11 në fakt?

12 PË. Pikërisht po. Kur folim ju thatë mbrendë që e ke njoft,
13 këto i kam njoft mbrenda, e tash lëvizjet e tyre kanë qenë të
14 shpeshta. Sidomos të Hashim Thaçit e Kadri Veseli ma të
15 shpeshta kanë qenë të shkojnë jashtë, kurse këta të tjerët më
16 shumë brenda kanë ndejt.

17 PY. A mbaheshin takime të rregullta të Shtabit të
18 Përgjithshëm në verën e 1998?

19 PË. Vështirë kanë qenë që të bëhen mbledhjet e rregullta, se
20 ne folim nga aspekti kur e kam marrë detyrën si drejtor i
21 drejtorisë operative dhe që kanë fillue, domethënë, sulmet në
22 të gjitha territoret e Kosovës dhe tanë kohën jemi marrë me
23 çështjen e ofensivës dhe luftimeve. Kur jemi taku aty për aty
24 edhe *ad hoc* kemi mujt të takohemi po jo gjithnji shtabi i
25 plotë, por simbas nevojave dhe vendeve ku jemi gjetur dhe si

1 kemi mujt të kontaktohem. Nuk ka qenë shumë shpesh. Shumë,
2 shumë rrallë dhe shumë shpesh i kemi ndërru vendet për arsye
3 të sigurisë edhe nevojave të luftimeve që kanë qenë ose
4 nevojave që është dashtë të shkojmë prej një zonës në zonën
5 tjetër.

6 PY. Do t'ju tregoj diçka që është shfaqur dhe herë tjetër në
7 këtë gjykim, dhe do ju kërkoj të komentoni, sepse është diçka
8 që e keni përmendur ju dhe në dëshminë që keni dhënë në
9 çështjen Limaj.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Madje, jo, fillimisht do t'ju jap
11 kontekstin.

12 PY. Në gjykimin Limaj në 2005, ju keni thënë se keni marrë
13 pjesë me Agim Qelaj në përgatitjen e videove propaganduese në
14 verën e 1998, për ta bërë UÇK-në të dukej më profesioniste nga
15 ç'ishte në të vërtetë. A është e saktë?

16 PË. Po, është e saktë. Këto dhe dje dhe pardje, kur jam
17 pyetur dhe nga Prokurori kam cek që kam qenë për këtë çështje
18 dhe në zonë, te Brigada 121, në fshatin në drejtim të grykës
19 së, faktikisht, qafës së Duhlës, ku kam ndihmuar për ndihmë si
20 rreshtohen, si raportohej, si duhej të përgjigjen ose si duhej
21 të rreshtohen ushtarët.

22 PY. Do t'ju tregoj një video dhe do ju kërkoj më pas të
23 komentoni lidhur me këtë video.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Është videoja që ka numrin P01278.
25 Nuk jam i sigurt a ka zë. Për procesverbal ka dhe transkriptin

1 përkatës kjo video, dhe ka numrin 061427-27-TR-ET.

2 [Luhet videoincizimi]

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne s' kemi audio.

4 [Luhet videoincizimi]

5 "... [E padëgjueshme] ushtarak i shkolluar në shkollat
6 ushtarake, por në përvojat e luftërave në të cilat kam qenë më
7 parë. Ne eprorët ushtarakë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës
8 jemi të angazhuar në të gjitha strukturat e Ushtrisë
9 Çlirimtare të Kosovës për aftësimin e eprorëve dhe ushtarëve
10 në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë ushtrimit
11 të cilit ne i ushtrojmë ushtarët dhe eprorët, jemi shumë të [E
12 padëgjueshme] me aftësinë dhe shpejtësinë me të cilën ushtarët
13 dhe eprorët në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të
14 cilët ne aftësojmë dhe aq shpejt këto janë të përgatitur për
15 nevojat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe në, për
16 nevojat e betejës apo të luftërave të cilat zhvillohen në
17 territorin e Kosovës. Te eprorët ushtarakë kemi patur [E
18 padëgjueshme] që obligimin tonë ndaj atdheut ta kryejmë mu
19 ashtu në aftësinë e gjithë kuadrit ushtarak të Ushtrisë
20 Çlirimtare të Kosovës."

21 Z. MISETIC: [Përkthim] E njihni personin në video.

22 PË. Po, unë jam.

23 PY. A ju kujtohet kur e keni incizuar këtë video?

24 PË. Po, plotësisht.

25 PY. A mund të na thoni ku dhe kur është incizuar?

1 PË. Është incizuar në qershor të 1998, në fshatin Luzhnicë,
2 në territorin e Bjeshkëve të Berishës, faktikisht, në zonën e
3 përgjegjësisë mbasandej të Brigadës 121.

4 PY. Ajo që thoni ju në video, a pasqyron vlerësimin tuaj të
5 vërtetë sa i takon organizimit të UÇK-së asokohe, apo ishte
6 një video propagandiste siç keni thënë dhe në gjykimin e
7 Limajt.

8 PË. Po, është e vërtetë se kjo është në periudhën kur veç
9 ende ishin njësite ndaj nuk ishin të unifikuar ose të
10 organizuar, të unizuar. Por në një pjesë -- pjesë propagande
11 në të cilën në atë është ba që, faktikisht, jemi duke shkuar
12 nga ky drejtim, por në atë kohë nuk ka qenë bash që aq edhe e
13 zhvilluar siç e kam dhanë edhe intervistën.

14 PY. Në rregull. Tani të flasim për Drenocin përpara se të
15 bëjmë pushimin e drekës. Shumë herë keni dhënë dëshmi dhe keni
16 thënë se kur keni hyrë në Kosovë në fund të majit të 1998,
17 keni qëndruar disa ditë në Drenoc, kështu?

18 PË. Po.

19 PY. A është e vërtetë që atje keni qëndruar tri ditë?

20 PË. Po.

21 PY. A jeni i sigurt që ka qenë tri ditë apo mund të ketë qenë
22 edhe më gjatë?

23 PË. Mund të ketë qenë edhe pak më gjatë.

24 PY. Në rregull. Ju thoni arsyeja pse qëndruat specifikisht në
25 Drenoc ishte se ishte vend afër kufirit, saktë?

1 PË. Saktë.

2 PY. Gjatë qëndrimit tuaj në Drenoc, këto ditë ju përgatitët
3 ushtarët e shtabit të Drenocit, kështu?

4 PË. Po, ashtu është.

5 PY. Kjo ka qenë me kërkesë të shtabit lokal të Drenocit
6 asokohe, kështu?

7 PË. Po, ashtu është.

8 PY. Një nga arsyet pse ju kërkuan ju që t'i përgatisnit,
9 ishte se pse kishit qenë oficer vetë dhe ishit personi më i
10 duhur për t'i trajnuar, përgatitur, ata.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Këtë ia keni thënë ZPS-së në
12 provën materiale P01355, Pjesa 1, faqja 28.

13 PY. Saktë?

14 PË. Saktë.

15 PY. A është e vërtetë që shtabi lokal në Drenoc ishte po
16 ashtu i interesuar që të kishte ish-oficerë të armatës
17 jugosllave pranë shtabit?

18 PË. Po.

19 PY. I keni thënë ZPS-së në Pjesën 1 të intervistës suaj në
20 faqen 30 se ishte personalisht një anëtar i shtabit të
21 Drenocit, Mensur Zyberaj, që ju kërkoi, ju kërkoi dy
22 pjesëtarëve prej grupit tuaj që të qëndronit në Drenoc,
23 kështu?

24 PË. Po. Nuk është veç Zymberi që ka kërkoi, ka kërkoi edhe
25 komandanti i shtabit lokal, ka qenë Gjermani. Kështu me

1 kërkesën e tyre unë, ia ndalëm dy oficerë. Është ndal Mahir
2 Hasani edhe Binak Gashi.

3 PY. A është e vërtetë që Mahir Hasani dhe Binak Gashi po
4 ashtu shprehën dëshirën e tyre të qëndronin në Drenoc?

5 PË. Po.

6 PY. Gjatë kohës që ishit në Drenoc, i thatë ZPS-së në Pjesën
7 1 të intervistës suaj, pra i thatë se ju qëndruat, por Hashim
8 Thaçi dhe Kadri Veseli shkuan në Deçan, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Mbase bëra një ngatërresë. Më duket se bëra një
11 ngatërresë. Në fillim qëndruat në Deçan dhe pastaj shkuat në
12 Drenoc, kështu? Do ta bëj dhe një herë, më falni. Do ta
13 riformuloj pyetjen.

14 Hashimi dhe Kadriu shkuan në Deçan, dhe ju qëndruat në
15 Drenoc dhe pritët që ata të ktheheshin, kështu?

16 PË. Në fillim kur kemi mbërrir në Drenoc, jemi, kemi shkuar së
17 bashku. Nga aty kemi shkuar, ka shkuar në zonën e Dukagjinit,
18 faktikisht, në Deçan, është, në atë kohë ishin luftimet në atë
19 territor, për të parë se çka po ndodh e çka ka. Ne kemi
20 qëndruar në Drenoc dhe kemi pritur derisa të kthehet.

21 PY. Më pas, kur u kthyen, vazhduat:

22 "... për në Drenoc-Likoc."

23 Sipas asaj që i keni thënë ZPS-së.

24 PË. Pastaj vazhduam prej Drenocit shkuam në Likoc.

25 PY. Pra, nëse hytë në Kosovë më 29 maj, dhe qëndruat tri a

1 katër ditë atje, i takon që keni shkuar më 1 ose 2 qershor

2 drejt Drenocit dhe Likocit, kështu?

3 PË. Sigurisht po. Nuk më kujtohet data, s'po muj me datën.

4 PY. Tani do ju pyes si e gjetët situatën në Drenoc kur shkuat

5 atje. ZPS-së i thatë që vutë re që shtabi ishte shumë i

6 lokalizuar dhe nuk vepronte në, nuk vepronte shumë gjerë, por

7 vepronte vetëm në fshatrat rreth e rrotull, saktë?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Pra, situata në Drenoc ishte e ngjashme me atë të

10 Dukagjinit, ku kishe disa grupe të UÇK-së të organizuar vetë

11 në një fshat, por nuk koordinonin me të tjerët, kështu?

12 PË. Po, po, ashtu është.

13 PY. A është e saktë që komandantët e këtyre grupeve lokale po

14 ashtu emëroheshin nga fshatarët e zonave apo nga zonat lokale?

15 PË. Ata veç ishin emëruar nga këto zonat e dalë, nga këto

16 vendet, grupeve, fshatrave, lagjeve.

17 PY. A mban mend një rast në qershor të 1998 ku t'u desh të

18 ndërhyje dhe, sepse pati një mosmarrëveshje mes Smajl Latifit

19 dhe Xhemë Gashit në shtabin e Drenocit sepse Smajl Latifi nuk

20 donte që të punonte me shtabin e Drenocit?

21 PË. Po, po. Plotësisht.

22 PY. A mund të na thuash çfarë, për çfarë ishte kjo

23 mosmarrëveshje dhe si u zgjidh kjo?

24 PË. Si e cekëm dhe më herët, çdo ku ka pas këto probleme mes

25 këtyre njësive për shkak se kanë qenë njësi të ndryshme lokale

1 të formume. Dhe çdonjëni ka këqyr, nuk ka këqyr, nuk ka --
2 disa, disa nuk kanë mujt, nuk janë pajtu të hyjnë në komandën
3 e dikujt, ose të unifikohet njësia. Këto ishin problemet me,
4 në atë kohë. Dhe më kujtohet që rasti i tillë ka qenë mes
5 Smajl Latifit dhe Xhemë Gashit.

6 Kështu që, kam shkuar disa herë të bisedojmë, dhe kemi
7 bisedu dhe kemi ofru këto njësi që të jenë së bashku. Dhe janë
8 unifikuar edhe pas një kohe bisedave kur kemi shku kemi bë
9 bashkë me Smajlin edhe me Xhemë Gashin, ose komandantin
10 Gjermanin, të Drenocit.

11 PY. Në Pjesën 1 të intervistës suaj në faqen 32 i keni thënë
12 ZPS-së se gjatë kohës që ishit në Drenoc:

13 "... nuk ka pas ekzistuar policia ushtarake dhe nuk ka
14 pas asnjë lloj strukture ushtarake. Nuk pas asnjë polici
15 ushtarake asnjë emblemë e as nuk më prezantoi njeri ndokënd që
16 të ishte pjesë e policisë ushtarake".

17 Kështu?

18 PË. Po, për këtë kohë kur kemi qenë, kur kemi mbërri aty, nuk
19 ka pas polici ushtarake, s'kam pa, s'kam pa as shenja të
20 policisë ushtarake në atë kohë.

21 PY. Më pas në Pjesën 1 të intervistës suaj vijoni dhe i thoni
22 Prokurorisë. Përshkruani situatën në terren dhe i thoni, këto
23 grupe lokale "nuk ishin të koordinuara, ishin, nuk ishin të
24 lidhura me njëra-tjetrën, nuk kishin kontakte me njëra-
25 tjetrën. Secili e quante veten komandant dhe mendonte se ishte

1 mbi të tjerët.”

2 A përshkruan kjo saktë situatën që keni gjetur ju në
3 Kosovë në qershor të 1998?

4 PË. Po, pikërisht kjo përshkruan situatën komplet. Jo veç në
5 këtë territor, por në shumë terriore të tjera.

6 PY. Në Pjesën 1, faqja 33 e intervistës suaj, thuhet:

7 “... Drenoci nuk kishte lidhje me shtabin”, do të thotë
8 Shtabi i Përgjithshëm. “Komanda, nga ana tjetër, thjesht ishte
9 atje, ishte si një linjë tranzitore mes Kosovës drejt
10 Shqipërisë dhe Shqipërisë drejt Kosovës.”

11 Pastaj vijoni dhe thoni:

12 “Asaj kohe këto njësite nuk ishin të lidhura me shtabin.
13 Ishin të lidhura me zonat operative, dhe zonat operative ishin
14 ato që kishin lidhje me shtabin”.

15 Saktë?

16 PË. Po, saktë. Ashtu ka [E padëgjueshme].

17 PY. A vazhdoi të ishte njësoj situata në fundin e verës së
18 1998, gushtin e 1998? Ta riformuloj për të qenë më konkret.

19 Kjo çështja e faktit që shtabet lokale [Korrigjim i
20 përkthyesit: shtabeve lokale] nuk koordinonin me njëri-
21 tjetrin, a vijoi të ishte problem gjatë gjithë verës së 1998?

22 PË. Po në disa vende, po. Kemi pas probleme. Dhe qershorit,
23 edhe korrikut, edhe gushtit. Por pastaj jo, veç në gusht kemi
24 fillue ristrukturimi kur kanë qenë, të brigadave, dhe pak ma
25 pak ka pas këto probleme. Por tash për momentin nuk më

1 kujtohet saktë në cilin territor, por shumë më pak. Për sa i
2 përket qershorit, korrikut, po, goxha shumë.

3 PY. Shkurtimisht flasim dhe për Prizrenin përpara drekës. Në
4 Pjesën të intervistës për ZPS-në, ju pyesin:

5 "Ku ka qenë shtabi lokal i Prizrenit?"

6 Ju thoni:

7 "Kur shkova për herë të parë, s'ka pasur fare shtab, ka
8 pasur disa grupe të ndryshme... të gjitha këto grupe ishin, u
9 bashkuan, dhe më pas u krijua shtabi lokal në zonën e Drinit -
10 -

11 PË. Vrrinit.

12 PY. -- Vrrinit, dhe u vendos në Jeshkovë." Kështu?

13 PË. Po, po, ashtu është.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, shoh që ka
15 vajtur ora për pushimin e drekës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
17 tani do bëmë pushimin e drekës, do rifillojmë në orën 14.30.
18 mos flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshminë
19 tuaj, ju lutem. Kaq për momentin. Mund të dilni me Asistenten
20 e Sallës.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
23 orën 14.30.

24 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

25 --- Seanca rifillon në orën 14.31

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam një
2 urdhër me gojë për sa i përket përjashtimit të evidencës të
3 Dëshmitarit W04445 që është dokumenti F02414 për përjashtimin
4 e tij, kërkesë e bërë nga Mbrojtja e z. Selimi.

5 Mbrojtja e z. Selimi kërkon që të përjashtohen këto prova
6 sipas informacionit të ZPS-së ose të dhënë ZPS-së nga
7 Dëshmitari W04445 gjatë seancës përgatitore, që presim edhe
8 një konfirmim edhe nga dëshmitari që z. Selimi ka qenë i
9 pranishëm në një vendndodhje të caktuar ndërkohë që dëshmitari
10 ka qenë i ndaluar atje. Mbrojtja shprehet që kërkon
11 përjashtimin e kësaj prove mbi bazë të faktit që shkon përtej
12 gamës së aludimeve të bëra në këtë aktakuzë si edhe në të
13 gjithë dosjen parapërgatitore dhe që nuk ka të bëjë me
14 aktakuzën.

15 Dhe që ZPS-ja thotë që Trupit Gjykses duhet në fakt ta
16 hedhë poshtë kërkesën e z. Selimi për arsye se ky fakt ose ky
17 dokument nuk prefshin fakte materiale dhe në dritë të kësaj i
18 është dhënë mundësia Mbrojtjes për të t'i bërë kundërpyetjet
19 dëshmitarit në fjalë.

20 Atëherë Trupi Gjykses ka vendosur si më poshtë vijon.

21 Trupi Gjykses është dakord me Mbrojtjen e z. Selimi që me
22 këtë rast që është shpjeguar në përgatitjen në dokumentin
23 përgatitor të dëshmitarit, në fakt, flitet, pra, jepet ky
24 informacion i ri, i cili nuk ka qenë në fakt i dhënë
25 Mbrojtjes. Dhe Trupi Gjykses gjithashtu pranon që prania e z.

1 Selimi në atë vendndodhje të specifikuar nga dëshmitari, nuk
2 është shprehur në këtë formë në aktakuzë dhe nuk shpjegon në
3 formë të qartë atë që është në dosjen të ZPS-së përpara gjyqit
4 dhe që në të nuk janë as deklaratat e dëshmitarit të
5 përfshira.

6 Megjithatë, Paneli, Trupi Gjykses është i kënaqur që
7 prova ka fakte relevante dhe rrethana të cilat në veçanti në
8 atë që ka thënë, me atë që mendohet që të ketë thënë z.
9 Selimi. Dhe Trupi Gjykses është i përgatitur që të lejojë ZPS-
10 në që të vazhdojë me këtë provë.

11 Në rast se Mbrojtja e z. Selimi do kërkojë që të bëhet
12 një hetim shtesë në lidhje me këtë informacion të ri që ka
13 dalë në dritë dhe ky informacion, pra, të konsiderohet nga
14 hetimi, atëherë duhet të ishte dhënë dëshmitarit, do të
15 kërkojë që të rithirret dëshmitari në një fazë të dytë në
16 lidhje me këtë çështje.

17 Ky është dhe fundi i urdhrin që sapo dha Paneli.

18 Znj. Sekretare, mund të ftojme tani në sallë dëshmitarin.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kjo që do të them tani nuk ka të
20 bëjë, në fakt, nuk e ndalon dëshmitarin që të hyjë në sallë,
21 po thjesht për t'ju thënë që ne do të kërkojmë një orë, një
22 orë e gjysëm sot dhe ndoshta pak më shumë nesër për
23 kundërpjetje. Dhe thjesht për t'i thënë Prokurorisë që duke
24 patur parasysh këtë lloj orari atëherë kjo do të thotë që
25 ndoshta ky do të jetë i vetmi dëshmitar që do të sillet nesër.

1 Ishte thjesht për arsye përgatitore.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

3 Atëherë ju do t'i bëni pyetjet ashtu siç e mendoni ju dhe si
4 çdo duhet të bëhen.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në rregull. Ishte thjesht për të
6 njoftuar Gjykatën.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 E vlerësojmë këtë fakt.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

11 [Përkthim] Ndjesë. Tani do të vijojmë me kundërpjetet nga
12 Mbrojtja e z. Thaçi. Ju lutem dëgjojini ato me vëmendje.

13 Mund të vijoni, z. Misetic.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Mirëdita, z. Zyrapi.

16 PË. Mirëdita.

17 PY. Dëshiroj që të vazhdojmë aty ku e lamë përpara pushimit
18 të drekës duke kaluar zonat e ndryshme dhe nuk besoj se do ta
19 zgjasë shumë.

20 Në zonën e Llapit, a është e saktë që komandant Remi
21 ishte në formë efektive, po themi, komandanti i zonës në
22 momentin që ju keni patur kontakt së pari me të?

23 PË. Po, ishte komandant i zonës.

24 PY. Dhe a e dini sesi u bë ai komandant i zonës?

25 PË. Jo, nuk e di.

1 PY. A e dini apo është vlerësimi juaj që ai u bë komandant
2 zone në një mënyrë të përngjashme me atë të mënyrës sesi u
3 zgjodhët komandantët e zonës së Dukagjinit, me pak fjalë, që
4 kishte mbështetjen e njësiveve lokale në zonën e Llapit dhe
5 ata e mbështetën që ai të ishte komandant i zonës?

6 PË. Po nuk e di sesi ka qenë më herët atje te ta. Po si ajo
7 shifet dhe ai ka pas autoritet në zonën e vet dhe te njësitë
8 të cilat kanë qenë zonën e Llapit.

9 PY. Në Drenicë, në lidhje me Syleman Selimin, a e dini sesi u
10 bë ai komandant i zonës së Drenicës?

11 PË. Përafërsisht si edhe ke zona tjera komandantët që janë
12 bë.

13 PY. Pra, me pak fjalë kishte mbështetjen e njësiveve lokale
14 të UÇK-së që e vendosën ata në një pozicion me autoritet, apo
15 jo?

16 PË. Po.

17 PY. Okej. Po më pas në verë, në një moment të caktuar Shtabi
18 i Përgjithshëm dhe ju po lëshonit emërimet zyrtare, formale. E
19 mbani mend këtë?

20 PË. Nuk e mbaj mend. Në për 1998, po. Po gjatë verës nuk më
21 kujtohet bash saktë kur.

22 PY. Okej. Përse, nëse mund të na shpjegoni, nëse ju i gjetët
23 këta persona që ishin tashmë në komandë të zonave pse lëshuat
24 ju emërimet zyrtare të këtyre personave si komandant më pas?

25 PË. Me çka di unë për këtë që po e thoni ju, këto ka fillue

1 lëshimi i këtyne urdhname dhe faktikisht vendosjen ka qenë
2 qysh në vjeshtë dhe më vonë kur është bë dhe riorganizimi dhe
3 i shtabit dhe i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për më herët
4 nuk e di qysh janë kanë lëshume dhe si janë lëshu.
5 PY. Le të fillojmë me gjërat që ju dini. Pra, ju besoni që
6 këtë, kjo ka filluar pas riorganizimit, megjithatë pyetja ime
7 është gjithsesi pse keni lëshuar emërimet zyrtare për këta
8 persona në rast se ata ishin tashmë ishin komandant të zonave?
9 PË. Unë kesh shumë i kjartë në ato. Për më herë nuk e di si
10 ka qenë. Po kur filloj riorganizimi i shtabit dhe i Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës atëherë janë lëshuar. Se normalisht
12 është riorganizimi se përpara kanë qenë nënzona, tani u bënë
13 zona. Përpara nuk kanë qenë brigadat. Janë bë brigadat, janë
14 bë komandat dhe normalisht u dasht dhe u nevojiten që të
15 lëshohen dhe urdhrat e tillë për emërimet edhe komandantëve
16 edhe eprorëve të tjerë të komandave.
17 PY. Dhe ashtu siç e kemi thënë tashmë, ju thatë që në mes të
18 korrikut ju u bëtë drejtori i drejtorisë operative.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaj për këtë arsye të vendosim në
20 ekran provën P0643-ET në faqen SPOE00229213 si në shqip ashtu
21 edhe në anglisht.

22 PY. Jua treguan këtë dokument --

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më falni. Z. Misetic, më
24 falni që po ju ndërpresim, po në faqen 8 besojmë që kemi një
25 gabim në 86, më falni, të transkriptit që del në kohë reale ku

1 pyetja jua j është shkruar si:

2 "... a është e saktë që komandant Drini ka qenë komandant
3 i zonës", zonës së Llapit.

4 Dhe ndoshta e kishit për komandant Remin?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e di në se e thashë unë Drini,
6 po më duket se e thashë Remi. Në rast se e kam thënë unë
7 Drini, atëherë e kam unë fajin në fakt dëshmitari tha që ishte
8 Remi, kështu që besoj që është gabim në shkrimin që është bërë
9 në transkript.

10 PY. Dëshmitar, Prokuroria jua tregoj këtë dokument gjatë
11 pyetjeve që ju bënë dhe dëshiroj që të flasim pak për këtë
12 dokument. Këtu duket sikur është një dokument që përmban
13 procesverbalin e mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm ose të
14 UÇK-së në datën 9 korrik dhe më pas fillohet me raportimin për
15 datën 23 korrik.

16 Pra, më 23 korrik ose të paktën tek ai nëntitull thuhet:

17 "Bislum Zyrapi vjen dhe merr detyrën e kryeshefit të
18 drejtorisë operative. U diskutua rasti i Rahovecit".

19 Po e lë pak këtu këtë bisedë. Por a e mbani mend që ka
20 qenë data 23 korrik kur ju keni marrë detyrën e shefit të
21 drejtorisë operative?

22 PË. Jo, nuk ka qenë 23 korrik. Më herët.

23 PY. Okej. Pra, sipas mendimit tuaj, ky është gabim në
24 shënimet e mbajtura në procesverbal të këtij diskutimi?

25 PË. Po. Po për shka po e shof këtu ça po lexoj thotë në

1 fillim për mua kur folët:

2 "Në shtab vjen Bislrim Zyrapi dhe kur në detyrën e
3 kryeshefit, në detyrën e kryeshefit të drejtorisë operative. U
4 diskutua rasti i Rahovecit".

5 Nuk thuhet që unë jam vendosë q'atë kohë. Sa po lexoj
6 tash në qoftë se po lexoj mirë.

7 PY. Po, po pyetja ime është a është e vërtetë që ju e morët
8 këtë detyrë, këtë pozicion në 23 korrik?

9 PË. Jo, thashë edhe më herët. Më herët e kam marrë detyrën.

10 PY. Okej.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Tek faqja në gjuhën shqipe të
12 kalojmë lart në këtë faqe.

13 PY. Dhe është rreshti ku shihni emrin Xhavit Haziri. Besoj që
14 është një gabim në anglisht në përkthim, prandaj ju lutem na e
15 lexoni pak këtë fjali, me Xhavit Hazirin.

16 PË. Së pari, nuk njoh kush është Xhavit Haziri.

17 PY. Lexoni pak fjalinë mbi Xhavit Hazirin, ju lutem.

18 PË. Mbi Xhavit Hazirin po thotë:

19 "Në këtë mbledhje për shef në Shtabin e Përgjithshëm ka
20 pas caktuar, ka pas caktuar Xhavit Haziri" -- për mu s'është e
21 kuptueshme kjo edhe kjo përpara ku ka qenë me një procesverbal
22 të mëhershëm, ditë të mëhershme.

23 PY. Do t'ju kërkoja që të shihnit nëse juve ju duket dhe në
24 qoftë se ju sugjeroj unë që thuhet që:

25 "Xhavit Haziri u caktua si shef i Shtabit të Përgjithshëm

1 në këtë mbledhje".

2 Thuhet kjo në gjuhën shqipe, sipas jush aty?

3 PË. Q'ashtu po shkrun.

4 PY. Okej. A e dini se kush është Xhavit Haziri?

5 PË. Jo. As nuk e kam dëgjuar as nuk e njof.

6 PY. Okej. Ky emërim për të qenë drejtori i drejtorisë
7 operative, ju i thatë ZPS-së në Pjesën 2, në faqen 9, që ju e
8 keni marrë këtë detyrë nga Sokol Bashota, është e saktë kjo?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. Në rregull. Dhe vetëm pasi e keni marrë emërimin, detyrën
11 ju mësuat se Azem Sylja ishte komandanti i përgjithshëm i UÇK-
12 së, është e saktë kjo?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Dhe kjo është në Pjesën e 2-të të intervistës tuaj të
15 ZPS-së në faqen 11.

16 Ju i keni thënë ZPS-së në Pjesën e 2-të të intervistës,
17 në faqen 11, që komandanti i përgjithshëm miratonte propozimet
18 tuaja dhe bënte emërimet, është e saktë kjo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, nga përvoja juaj, praktika e punës ka qenë që ju
21 jepnit propozimet për emërimet dhe komandanti i përgjithshëm i
22 miratonte ato?

23 PË. Si mbas rregullave është thënë që, po, propozohen. Në
24 qoftë se e marrim nga aspekti ushtarak, Shtabi i Përgjithshëm,
25 në nivelin e Shtabit të Përgjithshëm, përveç asaj ekziston

1 edhe drejtorja e personelit e cila i ka të dhënat për eprorët
2 të cilët propozohen në pozitë komanduese. Normalisht, pyetet
3 edhe shefi i shtabit për shkak se ka punë të bënë me njësitë
4 dhe ka njohuri sesa janë të aftë dhe eprorët që edhe ai duhet
5 të jepte mendimin e vet. Po ma së shumti është dhënë nga ana e
6 komisionit kadrovik dhe pastaj komandanti i përgjithshëm ka
7 vendosur ose ka shkruar vendimin për vendosjen në detyrat e
8 eprorëve të lart.

9 PY. Tani po flas në mënyrë të posaçme për marrëdhënien tuaj
10 me Azem Sylën veçanërisht. A mbani mend ndonjë moment kur ju
11 keni bërë ndonjë sugjerim për emërimin e ndonjë eprori,
12 oficeri dhe Azem Sylë ta ketë kundërshtuar atë ose të mos ta
13 ketë pranuar?

14 PË. Me çka e mbaj mend jo. Asnjëherë.

15 PY. Në rregull. Sa u përket kritereve, kë përzgjidhni ju,
16 çfarë kritereve kishit për të zgjedhur personat e duhur ose
17 për t'i propozuar këta persona në detyra të caktuara në UÇK?

18 PË. Personalisht unë gjithnjë e kam këqyrë si aspekt
19 ushtarak, së pari është nga aspekti ushtarak, sa ka dijeni,
20 aspekti i shkollimit dhe aftësive të tij dhe autoriteti i tij
21 sa është në aftësi.

22 PY. A keni marrë parasysh, për shembull, lidhjet e tyre
23 politike për këto kritere ose cilave parti u përkisnin. Duhet
24 të përgjigjeni me zë.

25 PË. Jo, asnjëherë.

1 PY. Në rregull. Në rast se dikush, për shembull, ishte anëtar
2 i LDK-së, ju a hidhnit poshtë kandidaturën e tyre si, për
3 shembull, një person i mundshëm për në UÇK?

4 PË. Jo.

5 PY. A jeni në dijeni të një emërimi që u bë që është bërë nga
6 Azem Syla dhe të cilin ju e keni kundërshtuar?

7 PË. Jo, nuk e di.

8 PY. Në rregull. Dëshmitar, po i kthehem tani çështjes së
9 Rahovecit. Ju keni dëshmuar që ju morën informacion që do të
10 duheshit të largoheshit nga Dukagjini ku po qëndronit dhe
11 duhet të shkonit në Rahovec në korrik të 1998, e saktë?

12 PË. E saktë.

13 PY. Dhe arsyeja për lëvizjen tuaj ishte për sulmet e fundit
14 që kishte marrë UÇK-ja në Rahovec, e saktë?

15 PË. Po, e saktë.

16 PY. Në rregull. Tani po të shikojmë dokumentin që ndodhet në
17 ekran, në dokument thuhet, në mes të faqes, në anglisht të
18 paktën:

19 "Në të dyja vendet - në lidhje me Rahovecin ashtu si dhe
20 /nuk lexohet/ pastaj dhe pjesa e epërme - udhëzimet e Shtabit
21 të Përgjithshëm të UÇK-së kanë qenë që të mos hyhej në sulme.
22 Udhëzimet e SHP-ës nuk janë përfillur ... dhe pasi ka hyrë
23 SHP-ja ka qenë e detyruar të marrë masa".

24 A është e shpjeguar saktë kjo sipas njohurisë tuaj?

25 PË. Po. Saktë është e shpjeguar. Se në atë kohë kur ka ndodh

1 rasti në Rahovec ne nuk kemi dhënë si Shtabi i Përgjithshëm as
2 dritën e gjelbërt, as nuk kemi sugjeruar që të shkohet në atë
3 sulm, se për të shkuar në sulme të tilla në vendbanime u dasht
4 një kohë goxha e gjatë dhe njësi, mjete të përgatiten për t'u
5 marrë një operacion i tillë. Në këtë rast, komandanti i kësaj
6 njësie lokale ka bërë një veprim të cilin nuk na ka pyetur, ka hy
7 në Rahovec dhe kanë filluar sulmet të cilët pastaj kanë pas
8 një pasojë jashtëzakonisht negative në këtë rast.

9 PY. Po. Cilat ishin pasojat negative?

10 PË. Pasojat negative edhe në njerëz edhe në humbjet e
11 territorit edhe në humbje të autoritetit edhe në humbje se
12 prej kësaj kanë fillu pastaj edhe sulme të tjera territoret e
13 Kosovës dhe së shpejti shumë njësi u destabilizuan dhe na u
14 dasht kohë pastaj shumë e gjatë që t'i bëmë në rend dhe të
15 ristrukturohet ose të bind forcat ushtarake pasi sulmit të
16 qershorit -- pas sulmit të 1998, verë 1998.

17 PY. Cili ishte ndikimi që pati kjo mbi popullsinë civile
18 shqiptare?

19 PË. Në shumë, për arsye se pastaj pas këtyre humbjeve dhe
20 këtyre, këtij sulmi, pak a shumë, ke dhe te popullata civile
21 nuk ishte veç e kënaqur me veprimin tonë dhe normalisht që
22 patëm edhe këtu pasojat e saj.

23 PY. Po. Por pas Rahovecit filloi ofensiva, është e saktë kjo,
24 ofensiva serbe e kam fjalën?

25 PË. Unë veç e shpjegova se pas saj, veç filloi ofensiva dhe

1 në territore tjera dhe në zona tjera dhe në tërë territorin e
2 Kosovës. Dhe kështu që patëm pasoja të mëdhaja.

3 PY. Po. ZPS-ja ju pyeti dhe ju tregoi një raportim që thuhej
4 që ishte shkruar, përpiluar nga shtabi lokal në faqen 11 të
5 dokumentit P01355.3, ju dëshmuat që nuk e kishit parë
6 ndonjëherë më parë këtë raport, të paktën jo përpara se jua
7 tregoi ZPS-ja, është e saktë kjo?

8 PË. Po, e saktë.

9 PY. Okej. Ju a keni urdhër, i keni dhënë urdhër shtabit lokal
10 që të kryente sulme, për shembull, të tilla që të tërhiqte
11 vëmendjen e serbëve për të mbrojtur popullsinë civile?

12 PË. Jo.

13 PY. A dini nëse ndokush në Shtabin e Përgjithshëm i ka dhënë
14 urdhra të tillë, pra, për të shpërqendruar forcat serbe për të
15 mbrojtur popullsinë civile?

16 PË. Mesa më kujtohet mua apo në atë kohë anëtarët e shtabit
17 disa kanë qenë pranë meje, do kanë qenë në zona tjera, po sa e
18 di unë, jo.

19 PY. Në rregull. Ju keni dëshmuar që z. Thaçi ka qenë me ju në
20 një moment të caktuar, është e saktë?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe pastaj ju i keni thënë ZPS-së në Pjesën e dytë të
23 intervistës tuaj, në faqen 33, që më pas, pak më pas ai u
24 largua nga Drenica ose jo, u largua për të shkuar në Drenicë
25 pak më vonë, është e saktë kjo?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Në rregull. Por ju i thatë ZPS-së në Pjesën 2, faqen 34,
3 që Hashim Thaçi personalisht ka ndihmuar duke ndërprerë rrugën
4 kryesore dhe rrugën kryesore në fakt që lidhte Malishevën dhe
5 për të mbyllur pra, pikërisht këtë pjesë për të mos avancuar
6 forcat serbe. E keni thënë ju këtë?

7 PË. Po, e kam thënë unë.

8 PY. Po pse, për shembull, duhet ta bënte këtë Hashim Thaçi
9 duke i dhënë një buldozeri?

10 PË. Pikë së pari, Hashim Thaçi nuk ka vozit buldozerin,
11 dikush ka qenë vozitës, po ky ka qenë pranë aty. Unë e kam
12 gjet aty afër kur kam mbërrir në territorin e Rahovecit që u
13 kanë duke shkëputur rruga. Dhe është mendim me vend se
14 shkëputet rruga për arsyet mos me depërtu në njësitë të
15 blinduara dhe mos me depërtu ma tutje në drejtim të
16 Malishevës. Për këtë është edhe arsyeja, domethënë, të
17 shkëputet rruga Rahovec-Malishevë.

18 PY. Ju keni thënë ose ju bënë një pyetje në lidhje me a dinit
19 gjë për aludime që civilë serb ishin rrëmbyer dhe ZPS-ja jua
20 ka bërë këtë pyetje në Pjesën e Tretë, në faqen 14 të
21 intervistës tuaj. Dhe përgjigja jua ka qenë që ju nuk kishit
22 dijeni për ndonjë civil që të jetë rrëmbyer në kohën e
23 operacionit të Rahovecit, është e saktë kjo?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Por më pas ju thatë që keni dëgjuar për këtë nga mediat

1 në fund të gushtit 1998, është e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. E keni thënë që ju e keni mësuar këtë gjë nga një mohim
4 që është lëshuar nga UÇK-ja për të cilën mësuar nga media,
5 është e saktë kjo?

6 PË. Po.

7 PY. ZPS-ja ju ka pyetur nëse ka patur hetim të rrëmbimit të
8 kësaj çështjeje, pra, të rrëmbimit të civilëve serbë dhe ju
9 keni thënë këtë gjë dhe do të pyes nëse vazhdon të jetë kjo
10 dëshmia juaj, pra, kjo që i keni thënë ZPS-së në Pjesën e
11 Tretë, në faqen 17 në rreshtat 10 deri në 17:

12 "Nuk mund të flas për të tjerët, por gjatë kësaj periudhe
13 unë personalisht nuk mund të kryeja ndonjë hetim për të gjetur
14 se kush ishin autorët. Pozicioni im ishte i tillë që unë isha
15 i angazhuar vetëm në aspektin operativ dhe tek trajnimet. Nga
16 ana tjetër ka të tjerë dhe ata duhet t'i kishin bërë hetimet
17 por nuk e di se këta anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm sa do
18 të kishin qenë në gjendje të bënin çfarëdolloj hetimi".

19 Është e saktë kjo?

20 PË. Po, shumë e saktë.

21 PY. Dhe në Pjesën e 3-të të intervistës tuaj, në faqen 18,
22 rreshtat 13 me 19, ju keni thënë:

23 "Po flas nga këndvështrimi im dhe kur po riorganizohej
24 UÇK-ja nga nëntori e tutje, duhet të theksohet këtu që shtabi
25 që ka qenë aty deri atëherë nuk ka qenë profesional dhe nuk

1 kishin hetues apo juristë të cilët do të kishin pasur
2 mundësinë potencialisht që të bënin këtë lloj hetimi.”

3 Është e saktë kjo?

4 PË. Po. Po, shumë e saktë.

5 PY. “Ne po e përgatisnim asokohe këtë staf, përfshirë këtu
6 edhe mua, po edhe njësitë që ishin në varësi të shtabit, po i
7 përgatisnim, po i trajnonim të gjithë që të dinin se çfarë
8 detyrash duhet të kishin dhe ta kthenim këtë në një ushtri të
9 përshtatshme që kishte një zinxhir komandues që të fillonte
10 nga lart poshtë dhe më pas dhe nga poshtë me drejtim lart.

11 “Unë personalisht nuk kam pasur kohë të merresha me këtë
12 çështje dhe nuk mund të hetoja çdo incident që ka ndodhur që
13 nga fillimi.”

14 Saktë?

15 PË. Saktë.

16 PY. Tani, disa pyetje faktike. Në gusht të 1998, a keni pasur
17 ju kompetencë të arrestonit, për shembull, një komandant zone?
18 S’e kam fjalën teorikisht këtu, në realitet.

19 PË. Jo.

20 PY. A keni pasur njësi të policisë ushtarake në dispozicionin
21 tuaj si drejtor i drejtorisë operative?

22 PË. Jo.

23 PY. Nëse mund ta arrestonit një komandant zone çfarë do të
24 bënit në momentin që do ta arrestonit? Ose, me fjalë të tjera,
25 çfarë mase disiplinore mund të merrnit ndaj një komandanti

1 zone apo komandanti brigade?

2 PË. Tani folim për atë kohë, nuk kemi marrë kurrfarë mase. As
3 kemi pas aparat të cilët mund të marrin këto masa. Po do çka
4 kemi mujt, kemi mujt veç me e ndërru prej pozicionit udhëheqës
5 komandues. Jo, asgjë më tepër.

6 PY. A keni pasur hetues ju në dispozicion që të hetonin
7 faktet?

8 PË. Jo.

9 PY. A ka pasur Hashim Thaçi në dispozicion njësi të policisë
10 ushtarake për të arrestuar komandantët e terrenit?

11 PË. Jo.

12 PY. Hashim Thaçi, si drejtor i drejtorisë për median, a
13 kishte hetues në dispozicion për të hetuar një rast të
14 terrenit?

15 PË. Jo.

16 PY. Hashim Thaçi, si drejtor i drejtorisë për median, a ka
17 pasur kompetencë që të ndëshkonte një komandant të terrenit në
18 cilësinë e tij si përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm
19 përgjegjës për median?

20 PË. Jo.

21 PY. Hashim Thaçi mesa keni ju dijeni, a ka qenë pjesë e
22 komandës operative të çdo njësie që mund të ketë marrë pjesë
23 në sulmin e Rahovecit?

24 PË. Jo.

25 PY. I thatë ZPS-së se çështjet disiplinore ishin vetëm

1 përgjegjësi e zonave - kjo është thënë në Pjesën 4, faqja 14,
2 rreshtat 21 dhe 24 - deri në momentin e ristrukturimit.

3 Kështu?

4 PË. Përgjegjësi në zonat dhe të brigadave, njësive kanë pas
5 komandantët e njësive dhe zonave. Edhe ristrukturimi kur është
6 bë prapë kanë pas nëpër zonat e veta komandantët e zonave. Në
7 shtab ka qenë vetëm atëherë kur është njësi të shtabit ose që
8 ka ardhë deri te niveli i shqyrtimit nga ana e sektorit
9 juridik.

10 PY. Të qëndrojmë tek periudha para ristrukturimit. Nëse një
11 komandant zone jepte masë disiplinore, këtë masë disiplinore a
12 ia raportonte ndokujt?

13 PË. Çka e di unë, në atë kohë, jo.

14 PY. Ju bëri ZPS-ja një pyetje, Pjesa 4, faqja 18. Pyetja
15 ishte kjo: Çfarë ndodhë në rastet kur një ushtar nga një zonë
16 ka kryer një vepër penale në një zonë tjetër dhe çfarë bëhej
17 nga pikëpamja disiplinore në këtë rast. Dhe ju jeni përgjegjor
18 dhe keni thënë që kjo ishte një çështje që e zgjidhnin vetë dy
19 komandantët e zonave para ristrukturimit?

20 PË. Kështu?

21 PË. Po, pikërisht.

22 PY. Ofensivat serbe në korrik, gusht dhe shtator çfarë
23 ndikimi patën, nëse patën ndikim, domethënë, çfarë ndikimi
24 patën ofensivat serbe në kompetencat tuaja për të disiplinuar
25 vartësit dhe për të kryer hetime?

1 PË. Në cilin aspekt? Fakt pyetja të jesh ma e kjartë.

2 PY. Për shembull, nëse këto ofensiva a patën ndikim në
3 organizimin e UÇK-së?

4 PË. Po. Në këtë kohë, unë edhe e ceka dhe ma herët, gjatë
5 ofensivave kur çetat kanë filluar qysh nga korriku e deri në
6 shtator e tetor kanë pas pasoja. Shumë njësi edhe zonat edhe
7 brigadat që të shumtat kanë qenë edhe të destabilizuara
8 totalisht. Dhe pas kësaj u desh të bëhet riorganizimi për t'i
9 rikthyer në formën e saj ushtarake. Kështu që pati shumë
10 pasoja.

11 PY. Është e drejtë të themi që armëpushimi i tetorit i dha
12 mundësi dhe ristrukturimit të UÇK-së?

13 PË. Po, plotësisht. Kjo na ka dhënë një mundësi që ne të
14 riorganizojmë si njësitë më poshtë ashtu edhe Shtabin e
15 Përgjithshëm.

16 PY. Tani dua të flasim për një temë tjetër që e keni
17 diskutuat edhe në pyetjet me Prokurorinë, bëhet fjalë për
18 rikthimin e Ramush Haradinaj si komandant zone të Dukagjinit
19 në fillim të shtatorit 1998.

20 A keni pasur dijeni ju në mes të gushtit 1998 që ka pasur
21 një mosmarrëveshje publike se kush do të përfaqësonte
22 shqiptarët e Kosovës në negociatat me qeverinë serbe? Edhe kjo
23 mosmarrëveshje ka qenë me z. Rugova nga një anë dhe Shtabin e
24 Përgjithshëm të UÇK-së nga ana tjetër.

25 PË. Jo, nuk pas dijeni me të.

1 PY. Do t'ju tregoj një dokument për të parë nëse ju ndihmon
2 me kujdesën.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dokument 1D00100. Në të dyja
4 gjuhët është faqja 2.

5 PY. Ndërkohë që presim dokumentin do t'ju bëj dhe këtë
6 pyetje. A e dinit ju që z. Rugova kishte formuar një ekip
7 negociues që do të përfaqësonte shqiptarët e Kosovës dhe
8 kishte përjashtuar UÇK-në si pjesë të këtij grupi në gusht të
9 1998?

10 PË. Unë nuk e kam ditë atë.

11 PY. Këtë thotë artikulli. Thotë:

12 "Rugova emëron ekipin negociator ..."

13 Data 13 gusht. Thotë:

14 "Kryeshtetas në hije i Kosovës Ibrahim Rugova tha në
15 Prishtinë më 13 gusht se ka caktuar një ekip negociator për
16 bisedime me autoritetet serbe. Trupi i ri përfaqëson Lidhjen
17 Demokratike të Kosovës së Rugovës, Demokristianët dhe Social-
18 Demokratët".

19 "Adem Demaçi dhe Mehmet Harizi, që janë pranë çlirimtare
20 të Kosovës ... e refuzuan ftesën e Rugovës për t'u bashkuar".

21 "UÇK-ja ka dalë me deklaratë në media më 13 gusht dhe ka
22 thënë që forcat tona po bëjnë "tërheqje taktike" në
23 kundërpërgjigje të forcave serbe. Sulmet e kanë bërë të qartë
24 që ekipi i Rugovës nuk flet për ekipet guerile. Po deklarata e
25 UÇK-së thotë që i kanë kërkuar Adem Demaçit të jetë

1 kryenegociator dhe të heqë dorë nga çdo pozitë tjetër politike
2 në arenën e Kosovës”.

3 Ju kujton gjë kjo?

4 PËRKTHYESJA: U bë ndërhyrje nga përkthyesit sepse nuk
5 shihet teksti në shqip.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Do ta lexoj dhe një herë tekstin ju lutem. Pjesa e fundit
8 e tekstit sepse nuk dukej. Thuhet:

9 “UÇK-ja e bëri të qartë që ekipi i Kosovës nuk flet për
10 guerilët por deklarata e UÇK-së që guerilët i kanë kërkuar
11 Adem Demaçit që të jetë kryepërfaqësuesi i tyre dhe të japë
12 dorëheqjen nga pozitrat e tjera në arenën politike të Kosovës”.

13 Keni ndonjë dijeni për këtë që sapo lexova?

14 PË. Jo.

15 PY. A e keni ditur ju që ishte caktuar Adem Demaçi nga Shtabi
16 i Përgjithshëm që të ishte përfaqësuesi i tyre?

17 PË. Po Adem Demaçi është përcaktu ma herët, jo në këtë kohë,
18 qysh në kohën e qershorit, korrik, është përcaktu si zëdhënës
19 -- përfaqësues politik i UÇK-së. Pi atëherit po, po në këtë
20 kohë nuk e di.

21 PY. Unë ju pyes sepse më pas, në 17 gusht, flasim tani për
22 zonën e Dukagjinit.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Përpara se të vijojmë me pyetjet,
24 do lutesha që të shfaqej në ekran materiali me numër P00487-
25 ET.8 dhe në shqip dhe në anglisht

1 PY. A e keni ditur ju që njësitë vartëse të UÇK-së për
2 njësitë operative të Lugut të Baranit --

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe një herë Sekretares i
4 drejtohem, ju lutem në shqip duhet të jetë faqja 2761. Jo nuk
5 është kjo faqe. Kjo.

6 PY. Është një komunikatë e lëshuar prej njësisë operative të
7 Lugut të Baranit. A ju kujtohet të ketë pasur një problem nga
8 këto njësite në zonën e Dukagjinit edhe ata kanë lëshuar një
9 komunikatë për të mbështetur z. Rugova dhe thonë që nuk do të
10 lejonin individë si Demaçi, Qosja, Hajrizi dhe ekipet e tyre
11 satelitore të luanin me personat dhe as nuk do të lejonin as
12 të drejtonin njësitë operative të UÇK-së në lugun e Baranit
13 dhe kjo është përgatitur nga Nazif Ramabaja i cili dhe e ka
14 nënshkruar këtë dokument.

15 A e keni njohur ju Nazif Ramabanë?

16 PË. Po.

17 PY. A keni pasur dijeni ju që e ka përgatitur këtë Nazif
18 Ramabaja në gusht të 1998?

19 PË. Jo. E di që ka pasur probleme të mjafta, jo veç këto, e
20 di që ka pas probleme edhe me Tahir Zemën. Por këtë komunikatë
21 nuk e di, qetash po e shoh.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirë. Tani shohim provën materiale
23 me numër P00094.

24 PY. Ky është një lajmërim që ka bërë Nazif Ramabaja për
25 njësitë lokale të UÇK-së në zonën e Dukagjinit dhe i ka ftuar

1 në një mbledhje më 20 gusht ku do të diskutonin "riorganizimin
2 e njësive operative, mbrojtjen territoriale, kuadrin
3 profesional apo joprofesional, 'mendimin e tyre'" dhe
4 "përkrahjen e vijës institucionale".

5 A keni pasur dijeni që të jetë kërkuar një takim i tillë
6 nga Nazif Ramabaja dhe në këtë takim në fakt Tahir Zemaj
7 zëvendëson Ramush Haradinaj?

8 PË. Në atë kohë ka zëvendësu, është një kohë që ka zëvendësu
9 Tahir Zemaj Ramush Haradinajn, po për këtë nuk kam pas dijeni,
10 për kesi lloj lajmërimi dhe thirrje të këtyre komandantëve.

11 PY. Fakti që po mblidhen sërish njësité lokale për të
12 diskutuar se cili do të jetë komandanti, kjo në fakt është e
13 ngjashme me praktikën sesi u bë Ramushi komandant në qershor.
14 Pra, a është e drejtë të themi edhe gjatë gjithë verës njësité
15 lokale ishin ende në kontroll të komandës së UÇK-së nëpër
16 zonat përkatëse ose të paktën në zonën e Dukagjinit?

17 PË. Po, kur të marrë me u këqyr me këto dhe në atë kohë nuk
18 kanë qenë të gjithë njësité lokale në komandën e UÇK-së,
19 domethënë, kanë pas ndikime dhe nga aspekte tjera, shifet dhe
20 në këto dokumente, po dhe me veprimin që është bë në gusht nga
21 ana e Tahir Zemës dhe grupit të tij.

22 PY. Po. Do flasim dhe për këtë. Tahir Zemaj zëvendëson Ramush
23 Haradinaj si komandant i zonës së Dukagjinit në fund të
24 gushtit 1998, kështu?

25 PË. Po.

- 1 PY. A ju kujtohet në sa takime keni marrë ju personalisht
2 pjesë në zonën e Dukagjinit për të trajtuar çështjen apo për
3 të trajtuar faktin që Tahir Zemaj kishte marrë detyrën e
4 Ramush Haradinaj si komandant?
- 5 PË. Një herë kemi marrë takim. Një takim ka qenë.
- 6 PY. Ky ka qenë takimi i shtatorit?
- 7 PË. Po.
- 8 PY. 2 shtator, besoj se ishte. Ju nuk keni qenë në asnjë
9 takim në zonën e Dukagjinit në fund të gushtit për të
10 diskutuar zëvendësimin e Ramushit nga Tahir Zemaj?
- 11 PË. Thashë që po jemi kanë. Një takim ka qenë kur ka qenë,
12 kur është mbajtur për zëvendësimin e Ramush Haradinaj. Dhe
13 këtë e kemi mbajtur, kemi shkue në Dukagjin dhe kemi
14 diskutuar. Nuk ka pas takime të shumta.
- 15 PY. Si pjesë e delegacionit të Shtabit të Përgjithshëm që
16 shkuan në takim ishit ju, Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Lahi
17 Brahimaj, kështu?
- 18 PË. Po. Po, ashtu është.
- 19 PY. Ju shkuan atje në mënyrë që të riemëronit Ramush
20 Haradinajn si komandant të zonës së Dukagjini, kështu?
- 21 PË. Ne shkuan atje së pari të shofim çka është, çka ka ndodhë
22 kjo, si ka ardhë deri te ndërrimi dhe normalisht të vendoset
23 prapë komandant i zonës në pozitën e vet, se ne nuk kishim
24 kurrfarë informacioni për ndryshime të tilla nga siç thuhet në
25 atë kohë për një marrëveshje të tillë që të bëhet Tahir Zemaj

1 komandant i zonës. Ku si shtab nuk kishin atë informacion as
2 nuk kishim ndonjë leje që të kem marrë nga komandanti i
3 përgjithshëm që të bëhen këto ndryshimet.

4 Dhe kështu që ishim atje dhe e diskutuam këtë çështje dhe
5 e kthyem prapë Ramush Haradinajn komandant zone dhe propozuam
6 që Tahir Zemaj të jetë zëvendëskomandnat. I cili nuk e pranoi
7 këtë pozitë, u kthy prapë në pozitën e komandantit të
8 brigadës.

9 PY. A ka pasur ndonjë problematikë mesa ju kujtohet ju që
10 kishte lidhje me fotografinë e Ibrahim Rugovës të vendosur në
11 zyrën e Tahir Zemajt?

12 PË. Nuk më kujtohet.

13 PY. Ju keni deklaruar se gjatë takimit Tahir Zemaj ju tha se
14 ishte emëruar si komandant zone në bazë të një vendimi të
15 marrë nga qeveria në mërgim, kështu?

16 PË. Po, ashtu është.

17 PY. Ai madje pretendoi se ka pasur dhe marrëveshje mes
18 qeverisë në mërgim dhe përfaqësuesve politikë të UÇK-së,
19 kështu?

20 PË. Ashtu është.

21 PY. Ju u përgjigjët duke i thënë këto përfaqësuese të
22 pretenduar politikë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nuk
23 janë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm me të cilët keni
24 punuar ju, kështu?

25 PË. Unë ju kam përgjigj atyre që ne nuk kemi, nuk di kush

1 janë përfaqësuesit që e kanë bërë këtë marrëveshje dhe ne nga
2 komandanti i përgjithshëm nuk kemi kurrfarë informacioni as
3 urdhër që të bëjmë këto ndryshime.

4 PY. Anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm që ishin të
5 pranishëm në takim a ju thanë ose më saktë a lanë të kuptohet
6 se ata kishin dijeni të ishte bërë ndonjë marrëveshje mes
7 përfaqësuesve politikë të UÇK-së dhe qeverisë në mërgim?

8 PË. Unë çka di dhe gjatë shkuarjes atje, po dhe atje si kemi
9 qenë asnjë prej anëtarëve të shtabit s'më ka thënë që ka pas
10 ose ka një marrëveshje të tillë.

11 PY. Më konkretisht, unë dua të di z. Thaçi, z. Selimi, z.
12 Brahimaj a të thanë ty që shiko ne kemi dijeni për një
13 marrëveshje të tillë mes këtyre kinse përfaqësuesve politikë
14 të UÇK-së edhe të qeverisë në mërgim?

15 PË. Jo, mu sa më kujtohet jo.

16 PY. A ju kujtohet ku më falni është bërë ky takim. Takimi e
17 kemi mbajt në shkollë, në fshatin më duket Bardhaniq, mos
18 gabofsha.

19 PY. Tani dua të tregoj një intervistë të Zërit në 1999 e keni
20 diskutuar këtë edhe me Prokurorinë, do ju tregoj çfarë keni
21 thënë për këtë në 1999 dhe t'ju pyes nëse e pranoni ende këtë
22 që keni thënë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] është prova me numër 1D00102 dhe
24 në anglisht dhe në shqip. Faqja U002-2986.

25 PY. Është këtu ku ju bëjnë pyetjen:

1 "Ku u takuat dhe për çfarë folët me Tahir Zemën?"

2 Dhe ju përgjigjeni kështu:

3 "Takimin e mbajtëm në një shkollë në fshatin Bardhaniq,
4 ku ishte stacionuar dhe brigada. Gjatë takimit ia tërhoqëm
5 vëmendjen Tahirit për faktin se në ushtri nuk bëhet votim nga
6 fshatrat apo anëtarët e publikut ..."

7 Ndaloj këtu për momentin. Pra, ju në atë kohë e keni
8 ditur në 1999 që ajo që kishte ndodhur ishte që kishin votuar
9 fshatrat për Tahir Zemaj dhe që Tahir Zemaj të zëvendësonte
10 Ramush Haradinaj, kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Vijoni dhe thoni dhe se "emërimet bëhen nga lart-poshtë.
13 I thashë Tahirit se ai e dinte sesi bëheshin emërimet në
14 ushtri, në përputhje me rregullat e shërbimit, pra, i thamë
15 atij se komandanti mund të zgjidhej vetëm nga shtabi qendror.
16 Pastaj i grumbulluam të gjitha fshatrat së bashku duke
17 përfshirë dhe fshatrat në fjalë dhe pas një mbledhje të gjatë
18 i bindëm ata se nuk kishin të drejtë të votonin dhe të
19 emëronin një udhëheqës ushtarak".

20 Po ndaloj këtu.

21 Ju keni përdorur fjalën këtu "i bindëm" nuk keni thënë
22 këtu "i urdhëruam". Është fjalë me rëndësi kjo këtu. Pse keni
23 thënë këtu që ne i bindëm ata dhe nuk keni thënë ne i
24 urdhëruam ata?

25 PË. Po, i bindëm. Se dhe tash më kujtohet mirë, se unë e kam

1 bisedu dhe me këto fshatrat, nëpër shtabet lokale të këtyne
2 fshatrave dhe kemi diskutuar për këtë çështje sesi emënohet
3 një epror dhe si vendoset në pozitat komanduese. Dhe prej
4 atëherë u bindën që shtabet lokale që nuk mund të vendoset me
5 votë ama po duhet të vendoset në aspektin ushtarak, të cilët
6 është shtabi ai që i vendosë dhe i emnon komandantët e lart
7 dhe mënyrën sesi vendoset. Kështu që ata kanë ranë dakord dhe
8 kemi bërë këto ndryshimin në këtë kohë.

9 PY. Po a është e drejtë të themi që ju ende ju duhej pëlqimi
10 prej fshatrave, pra, duhet të merrnit pëlqimin e fshatrave që
11 ta rikthenit Ramushin si komandant?

12 PË. Ajo kur u është shpjeguar atyne dhe jo veç ata pëlqimin,
13 domethënë, që e kanë dhënë, po ata e kanë kuptuar se nuk bëhet
14 më emnimet siç kanë qenë më herët me vota se nuk është parti
15 politike, është ushtri, po formonin një ushtri, kemi fillu të
16 formonim një ushtri i cila do të ketë një rregull edhe një
17 disiplinë. Dhe për atë arsye dhe kemi shkuar dhe kemi
18 shpjeguar këto drejtimet, normalisht dhe ata janë pajtuar që
19 prapë të jetë Ramushi. E kanë njohtë dhe e kanë pas autoritet
20 dhe në atë kohë.

21 PY. Ju thoni:

22 "Pas takimit me fshatrat u rikthyem te takimi në
23 Bardhaniq. Më pas ju lexova deklaratën e shtabit qendror se
24 komandanti i zonës operative të Dukagjinit ishte Ramush
25 Haradinaj, sipas emërimit të bërë nga udhëheqja e lart

1 ushtarake dhe se Tahir Zemaj mund të ishte zëvendës i
2 Ramushit. Tahir Zemaj nuk e pranoi postin. Ai kishte aty pranë
3 një telefon satelit dhe telefonoi Ahmet Krasniqin duke e
4 informuar atë për gjithçka që kishte ndodhur. Pastaj unë dhe
5 Hashim Thaçi folëm me Ahmet Krasniqin në telefon. I thashë
6 Ahmetit, si mund të bësh një votim për një komandant kur kemi
7 një shtab qendror në Kosovë? Ahmeti u përgjigj ..."

8 Ju lutem kalojmë tek faqja tjetër në shqip:

9 "... 'Ju merruni me punën tuaj dhe mos ndërhyjni me
10 oficerët e mi'. Unë pastaj i thashë, 'Zotëri, këta janë
11 oficerët e UÇK-së" dhe ai u përgjigj, 'Jo, ata janë oficerët e
12 mi dhe ti nuk ke punë të ndërhysh".

13 A ju ndihmon kjo për të kujtuar thirrjen telefonike që
14 keni pasur me Ahmet Krasniqin?

15 PË. Po, po, plotësisht.

16 PY. Pra, çfarë ka ndodhur në praktikë është që qeveria,
17 Ministria e Mbrojtjes e qeverisë në mërgim po përpiqej të
18 merrte në kontroll zonën e Dukagjinit përmes Tahir Zemajt,
19 kështu?

20 PË. Po, pikërisht qashtu është. Nuk u përmbajt, po dhe në
21 qoftë se e kanë pas një marrëveshje, ka mund të shkohet ashtu
22 siç janë marrë vesh, mirëpo në këtë mënyrë ka shku qashtu.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
24 do bëjmë një pushim të shkurtër.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, do vazhdoj me këtë dokument

1 pas pushimit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
3 bëjmë dhjetë minuta pushim tani.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Bëjmë një shkëputje prej dhjetë minutash.

7 --- Seanca ndërpritet në orën 15.29

8 --- Seanca rifillon në orën 11.30

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Sillni dëshmitarin në
10 sallë, ju lutem.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një çështje organizimi, ju
12 lutem. Na këshilloi Sekretarja për një përkthim në gjuhën
13 angleze dhe një provë materiale që është pranuar. Me sa duket
14 një nga materialet ka dy përkthime. Një nga përkthimet është i
15 TPNJ-së, dhe është një rishikim i përkthimit nga kjo Gjykatë.
16 Do të doja të hiqej përkthimi i parë nga provat, dhe do të
17 donim që të mbajmë të pandryshuar provën me numër P00141-ET si
18 përkthimin e vlefshëm, dhe jo materialin me numër P00141.E.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me sa shoh
20 nuk ka kundërshtime. Në rregull atëherë, materiali me numër
21 P00141-ET është materiali i vlefshëm.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Përkthimi i këtij
23 materiali merr numrin e provës 1D00165_ET dhe zëvendëson
24 përkthimin e mëparshëm. Klasifikimi është konfidencial.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 127

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,

2 riklasifikojeni si dokument publik.

3 [Mikrofoni çaktivizuar]

4 Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

7 personat që kanë një pajisje celular ta fikin sepse bën zhurmë

8 në mënyrë të vazhdueshme.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Duhet të jetë radiomarrja e

10 sigurisë, jo e jona.

11 Faleminderit.

12 PY. Dëshmitar, mirë. Vazhdojmë te dokumenti në ekran, edhe të

13 shohim çfarë keni thënë në 1999 për *Zërin*. Në rreshtin e dytë

14 thoni:

15 "Ne u kthyem në takim", domethënë kjo është pas bisedës

16 që keni bërë me Ahmet Krasniqin në telefon. Ju thoni:

17 "U kthyem në takim dhe thamë që ai duhej", domethënë ai,

18 Tahir Zemaj, "duhej të qëndronte si zëvendëskomandant i zonës.

19 Ai tha se nuk do t'i pranonte këto detyra dhe se do të

20 vazhdonte të qëndronte si komandant i Brigadës 131 me bazë në

21 Prapaqan. Ne pastaj vendosëm që ai të qëndronte si komandant i

22 kësaj brigade, por me kusht që të mos ndërhynte në asnjë lloj

23 çështje civile siç kishte bërë më parë."

24 Po ndaloj për një sekondë këtu.

25 Ky rreshti këtu, që ju i keni thënë atij që nuk duhet të

1 ndërhynte në çështje civile, a ju kujtohet çfarë kishte bërë
2 ai për këto çështje civile?

3 PË. Po pas kësaj kur jemi larguar nga aty, ai pas një
4 periudhe shumë të shkurtër ka marrë njësinë dhe është larguar
5 krejt nga territori i Kosovës, dhe ka lanë vijat e frontit, të
6 gjitha, i ka lanun pa mbrojtje dhe popullatën.

7 PY. Më falni, se mbase nuk e bëra pyetjen siç duhet. Pyetja
8 ime është kjo, e kam për këtë fjalinë këtu, që i keni thënë
9 Tahir Zemaj në takim, që të mos ndërhynte në asnjë lloj
10 çështje civile siç kishte bërë më parë. Dhe unë pyetjen e kam
11 kështu, në çfarë çështjesh civile kishte ndërhyrë ai para
12 takimit që sipas jush ishte e papërshtatshme sepse ishin
13 çështje civile, ishin të natyrës civile?

14 PË. Po çështja është, kur thuhet civile është çështjet e
15 shtabeve lokale, të fshatrave që kanë qenë. Shtabe lokale,
16 kanë qenë këshillat e fshatrave. Për këtë, për këtë arsye kemi
17 folur dhe kjo është çështja pse është thanë.

18 PY. A mund të ketë pasur kjo lidhje me këtë mosmarrëveshjen
19 se kush do ta përfaqësonte UÇK-në dhe për faktin që Tahir
20 Zemaj kishte ndërhyrë dhe kishte lëshuar komunikata politike
21 nga zona? Madje, do ta bëj ndryshe pyetjen. A e kontestoni ju
22 parashtrimin tim kur them që kjo mund të ketë pasur lidhje me
23 faktin që Tahir Zemaj dhe Nazif Ramabaja kanë lëshuar
24 komunikata politike nga ajo zonë?

25 PË. Simbas asaj komunikatë e pashë, ato po shifin që po, janë

1 politike.

2 PY. Më pas ju thoni:

3 "Pas kësaj, siç e dini, filloi ofensiva, dhe Tahiri
4 tërhoqi të gjitha trupat, braktisi vijën e frontit dhe i
5 dorëzoi, dorëzoi një arsenal të madh armësh. Ky veprim, gjatë
6 ofensivës vitin e kaluar, tregoi se kush kishte çfarë
7 qëllimesh dhe kush ishte i përkushtuar për të luftuar për
8 lirinë e Kosovës".

9 Pyetja e parë që po ju bëj është kjo: Tahir Zemaj kujt ia
10 dorëzoi këtë arsenal të madh armësh?

11 PË. Këtë arsenal armësh e ka lanë aty në fshatra dhe,
12 normalisht, pastaj këto fshatrat civilët kur hynë forcat serbe
13 i kanë marrë, i kanë zanë rob. Faktikisht, komplet ai arsenal
14 armësh e municioni ra në dorë të ushtrisë serbe.

15 PY. Ju pse mendoni që u tërhoq Tahir Zemaj nga vija e frontit
16 dhe tërhoqi trupat, si e keni kuptuar ju?

17 PË. Kuptimi im i plotë ka qenë në aspektet ushtarake, është
18 dhe qysh të dush ta marrësh, nuk u ka përshtatur me të tjerë,
19 domethënë faktikisht nuk ka arrit të jetë aty ku ai ka
20 dashtur. Dhe është tërhjekur nga territori i Kosovës. Por,
21 faktikisht, shkurt e them, ai që vjen, dëshirën që e ka të
22 lufton, që ka vullnetin e luftës, nuk pyet as për aspektet
23 politike as për vështirësitë. Por një epror ushtarak si unë
24 apo të tjerët janë që të ndihmon popullatës, pa marrë parasysh
25 vështirësitë apo të mirën apo të keqen. Dhe u dasht të vazhdon

1 të jetë pranë popullatës, me siguri pas një kohe do të kishte
2 arrit aty ku ai ka menduar të jetë si epror ushtarak me
3 përvojat e tyre, dhe besimin që do ta kishte edhe nga
4 popullata edhe nga ushtarët, si unë që e kam pas nga fillimi
5 edhe deri në fund.

6 PY. Kur thoni nuk përmbushi qëllimet e tij, sipas jush, çfarë
7 qëllimesh kishte ai?

8 PË. Qëllimi i tij ka qenë shumë kjartë. Të mbërrijë në
9 pozitën e komandantit të zonës, të udhëheqë zonën, të merr në
10 dorë, në kontroll, kjo ka qenë qëllimi i tij.

11 PY. A ka qenë si pjesë e qëllimit edhe që të bëhej ai
12 komandant i zonës dhe ta mbante këtë zonë nën kontrollin e
13 qeverisë në mërgim?

14 PË. Unë foli për atë pjesë, aspektit, ai të arrin, të është
15 në atë pozitë. Me siguri edhe ajo është, por tani për tani nuk
16 mund ta them atë se, por qëllimi i tij, po, ka qenë të jetë
17 komandant i zonës.

18 PY. Dhe një gjë për Tahir Zemajn. Në intervistën për ZPS-në
19 në Pjesën 3, faqja 32, rreshti 17 deri në 21, ju keni thënë:

20 "E pyeta Tahir Zemajn dhe i thashë nëse do, mund të
21 bëhesh pjesë e drejtorisë operative, ai dhe disa oficerë të
22 tjerë, në mënyrë që ta plotësonim drejtorinë operative dhe ta
23 zhvillonim më tej ushtrinë, por ai nuk e pranoi këtë ofertë".

24 Është e saktë?

25 PË. Po, është e saktë. Kjo është edhe para kësaj, këtij

1 rastit. Kur kam qenë herën e parë, kam diskutuar me të, edhe
2 me oficerë të tjerë, por nuk ka ardh.

3 PY. Në rregull. Ju vajtët në zonën e Llapit në gusht të 1998,
4 a u takuat me komandant Remin në atë takim [Korrigjim i
5 përkthyesit: në atë udhëtim]?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe z. Thaçi ka qenë me ju në atë udhëtim?

8 PË. Po, në atë udhëtim kemi qenë bashkë, unë, z. Thaçi dhe z.
9 Rexhep Selimi.

10 PY. Në rregull. A e konfirmuat komandant Remin si komandantin
11 e zonës së Llapit në atë udhëtim?

12 PË. Sa më kujtohet, [E pakuptueshme] në atë kohë kur kemi
13 shkuar ne kemi shku për një arsye, që të shkojmë në këtë
14 territor për të shkuar deri në Prishtinë për të shkuar se
15 kemi pas një informacion që Agim Qelaj, ish-eprori, që gjindet
16 në Prishtinë, që është i plagosur, dhe është në shërim. Kur
17 kemi shkuar atje në zonë, unë së bashku me zëvendëskomandantin
18 kemi vazhduar të vizitojmë vijat e frontit dhe njësitë, kurse
19 Hashim Thaçi edhe Rexhep Selimi kanë hyrë në Prishtinë për t'i
20 shkuar a është Agim Qelaj, çka u konstatue pastaj që nuk
21 është. Pas kthimit të tij, këtyre, nga Prishtina, kemi vazhdu
22 menjëherë rrugën se ishte koha veç që mbërrinin nga lëshimi
23 territ, që neve na mundësonte që të lëvizim nga ajo zonë për
24 mbrapa në zonën e Drenicës.

25 Dhe jemi kthyer nga zona e Llapit. Unë nuk e di që është

1 konfirmuar ndonjësend aty që është vendos, se s'e kam pa, nga
2 ana ime nuk është dhënë asgjë.

3 PY. Në rregull. A keni diskutuar strukturën e komandës me
4 komandant Remin ose me Kadri Kastratin?

5 PË. Po, me Kadri Kastratin kam diskutuar unë, personalisht.

6 PY. Në rregull. Ky udhëtim, kjo rrugë që bëtë në të cilën
7 ishte edhe z. Thaçi dhe z. Selimi, ju thoni që ndaluar në
8 zonën e Llapit te komanda dhe ata vijuan për në Prishtinë dhe
9 kërkonin Agim Qelajn?

10 PË. Po, pikërisht.

11 PY. Dhe ata kishin dëgjuar që ai ishte plagosur?

12 PË. Po, kemi dëgjuar ashtu që është i plagosur dhe gjindet
13 atje në shërim.

14 PY. Po, po. A është e saktë që kur arritën në Prishtinë ata,
15 ju mësuat më vonë që nuk ishte Agim Qelaj, por që gjetën
16 dikënd tjetër, një person tjetër në Prishtinë?

17 PË. Po.

18 PY. E saktë?

19 PË. Po, e saktë është.

20 PY. Në shtator, ju i thatë Gjykatës në rastin Djordjevic, në
21 materialin P01356, në faqen 6178 të procesverbalit, që ju
22 ishit në Shqipëri për të rekrutuar më shumë ish-ushtarë të
23 armatës jugosllave për t'i bërë pjesë të UÇK-së, është e saktë
24 kjo?

25 PË. Po, unë shkova atje, dhe atje, jo vetëm në Shqipëri, por

1 dhe jashtë në pjesën perëndimore, në perëndim, për t'u takuar
2 me ish-eporët ushtarakë, për t'i ofruar për të ardhur mbrenda
3 në, për t'u kyçur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

4 PY. Në rregull. Këtë e keni bërë me nismën tuaj, apo ka qenë
5 diçka që është diskutuar nga të gjithë anëtarët e Shtabit
6 Qendror dhe që ju duhet të shkonit atje për të marrë, për të
7 rekrutuar më shumë ish-ushtarë të armatës jugosllave?

8 PË. Po, kemi diskutuar bashkë. Dhe është parë nevoja që duhet
9 të ketë më tepër pak eporë për me mujt me u riorganizu dhe me
10 forcu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

11 PY. Në mënyrë specifike, në Shtabin e Përgjithshëm me kë e
12 keni bërë këtë diskutim?

13 PË. Zakonisht i kemi bërë gjatë veprimit të punës dhe
14 zhvillimit në të dhe me z. Selimi edhe me, Rexhep Selimin,
15 edhe me Hashimin, Thaçin, edhe me anëtarë të tjerë të shtabit.

16 PY. Në rregull. Gjatë kohës që -- ose më mirë, ta bëj pyetjen
17 kështu. Ju, a keni qenë ndonjëherë në Kosovë në tetor të 1998?

18 PË. Jo.

19 PY. Kur, pasi u larguat në shtator, kur ka qenë hera e parë
20 që keni rihyrë në Kosovë?

21 PË. Në nëntor, bashkë kur jemi kthyer në Kosovë, kemi hy unë
22 dhe z. Kadri Veseli. Ishte nëntori.

23 PY. Në rregull. Meqenëse po flasim për muajin, ose po flas
24 unë për muajin tetor, juve ju janë bërë disa pyetje nga ZPS-ja
25 në lidhje me arrestimin e Cen Deskut dhe Jakup Kastratit. E

1 mbani mend që ju janë bërë pyetje në lidhje me këtë çështje?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe ju i keni thënë ZPS-së që urdhri për arrestimin e
4 tyre ka ardhur nga komandanti ose zëvendëskomandanti i Shtabit
5 të Përgjithshëm. Pyetja ime është kjo, ata u arrestuan në fund
6 të tetorit. Në rast se ju nuk keni qenë në Kosovë në atë kohë,
7 nga i dini ju rrethanat të cilat, në të cilat janë arrestuar
8 ata?

9 PË. Po. Unë nuk kam qenë në tetor, është e saktë. Por ato
10 kam, q'atë informatë e kam marrë mbasi kam hy mbrenda në
11 nëntor.

12 PY. Ju i keni thënë ZPS-së që kur e përmendët këtë çështje,
13 çështjen e Deskut dhe Kastratit në një takim të Shtabit të
14 Përgjithshëm, askush nuk u përpoq të shpjegohej apo ta
15 justifikonte atë. Pra, këtë e keni thënë në dokumentin P01355,
16 Pjesa 3, faqja 38, rreshtat 1 deri në 9. Ju kujtohet më mirë
17 tani që kur jua bënë këtë pyetje askush nuk -- kur e bëtë ju
18 këtë pyetje, askush nuk u përpoq të jepte shpjegim, apo ta
19 justifikonte atë?

20 PË. Nuk e di, nuk më kujtohet. Por e di që e kemi diskutuar
21 disa herë, dhe domethënë është, justifikim nuk kam pa diçka të
22 veçantë.

23 PY. Po, dhe ju në fakt në Pjesën 3, faqen 39, rreshtat 4 deri
24 në 9 të intervistës me ZPS-në, thoni që askush nuk jua ka
25 shpjeguar arsyet e ndalimit të tyre. Pra, pyetja ime për ju

1 është, a ka mundësi që askush nuk u përpoq ta shpjegonte apo
2 ta justifikonte se askush në nivelin e Shtabit të Përgjithshëm
3 nuk ishte në fakt i përfshirë?

4 PË. Me siguri, po.

5 PY. Ju nuk keni dijeni nëse mund të ketë qenë një çështje
6 lokale në të cilën janë përfshirë njësitet lokale të UÇK-së,
7 në terren ose jo xhanëm, se ju nuk keni qenë atje, apo jo?

8 PË. Jo.

9 PY. Saktë?

10 PË. Nuk e di, q'ashtu është.

11 PY. Në të njëjtën kohë, a është e saktë që ju keni qenë në
12 Shqipëri duke negociuar me Qeverinë në mërgim, në Ekzil, për
13 unifikimin apo bashkimin e UÇK-së dhe FARK-ut?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe kjo marrëveshje u përfundua në datën 2 nëntor të
16 vitit 1998, pra disa ditë pasi zotërinjtë Desku dhe Kastrati
17 ishin ndaluar. Çështja e ndalimit të tyre ka dalë në bisedat
18 tuaja me Qeverinë në Ekzil? Të paktën me sa mbani mend.

19 PË. Me sa mbaj mend, jo.

20 PY. Anëtarët e Qeverisë në Ekzil, me ç'mbani mend ju, a kanë
21 qenë anëtarë të LDK-së?

22 PË. Nuk e di a kanë qenë anëtarë të LDK-së. Po, disa po. Disa
23 po.

24 PY. Në rregull. A mbani mend në mënyrë të veçantë nga Qeveria
25 në Ekzil me kë keni negociuar ju për të arritur unifikimin e

1 UÇK-së dhe FARK-ut?

2 PË. Po, takimin e parë të cilin e kemi bërë jashtë

3 Shqipërisë, në Turqi. Nga ana e Shtabit të Përgjithshëm kam

4 qenë unë dhe z. Kadri Veseli. Kurse nga ana e Qeverisë në

5 Ekzil ka qenë Bujar Bukoshi, Isa Mustafa, Halil Bicaj, Kadri

6 Balaj.

7 PY. Në rregull. Ju i keni thënë ZPS-së që ajo që shpresonit

8 nga këto takime, ishte që të kishit më shumë kuadro

9 profesionistë dhe ish-eprorë të armatës jugosllave që të

10 bëheshin pjesë e UÇK-së. Është e saktë kjo? Sepse kjo është në

11 Pjesën 14 në faqen 35.

12 PË. Po, saktë.

13 PY. Në rregull. A keni patur përkrahjen e komandantit të

14 përgjithshëm në këto negociata?

15 PË. Po. Komandanti i përgjithshëm na ka dërguar.

16 PY. Në rregull. A e mbani mend nëse ai ka qenë i pranishëm në

17 ndonjë nga këto takime?

18 PË. Takimin e parë, kur të thashë, kemi qenë në Stamboll. Jo,

19 takimet e dyta nuk e mbaj mend. Di që ka qenë Xhavit Haliti,

20 përfaqësuesi politik, dhe anëtar i shtabit, Kadri Veseli, unë.

21 Ka mund me qenë edhe dikush tjetër, por më të shumti kemi qenë

22 ne.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Sekretare e seancës, ju lutem

24 shfaqni në ekran DHT03873 deri në DHT03877, që është versioni

25 në anglisht i marrëveshjes ndërmjet UÇK-së dhe FARK-ut, ndërsa

1 në gjuhën shqipe gjendet me numrin 061167 deri në 061171. A

2 mund të kalojmë në pjesën e poshtme të faqes, në versionin në
3 shqip?

4 PY. Z. Zyrapi, a e njihni këtë dokument që e shihni në anën e
5 majtë të ekranit?

6 PË. Po.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund të vijojmë poshtë, te
8 pjesa e poshtme e faqes.

9 PY. A është ky dokumenti që keni nënshkruar ju në emër të
10 UÇK-së për të unifikuar FARK-un dhe UÇK-në?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe me sa mbani mend ju, data në këtë dokument 2 nëntor
13 1998, a është e saktë ajo?

14 PË. Po.

15 PY. Në rregull. Dhe këtu pra bëhet thirrje për bashkimin e të
16 dyja këtyre grupeve, FARK-ut dhe UÇK-së, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Ka edhe një postskript ku thuhet:

19 "Në mënyrë që vendimi të fitojë plotfuqi më duket edhe
20 miratimi nga takimi që do të pasohet ndërmjet:

21 "Adem Demaçit

22 "Bujar Bukoshit

23 "Përfaqësuesit të UÇK-së, dhe

24 "Halil Bicajt".

25 Atëherë, përse në këto negociata kërkohej miratimi i Adem

1 Demaçit?

2 PË. Përveçse kjo që e pamë ne, është një marrëveshje
3 ushtarake, kurse marrëveshja tjetër do të ishte një
4 marrëveshje politike. Do të ishin edhe përfaqësuesit, se këtu
5 është, domethënë, edhe Adem Demaçi si përfaqësues politik, por
6 dhe përfaqësuesi politik i UÇK-së në Shqipëri. Kështu që,
7 përveç kësaj, duhet kjo marrëveshje të lindte edhe aspektet
8 edhe politike, si metodë, si marrëveshje për të qenë
9 fuqiplotë, dhe këto grupet u dasht, domethënë, në aspekte
10 politike që të bijnë dakord, dhe të nënshkruajnë edhe ata një
11 marrëveshje të tillë, të cilën ka qenë simbas marrëveshjes dhe
12 bisedës që e kemi bo ne në Stamboll, që [E pakuptueshme] pranë
13 qeverisë së Shqipërisë, si garante ajo që është mes të dy
14 palëve që do të bashkohen edhe do të nënshkruajnë këtë
15 marrëveshje. Për atë edhe janë kyçë edhe aspektet edhe [E
16 pakuptueshme] politike.

17 PY. A mbani mend se kush apo cila palë ka thënë që kërkohej
18 miratimi i Adem Demaçit për miratimin politik?

19 PË. Nuk më kujtohet.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë të kalojmë tek faqja
21 tjetër.

22 PY. Dëshmitar, ka patur një shtojcë kjo marrëveshja.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Është faqja tjetër, jo kjo që
24 duket në ekran.

25 PY. Dhe, është dhe një strukturë që propozohet për Shtabin e

1 Përgjithshëm, është e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe Agim Çeku sipas marrëveshjes, do të duhet të merrte
4 vendin e Azem Sylës si komandant i përgjithshëm, saktë?

5 PË. Po, shumë saktë.

6 PY. Por, a mund të na shpjegoni, ose siç e shpjegoni ju në
7 fakt në intervistën tuaj me ZPS-në, Pjesën 14, faqe 39 -- në
8 fakt, më mirë do t'jua bëj si pyetje.

9 Së pari, Agim Çeku pse u zgjodh si komandant i
10 përgjithshëm?

11 PË. U zgjodh në bisedë kur kemi pasur në, gjatë marrëveshjes,
12 që komandanti i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
13 të jetë një person profesionist i paanshëm, domethënë, që
14 s'është as i anës të qeverisë në ekzil, por as i UÇK-së, por
15 të është një profesionist tjetër i cili ka përvojën dhe të
16 vendoset si konsensus, si komandant i përgjithshëm.

17 PY. Dhe siç e dimë ne, Agim Çeku nuk u bë komandant i UÇK-së
18 deri në muajin prill. Pra, mund të shpjegoni se pse u desh
19 pesë muaj që të ndodhte kjo gjë?

20 PË. Nuk e di për arsyen pse, e di që në atë kohë ai ka
21 kërkuar që një herë, se ka qenë aktiv në ushtrinë kroate,
22 derisa është demobilizuar, apo deri i ka kry veprimet që është
23 dasht, por na ka ardhur tek, faktikisht, mbrenda në Kosovë kur
24 ka ardh detyrën me e marrë në prill të 1999.

25 PY. Ju i keni thënë ZPS-së që fillimisht sipas kësaj

1 marrëveshjeje, Hashim Thaçi planifikoi që të bëhej pjesë e
2 qeverisë në ekzil dhe këtu është J.1. E shihni këtë pikë?
3 PË. Po.

4 PY. A mund të na shpjegoni pak se cili ishte koncepti, pra
5 çfarë do t'i binte që do duhet të bënte Hashim Thaçi si pjesë
6 e qeverisë në ekzil?

7 PË. Me atë bisedë kur kemi diskutuar në Stamboll, po ka qenë
8 pjesë që të hyjnë një pjesë e anëtarëve të Shtabit të
9 Përgjithshëm të hyjnë në pjesën e qeverisë në ekzil, në pozita
10 të ndryshme. Tash s'më kujtohet postet saktë cila pozitë ka
11 qenë, për të hyrë në kuadër të saj. Që jo veç Hashim Thaçi,
12 por kanë qenë të planifikuar edhe disa të tjerë anëtarë, si
13 edhe ministri i mbrojtjes, disa, financave, sa më kujtohet.
14 Dhe kështu që këto është bisedue.

15 PY. Atëherë, nuk e di a e kam kuptuar saktë unë që dëshmia
16 juaj është që marrëveshja që e tillë që FARK-u bëhet pjesë e
17 Ushtrisë nën UÇK-në, dhe UÇK-ja cakton përfaqësuesit e vet
18 politikë tek qeveria në ekzil, që është si një bashkim jo
19 vetëm i anës ushtarake, por edhe i asaj politike, të të dyja
20 këtyre organizatave?

21 PË. Po, pikërisht.

22 PY. Dhe ju që disa nga këto pozicione këtu janë ndryshuar për
23 shkak të zhvillimeve në teren, dhe në mënyrë më specifike,
24 meqenëse negociatat kishin filluar me ndërkombëtarët, dhe kjo
25 është në intervistën tuaj në Pjesën 14 të saj, është e saktë

1 kjo? Në faqen 38.

2 PË. Po, e saktë është.

3 PY. Ju i keni thënë ZPS-së që për shkak të fillimit të këtyre
4 negociatave, duhej që tek Shtabi i Përgjithshëm të krijohet
5 një drejtori politike, është e saktë kjo?

6 PË. Po, e saktë.

7 PY. Dhe Hashim Thaçi u emërua që të udhëhiqte drejtorinë
8 politike të UÇK-së, e saktë?

9 PË. Po, e saktë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar i seancës,
11 Kryegjykatës, dëshiroj të kërkoj tani pranimin të këtyre
12 dokumenteve. Kemi një version P652-ET, por në atë version nuk
13 është i përfshirë shtojca. Kështu që, ose do ta zëvendësojmë
14 atë me dokumentin me shtojcë, ose në rast se ZPS-ja dëshiron
15 të mbajë versionin që ka, atëherë të shtojmë vetëm shtojcën si
16 dokument i Mbrojtjes.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
18 [Përkthim] P652 nuk më duket numër i saktë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt, faji im, numër i saktë
20 është 652.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj,
22 P652.

23 Ka kundërshtime për të shtuar shtojcën tek dokumenti që
24 në fakt ka qenë provë e përfshirë, origjinalit?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë me ç'kuptoj, P652 është vetëm

1 një faqe, pra një faqe e vetme. Ne nuk kemi kundërshtim që të
2 pranohet kjo faqe, dhe në qoftë se do ketë probleme me
3 përkthimin, mund t'i ngremë këto çështje më vonë ndërmjet vetë
4 palëve.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt nëse mund të shtoj unë
7 një, ky është një dokument i rëndësishëm dhe jemi pak të
8 paqartë se pse kemi dy versione. Një me dhe tjetri pa
9 shtojcën. Atëherë, unë them që në fakt të pranohen veç e veç,
10 se sa të shtojmë, ose të zëvendësojmë diçka.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt,
12 synimi i Panelit, i Trupit Gjykses, është që t'i pranojë veç e
13 veç, kështu që keni të drejtë. Atëherë, ERN-ja është DHT03873,
14 është e saktë kjo?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
17 061167 deri në 061171, në gjuhën shqipe, pranohet. Dhe besoj
18 që dokumenti mund të jetë dokument publik?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, nga ana jonë, po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
21 kundërshtim? Nëse jo, riklasifikohet si dokument publik dhe
22 t'i japim një numër të ri provës materiale.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës,
24 versioni në shqip dhe përkthimi në gjuhën angleze do të marrë
25 numrin e provës materiale 1D00166, dhe të dyja këto dokumente

1 riklasifikohen si dokumente publike.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Vijoni, z. Misetiç.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

5 PY. Atëherë, Dëshmitar, si pjesë e ristrukturimit dhe
6 dëshiroj në fakt që të diskutojmë pak titullin tuaj,
7 pozicionin. Kemi përdorur dy emërtime të ndryshme dhe dua të
8 di se cili është i sakti. Në ushtri, ka diçka që quhet shefi i
9 shtabit, dhe kemi edhe një pozicion tjetër që është shefi i
10 Shtabit të Përgjithshëm. A është e saktë që ju keni qenë shefi
11 i Shtabit të Përgjithshëm dhe jo shefi i shtabit?

12 PË. Me këtë formacion, të cilin ka qenë aty, unë kam shefi i
13 shtabit të Shtabit të Përgjithshëm. Se në qoftë se marrim në
14 kontekstin ushtarak në kohët e sotme, shefi i shtabit është
15 shefi i mbrojtjes, dhe nuk ka mbi të komandant të
16 përgjithshëm. Meqenëse ne kemi qenë në zhvillim atëherë, kemi
17 pas komandantin e përgjithshëm, zëvendësin, shefin e shtabit.
18 Domethënë unë kam qenë shefi i shtabit.

19 PY. Mirë atëherë. Do t'ju tregoj disa dokumente që ua ka
20 treguar edhe Prokuroria.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të vendosim në ekran
22 materialin që mban numrin P00604 [Korrigjim i përkthyesit:
23 624].

24 PY. Kjo është një urdhëresë ose urdhër që e keni lëshuar ju
25 më 4 janar 1999.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim pjesën ku duket firma,
2 nënshkrimi.

3 DËSHMITARI: Po.

4 Z. MISETIC: [Përkthim]

5 PY. Në anglisht thuhet, "Shef i Shtabit të Përgjithshëm të
6 UÇK-së", po në shqip çfarë thotë?

7 PË. "Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së".

8 PY. Pra, Shef i Shtabit të Përgjithshëm është nivel
9 komandues, është një post komandues, apo jo? Apo jo?

10 PË. Është kur nuk ka komandant të përgjithshëm. Meqenëse tash
11 është komandanti i përgjithshëm, edhe ka komandantin e
12 përgjithshëm, shefi i shtabit është në këtë pozitë të tretë.
13 Dhe nuk është pozitë komanduese.

14 PY. Po. Nga mënyra si e keni nënshkruar ju dokumentin, se nuk
15 është nevoja të nxjerrim të gjithë dokumentet, por të gjitha
16 dokumentet që unë po citoj, ju të gjitha këto i keni
17 nënshkruar si shef i Shtabit, në cilësinë e shefit të Shtabit
18 të Përgjithshëm, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Në gjykimin Milutinovic, dokumenti P01356, faqja 5958,
21 rreshtat 3 dhe 4, keni thënë, i keni thënë Trupit Gjykses që
22 ka qenë përgjegjësia juaj të urdhëronit luftimet, të
23 urdhëronit operacionet në luftime, kështu?

24 PË. Përgjegjësia e shefit të shtabit është të përgatisë të
25 gjitha operacionet operative dhe strategjike në nivelin e

1 Kosovës. Në momente të duhura mund të urdhërojë lëvizjen e
2 njësive, në pajtim me komandantin e përgjithshëm.

3 PY. Në gjykimin Milutinovic keni thënë që:

4 "Funksioni i shefit të shtabit ishte të administronte dhe
5 të drejtonte Shtabin e Përgjithshëm si dhe drejtoritë pranë
6 Shtabit të Përgjithshëm."

7 Saktë?

8 PË. Po. U është thënë detyra që shefi i shtabit që të punon
9 me drejtoritë, drejtoritë pranë Shtabit të Përgjithshëm, të
10 cilët do të administronte me ta, përgatiste me ta, t'i jepte
11 detyrat dhe normalisht të mundësonte punën e këtyne drejtorive
12 të Shtabit të Përgjithshëm.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim provën materiale P01356 në
14 faqen 5945 dhe në anglisht dhe në shqip. Në anglisht është
15 rreshti 16 dhe 19. Në shqip rreshtat 12 deri në 14.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na thoni se
17 cila pjesë?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt s'e paskam pjesën, sepse
19 është një nga transkriptet e TPNJ-së. P01356, IT-05-87.1
20 P00428. Në shqip janë rreshtat 12 deri në 14, në anglisht 16
21 deri në 19.

22 PY. Ju është bërë një pyetje në këtë gjykim, lidhur me një
23 dokument, "Rregulla e përkohshme e organizimit të jetës së
24 brendshme të UÇK-së", është dokumenti. Dhe ju keni thënë
25 kështu.

1 "Është një dokument paraprak i cili është përgatitur në
2 fund të 1998. Ky dokument rregullonte organizimin e jetës së
3 brendshme. Për të përgatitur këtë dokument, pamë rregulloret e
4 ushtrive perëndimore."

5 Të hënën, është e reflektuar në transkriptin e ditës së
6 hënë kjo, ju i keni thënë Prokurores se ju e dinit që këto
7 rregulla ekzistonin qysh para nëntorit 1998. Kjo është në
8 transkript tek faqja 17405. Ndërsa këtu ju thoni që ky
9 dokument paraprak, është përgatitur në fund të 1998. A është e
10 drejtë të themi që mbase kujtesa juaj në çështjen Milutinovic
11 ka qenë më e mirë se kujtesa që keni aktualisht sa i takon
12 përgatitjes së këtyre rregullave, të kësaj rregulloreje
13 paraprake.

14 PË. Jo, aspak. Edhe atëherë edhe tani. Në qoftë se mvaret
15 prej momentit që është pyet cila rregullore dhe çka është pyet
16 në cilën kohë. Dhe tash po e them njëjtë.

17 PY. Po këtu po flasim për rregulloren e përkohshme të
18 organizimit të jetës së brendshme. Ju thoni që ju e keni
19 përgatitur këtë dokument, dhe unë, mua ma merr mendja që këtë
20 e keni bërë pasi jeni bërë shefi i Shtabit të Përgjithshëm që
21 i takon në nëntor, pas nëntorit. Dhe ju keni thënë që:

22 "... ne pamë edhe rregulloret e ushtrive perëndimore."

23 Pra, ju keni thënë që janë përgatitur pas, në fund të
24 1998, dhe prezumoj që kjo ka ndodhur pasi jeni bërë ju shef
25 shtabi, saktë?

1 PË. Saktë. Unë, po këtu po e cekim në kohën kur unë kam qenë
2 shef shtabi, edhe kur kemi punu në riorganizimin dhe
3 rregulloren e brendshme që është plotësuar në atë kohë. Për
4 këtë kam fol edhe atëherë, edhe tani.

5 PY. Ditën e hënë i thatë Prokurores se nuk keni parë asnjë
6 rregullore tjetër disiplinore përpara rregullores së
7 përkohshme të cilën e keni përgatitur ju vetë.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj. Nuk besoj se është
9 shprehur në këtë formë dëshmitari. Do i lutesha Avokatit të
10 lexojë pjesën konkrete të transkriptit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
12 Dëshmitar, nëse mundeni mund të përgjigjeni.

13 Z. MISETIC: [Përkthim]

14 PY. A është e vërtetë që nuk keni parë asnjë rregullore -- më
15 fal, desha të thoja, nuk keni parë asnjë rregullore tjetër për
16 organizimin e brendshëm të UÇK-së përveç kësaj?

17 PË. Së pari, zotëri Avokat, ju bënë pyetjen për rregulloren
18 e brendshme. Rregullorja e mbrendshme dhe rregullorja e
19 disiplinës kanë dallime. Janë dy dokumente të ndryshëm. Ne
20 folëm për rregulloren e mbrendshme, është q'ashtu. E
21 disiplinës është diçka tjetër, ka pas diçka, unë kam dëgju që
22 ka pas, por unë nuk e kam pa aty.

23 PY. E korrigjova veten, ishte gabimi im në fakt.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 transkripti ka ngelur, është bllokuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ashtu është,
2 në fakt.

3 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja këshillohen]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se do
5 të duhet ta përsërisni pyetjen nesër.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt, ma mori mendja.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se
8 transkripti nesër do të jetë në funksion.

9 Z. Dëshmitar, do të duhet të largoheni, të ktheheni nesër
10 në orën 9.00. Faleminderit për ditën e sotme, ju kërkohet
11 ndjesë për këtë defekt teknik. S'e mbyllëm mirë nga pikëpamja
12 teknike, por gjëra që ndodhin.

13 Mos harroni që të mos flisni me askënd për dëshminë tuaj
14 jashtë sallës së gjyqit. Tani mund të largoheni. Faleminderit.

15 Faleminderit dhe Avokatit Kujdestar që ishit i pranishëm.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Fillojmë nesër në orën 9.00 -- më falni, dikush kishte diçka.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të diskutojmë pak
20 planifikimin e nesërm, unë e di nga përvoja ime, [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR], personi sa më afër të jetë, [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR].

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private për
25 ta diskutuar këtë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, s'mundemi
2 të kalojmë në seancë private në fakt.

3 E kuptuam çfarë donit të thoni. E kuptova. E kuptova.

4 Po mund të na jepni një ide me përfaqësi dhe sa kohë ju
5 nevojitet?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që të gjithë seancën e
7 nesërme. Por kam pasur zhvillime të mira dhe mund ta reduktoj
8 kohën e përgjithshme që kisha kërkuar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju, z.
10 Emmerson?

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë mendoj që do të përdor të
12 katërta orët që kisha kërkuar. Po unë kam pak merak për
13 fillimin, kur të më vijë radha e pyetjeve, mbase do të jetë
14 nevoja për pak pushim dëshmitari. Të ketë një shkëputje, pra
15 një mes ditëve të dëshmitarit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [REDAKTUAR]
17 [REDAKTUAR], kështu që ne [REDAKTUAR]
18 [REDAKTUAR]
19 [REDAKTUAR].

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë nuk kam ndryshim në orarin që
21 kisha, në orarin tim.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] As unë s'kam ndryshim, por kam
23 dhe unë një gjë që duhet të trajtoj. E kam ngritur këtë aspekt
24 edhe me Gjykatën për z. Krasniqi. A është e mundshme që ai të
25 na ndjekë përmes videolidhjes nesër?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kemi thënë
2 që për këtë doja të na jepet [REDAKTUAR].

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kemi kërkuar [REDAKTUAR],
4 dhe unë e kam njoftuar Gjykatën [REDAKTUAR].

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vlen i njëjti
6 rregull, ju lutem mirëkuptojeni.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fillojmë
8 nesër në orën 9.00.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25